Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

PLANI I VEPRIMIT 2009 PËR IMPLEMENTIMIN E PARTNERITETIT EVROPIAN PËR KOSOVËN

Korrik 2009

Prishtinë

Përmbajtja

1 HYRJE 8

1.1 RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN 8

1 HYRJE 8

1.1 RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN 8
1.2 PREGADITJA E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN (PVPE 2009) 9
1.3 SYNIMET E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN 10
1.4 PËRMBAJTJA E PLANIT TË VEPRIMIT 10
1.5 SHTOJCAT/LLOJET E AKTIVITETEVE 11
1.6 MONITORIMI, RAPORTIMI DHE RISHIKIMI I PVPE-SË 12

2 KOMPONENTI NARRATIV I PVPE-SË 2009 14

2.1 KRITERET POLITIKE 14
2.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT 14
a. Kushtetuta 14
b. Kuvendi 14
c. Zgjedhjet 15
d. Qeveria 15
e. Administrata publike 17
f. Qeverisja lokale/decentralizimi 20
g. Sistemi gjyqësor 24
h. Politika kundër korrupsionit 29
2.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE 31
a. Të drejtat civile dhe politike 31
b. Të drejtat ekonomike dhe sociale 34
c. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve 38
2.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE 40
2.2 KRITERET EKONOMIKE 41
2.2.1 EKZISTIMI I EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT 41
a. Thelbi i politikës ekonomike 41
b. Stabiliteti makroekonomik 43
c. Bashkëveprimi i forcave të tregut 51
d. Hyrja dhe dalja në treg 51
e. Sistemi ligjor 52
f. Zhvillimi i sektorit financiar 52
2.2.2 KAPACITETI PËR T'U PËRBALLUR ME KONKURRENCEN DHE KUSHTET E TREGUT BRENDA UNIONIT 56
a. Kapitali njerëzor dhe fizik 56
b. Struktura e sektorit dhe ndërmarrjeve 60
c. Ndikimi i Qeverisë mbi konkurrencën 61
d. Integrimi ekonomik me BE-në 62
2.3 STANDARDET EVROPIANE 68
2.3.1 TREGU I BRENDSHËM 68
a. Lëvizja e lirë e mallrave 68
b. Lëvizja e lirë e kapitalit 72
c. Dogana dhe tatimet 75
d. Prokurimi publik 79

e. Të drejtat e pronësisë intelektuale....79
f. Punësimi dhe politikat sociale....80
g. Arsimi dhe hulumtimi....83
2.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE....86
a. Industria dhe NVM-të....86
b. Bujqësia dhe peshkataria....89
c. Mjedisi....95
d. Politikat e transportit....99
e. Energjia....103
f. Shoqëria informative dhe mediat....109
g. Kontrolli financiar....114
h. Statistikat....116
2.3.3 DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA....119
a. Vizat, kufijt, azili dhe migrimi....119
b. Shpërlarja e parave....121
c. Luftimi i krimit të organizuar....121
d. Drogat....122
e. Policia....123
f. Mbrojtja e të dhënave personale....125
3 REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KAPACITETET ADMINISTRATIVE....127
a. Sfondi....127
b. Institucionet përgjegjëse dhe gjendja aktuale....127
c. Çka duhet bërë...?....127
4 PËRKTHIMI I ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN....128
a. Sfondi....128
b. Institucioni përgjegjëse dhe gjendja aktuale....128
c. Çka duhet bërë...?....128
5 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI....129
a. Sfondi....129
b. Institucionet e përgjegjëse dhe gjendja aktuale....129
c. Çka duhet bërë...?....130
6 2009 SHTOJCAT: TABELAT....131
a. Tabela e legjislacionit....131
b. Tabela e vendimeve politike dhe dokumenteve strategjike....154
c. Tabela e ndërtimit të institucioneve – kapacitetet administrative....171
d. Tabela e ndërtimit të institucioneve – intervenimet strukturore....187
e. Tabela e Nevojave për Prokurim të pajisjeve....194
f. Tabela e Investimeve Kapitale....201
7 TABELA E VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PARTNERITETIT EVROPIAN ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AKR	Aleanca Kosova e Re
AKS	Agjencia Kosovare për Standardizim
AKZHIE	Agjencia për Koordinim të Zhvillimit dhe Integrimit Evropian
AMNVM	Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APIK	Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
APK	Agjencia për Privatizim e Kosovës
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AVUK	Agjencia për Veterinë dhe Ushqim e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPSH	Bruto Produkti Shoqëror
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BQNJ	Byrotë e Qarkut për Ndihmë Juridike
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DK	Doganat e Kosovës
DPISH	Dokumenti Programues Indikativ Shumëvjeçar
ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (*European Common Aviation Area*)
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GjND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
GND	Grupi Ndërministror për Decentralizim

GTZ	Agjencia Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
GZRK	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KELP	Këshilli për Emërime të Larta Publike
KENM	Karta Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPK	Komisioni Prokurorial i Kosovës
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
KPP	Kodi i Përkohshëm Penal
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
KSK	Këshilli i Sigurisë i Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LQMK	Laboratorin Qendror për Metrologji i Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAP	Ministria e Administrates Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MFP	Menaxhimi i Financave Publike

MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (*North Atlantic Treaty Organisation*)
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (*OECD – Organisation for Economic Cooperation and Development*)
OGjM	Organizmat Gjenetikisht të Modifikuar
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PBEJL	Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PIP	Programi i Investimeve Publike
PK	Policia e Kosovës
PNJK	Pilot-Njësitë Komunale
PPP	Partneritet Publik-Privat
PSH	Prokuroria e Shtetit
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PVRMFP	Plani i Veprimit për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike
PZHIT	Plani Zhvillimor dhe Investues i Transmisionit
PZHRB	Plani për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
QITT	Qendra për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim

QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit
RAP	Reforma e Administratës Publikes
RTK	Radio-Televizioni i Kosovës
SEETO	Observatori i Transportit për Evropën Juglindore (*South East Europe Transport Observatory*)
SHCK	Shërbimi Civil i Kosovës
SHPLF	Procesi i zhvillimit të Shpenzimeve Publike dhe Llogaridhënies Financiare
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
TADOC	Akademia Ndërkombëtare për Luftimin e Drogës dhe Krimit të Organizuar
TQNJ	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
UA	Udhëzim Administrativ
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (*United States Agency for International Development*)
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZMAGZ	Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ZPZH	Zyra për Persona të Zhdukur
ZQM	Zyra për Qeverisjes të Mirë
ZRRE	Zyra Rregullatore e Energjisë
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

1 HYRJE

1.1 Raportet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian

1 HYRJE

1.1 Raportet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian

Prej Samitit të Selanikut më 2003, Kosova ka qenë fuqimisht e përfshirë në kornizën e Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit. Më 20 prill 2005, Komisioni Evropian miratoi komunikatën "E ardhmja evropiane për Kosovën", që përforcon edhe më tepër përkushtimin e BE-së ndaj Kosovës. Në vitin 2006, Këshilli Evropian miratoi Partneritetin e parë Evropian dhe më 18 shkurt 2008 Partneritetin e dytë Evropian për Kosovën. Si përgjigje ndaj kësaj, më 31 korrik 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin e veprimit për implementimin e Partneritetit Evropian (PVPE) 2008.

Mekanizmi përcjellës i Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit (MPSA) është bazë për dialogun në mes të BE-së dhe institucioneve kosovare mbi çështjet e integrimit evropian. Si rezultat i intensifikimit të procesit të integrimit evropian, Qeveria e Kosovës, më 27 gusht 2008, ka miratuar strukturat e reja qeveritare me qëllim të koordinimit sa më të mirë të institucioneve në këtë drejtim. Këto struktura përfshijnë grupe punuese sektoriale nën ombrellën e MPSA-së, në fushën e qeverisjes së mirë, ekonomisë, tregut të brendshëm, inovacionit, infrastrukturës dhe bujqësisë.

Bashkimi Evropian vazhdon të sigurojë një ndihmë të konsiderueshme financiare për ndërtimin dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës, nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik, si dhe avancimin e mëtutjeshëm të integrimit rajonal. BE-ja është aktualisht donatori më i madh në Kosovë, që ndan më shumë ndihma për kokë banori krahasuar me secilin vend tjetër të botës.

Instrumenti kryesor i asistencës së donatorëve gjatë periudhës 1999-2006 ka qenë Asistenca e komunitetit për rindërtim, zhvillim dhe stabilizim (CARDS). Më 2007, programi CARDS u zëvendësua me Instrumentin e ndihmës së para-anëtarësimit (IPA). Kosova përfiton nga IPA përmes dy komponentëve të saj: komponenti I – mbështetja për ndërtimin dhe tranzicionin e institucioneve; dhe komponenti II – bashkëpunimi ndërkufitar.

Për periudhën 2007-2009, Komisioni Evropian ka paraparë përkrahjen e Kosovës me 199.1 milionë €. Prioritetet kryesore të programeve të IPA-s për vitet 2007-2009 janë përforcimi i kapaciteteve administrative në të gjitha nivelet, avancimi i sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe qeverisja e mirë, përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike të të gjitha komuniteteve, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit rajonal.

Kosova ende nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Në strategjinë e zhvillimit dhe sfidave 2008 – 2009, Komisioni Evropian ka propozuar, ndërsa Këshilli ka aprovuar, realizimin e studimit të fizibilitetit me qëllim të avancimit të Kosovës drejt integrimit në BE, në kontekstin e procesit të Stabilizimit dhe Asociimit.

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Deklaratën e Pavarësisë, duke hapur kështu një faqe të re në historinë e Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke siguruar gjithashtu një të ardhme të re evropiane për Kosovën dhe të gjithë rajonin.

Procesi i njohjes së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran është në vazhdim e sipër. Kosova është duke zbatuar një agjendë gjithëpërfshirëse dhe komplekse, ku procesi i integrimit evropian po bëhet një proces udhëheqës dhe udhëzues për të gjitha reformat tjera.

Sfida e radhës për Kosovën, në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, është të hyjë në fazën e ardhshme të procesit - në hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit. Sa më shpejt që Kosova arrin progres në zbatimin e rekomandimeve të Partneritetit Evropian, e sidomos në zbatimin e prioriteteve thelbësore dhe atyre afatshkurtra, aq më herët do të hapet dera për Kosovën që të tregojë përkushtimin e saj të plotë për procesin e integrimeve evropiane dhe të hyjë në fazat e ardhshme:

- Komisioni Evropian përgatit dhe paraqet përfundimet e Studimit të Fizibilitetit për hapjen e negociatave për MSA-në me Qeverinë e Kosovës,
- Vendimi i Këshillit për hapjen e negociatave për MSA-në me Qeverinë e Kosovës dhe KE-së për përgatitjen e qëndrimeve në negociata,
- Hapja zyrtare e negociatave për MSA,
- Negociatat për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale përmes MSA-së,
- Dhe më vonë aplikimi për anëtarësim,
- Përgjigjet në pyetësorë,
- Statusi i kandidatit dhe fillimi i përgatitjeve për fazën përfundimtare,
- Hapja e negociatave për anëtarësim,
- Përfundimi i negociatave,
- Nënshkrimi i Traktatit me Bashkimin Evropian dhe kalimi në procedurën e ratifikimit.

1.2 Pregaditja e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE 2009)

Disa faktorë të rëndësishëm janë marrë parasysh në përgatitjen e Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian 2009:

- Pavarësia e Kosovës dhe zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
- Struktura e re institucionale evropiane/ndërkombëtare e vendosur në Kosovë (ZCN/ZPBE, EULEX,)
- Ndikimi i Raportit të fundit të Progresit (Nëntor 2008) nga Komisioni Evropian mbi arritjet dhe sfidat e Kosovës,
- Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidave 2008 – 2009 nga Komisioni Evropian,
- Konkluzionet e takimeve që zhvillohen brenda procesit të MPSA-së, si dhe të gjeturat e Misioneve Homologe Vlerësuese të realizuara gjatë vitit 2008,
- Nevojat në lidhje me rishqyrtimin e prioriteteve në lidhje me shfrytëzimin e Ndihmës së Donatorëve në përputhje me rekomandimet e Partneritetit Evropian dhe qasjen e strukturuar me ndarje të qartë mes AIE-së dhe QKD,
- Pjesëmarrja në zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për trajnime dhe Strategji dhe Planit të Veprimit për Informim dhe Komunikim.

Për më tepër, puna e institucioneve të Kosovës do të udhëzohet në të gjitha fushat e rëndësishme nga disa dokumente zyrtare të përgatitura dhe miratuara nga Qeveria:

- Programi i Qeverisë për periudhën 2008-2011,

- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010 – 2012,
- Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2009,
- Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2009,
- Plani për Integrim Evropian të Kosovës 2008-2010, miratuar nga Qeveria më 3 prill 2008.

1.3 Synimet e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian

Duke u bazuar në agjendën evropiane për Kosovën, çdo përparim i mëtutjeshëm i vendit do të matet në bazë të zbatimit të prioriteteve thelbësore, afatshkurtra dhe afatmesme, në kuadër të Partneritetit Evropian. Në këtë kontekst, PVPE duhet të përdoret për planifikimin e veprimtarisë së Qeverisë:

- Në lidhje me agjendën politike të Qeverisë dhe prioriteteve të saj,
- Agjendën legjislative të Qeverisë (ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe akte tjera ligjore) si dhe Kuvendit,
- Planin e punësimit të nevojshëm për zbatimin e agjendës së integrimeve evropiane dhe zbatimin e akteve të harmonizuara ligjore,
- Planin për ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit (nevojat për trajnime të përgjithshme dhe specifike),
- Planin për investime e sidomos për ndërtimin (avancimin) e rrjetit të TI në lidhje me Acquis.

Tutje, Plani i Veprimit mund/duhet të shfrytëzohet për komunikimin e brendshëm:

- Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë (mirëkuptimi i përbashkët i agjendës qeveritare dhe rezultateve që duhen arritur),
- Ministrave dhe stafit të tyre (udhëzime të qarta me caqe të matshme),
- Marrëdhëniet në mes të organeve qeveritare (një plan dhe të njëjtat afate),
- Qeverisë dhe komunitetit afarist dhe partnerëve socialë (mekanizëm paralajmërues për ndryshimet që do të ndodhin dhe do të prekin komunitetin afarist dhe partnerët socialë),
- Marrëdhëniet me sektorin e OJQ-ve (baza për ndërtimin e partneritetit)
- Komunikimin me media (agjendë e qartë e Qeverisë që mund të matet edhe nga mediat)
- Si dhe me publikun e gjerë, gjithë qytetarët, (qytetarët që duan mund të masin në çdo kohë se sa e suksesshme ka qenë Qeveria)

… si dhe për komunikim të jashtëm:

- Komunikim me bashkësinë ndërkombëtare dhe për kuptim më të mirë të prioriteteve të Kosovës (prioritete dhe agjendë qeveritare të qartë dhe të paraqitur publikisht),
- Marrëdhëniet me Komisionin Evropian dhe shërbimet e tij (gjithmonë e nevojshme për qëllime të monitorimit dhe paraqitjes së pasqyrës së qartë për përparimin e arritur),
- Me të gjitha shtetet anëtare të BE-së (të mos harrohet që të gjitha vendimet e rëndësishme merren nga ato),
- Me fqinjët e Kosovës (të gjithë në rajon janë dhe do të ndjekin shumë, afërsisht atë që Kosova bën, planifikon dhe arrin),
- Me sektorin akademik dhe joqeveritar evropian dhe publikun e gjerë (Kosova ka nevojë për gjithë mbështetjen që mund ta marrë nga një mjedis sa më i gjerë që është e mundur).

1.4 Përmbajtja e Planit të Veprimit

Programi ndjek strukturën e Partneritetit Evropian për Kosovën 2008 si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit, duke përfshirë kështu këto pjesë:

- Kriteret politike,
- Kriteret ekonomike,

- Standardet evropiane,
- Reformat e administratës publike dhe kapacitetet administrative,
- Përkthimi i Acquis në gjuhët zyrtare të Kosovës,
- Informatat dhe komunikimet,
- Shtojcat, si dhe
- Monitorimi dhe raportimit në bazë të PVPE-së dhe Revizionit të Programit.

Përmbajtja dhe struktura e pjesës mbi kriteret politike dhe standardet evropiane – është paraqitur në renditjen si në vijim:

- Korniza ligjore - përshkruan kontekstin ligjor brenda secilës fushë;
- Korniza institucionale – përshkruan kontekstin institucional brenda secilës fushë;
- Prioritetet afatshkurtra – përshkruajnë veprimet që do të zbatohen *vis-a-vis* prioriteteve afatshkurtra brenda secilës fushë;
- Prioritetet afatmesme – përshkruajnë veprimet që do të zbatohen *vis-a-vis* prioriteteve afatmesme brenda secilës fushë.

Prioritetet e Partneritetit Evropian janë ndarë në prioritete afatshkurtra (1-2 vite) dhe prioritete afatmesme (3-4 vjet).

Përmbajtja dhe struktura e pjesës së dytë – kriteret ekonomike – vlerësojnë të gjitha kriteret ekonomike, reformat e planifikuara ekonomike dhe dinamikën e tyre.

Reformat e administratës publike dhe kapacitetet administrative, ose aftësia për zbatimin e Acquis në pajtim me standardet apo praktikat më të mira në Shtetet Anëtare, përmban një pasqyrë të përgjithshme të reformës së administratës publike (përshkrimi i kornizës ligjore me shqyrtimin e akteve të reja ligjore si dhe një shqyrtim të politikave dhe strategjive për përmirësimin e kapaciteteve administrative).

Një pjesë e veçantë e PVPE-së i kushtohet procesit të përkthimit të Acquis Communitare në gjuhët zyrtare të Kosovës, ku është përshkruar zhvillimi i sistemit të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe ndërtimit të kapaciteteve dhe resurseve.

Së fundmi, por mjaft me rëndësi, është edhe pjesa që përshkruan aktivitetet e Qeverisë në lidhje me implementimin e Strategjisë për informim dhe komunikim mbi procesin e integrimit evropian, duke pasur për synim publikun e brendshëm dhe të jashtëm, metodat dhe mënyrat e qasjes së zyrtarëve publikë, vendim-marrësve, administratës, studentëve, gazetarëve si dhe publikut më të gjerë të mundshëm si konsumues të informacionit.

Kalkulimi financiar i veprimeve në PVPE-në e reviduar 2009 nuk është bërë në këtë fazë, pasi që AKZHIE ka hartuar metodologjinë përfshirjen e veprimeve nga PVPE në KASH dhe Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe në këtë drejtim me vendim të Qeverisë nr??? është themeluar grupi punues për implikime financiare i cili do të jetë mekanizërm kryesor financiar për kalkulimin e veprimeve brenda PVPE-së dhe përfshirjen e tyre brenda KASH-it, buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe identifikimit të veprimeve që kërkojnë të financohen nga donatorët e mundshëm. I tërë ky sistem do të siguroj që PVPE-ja të jetë një dokument sa më strategjik dhe sa më i mundshëm për tu zbatuar.

1.5 Shtojcat/llojet e aktiviteteve

Shtojcat përmbajnë të dhënat e pranuara nga institucionet kompetente gjatë përgatitjes së Planit dhe reflektojnë nivelin dhe shkallën e kuptimit të procesit kompleks të integrimit evropian dhe *acquis*

communitare si dhe pasojat e tyre ligjore. Lëvizjet pozitive janë evidente kur krahasohen planet e mëparshme të veprimit të përgatitura nga e njëjta administratë në Kosovë.

a. Tabela e legjislacionit

Kjotabelë ofron një pasqyrë të legjislacionit vendor si atë primar dhe sekondar që janë planifikuar të miratohen gjatë periudhës raportuese duke u bazuar në dokumentet strategjike të institucioneve përkatëse.

b. Tabela e vendimeve politike dhe dokumenteve strategjike

Kjo tabelë ofron një pasqyrë të të gjitha veprimeve për të cilat duhet marr vendim politik nga Parlamentit, Qeverisë apo nëse ka nevojë për marrëveshje ndër-partiake apo marrëveshje ndërkombëtare. Gjitashtu kjo tabelë reflekton planet e Qeverisë së Kosovës në lidhje me dokumentet strategjike që duhet hartuar dhe miratuar gjatë periudhës raportuese.

Këto tabela ofrojnë një pasqyrë të ndryshimeve të nevojshme institucionale (themelimi i institucioneve të reja, riorganizimi i atyre ekzistuese, Departamente të reja, Njësi të reja), ose përforcim institucional i institucioneve (punësime të reja), të paraqitura në kapituj standardë evropianë dhe sipas viteve (kudo që është e mundur).

c. Tabela e ndërtimit të institucioneve – kapacitetet administrative

Kjo Tabelë përmban një pasqyrë të identifikimit të nevojave për përforcimin e institucioneve përmes punësimit të stafit shtesë dhe trajnimeve të nevojshme për funksionim të mirëfilltë të institucioneve egzistuese dhe atyre në krijim e sipër sipas standardeve evropiane. Kjo Tabelë është baza fillestare për analiza të mëtutjeshme për hartimin e planeve dhe programeve precize të trajnimit.

d. Tabela e ndërtimit të institucioneve –intervenimet strukturore

Kjo tabelë ofron një pasqyrë të ndryshimeve të nevojshme institucionale (themelimi i institucioneve të reja, riorganizimi i atyre ekzistuese, departamente të reja, njësi të reja dhe strukturave tjera të karakterit qendror apo lokal).

e. Tabela e nevojave për prokurim të pajisjeve

Kjo shtojcë ofron një pasqyrë të nevojave prokurimin e pajisjeve të nevojshme si ato që dalin nga legjislacioni evropian si psh. Pajisjet e nevojshme laboratorike për kontrollin e cilësisë së ushqimit, , prokurimi i pajisjeve të teknologjisë informative dhe pajisjeve të ngjajshme për zyre.

f. Tabela e investimeve kapitale

Kjo tabelë paraqet investimet kapitale (projektet infrastrukturore, ndërtimi i ndërtesave, blerja e ndërtesave, etj.) sipas projekteve, të ndara sipas strukturës së PVPE-së.

1.6 Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i PVPE-së

AKZHIE është duke e finalizuar sistemin e avancuar të monitorimit dhe raportimit të PVPE-së dhe kërkesave tjera që dalin nga procesi i integrimit evropian dhe ky sistem do të ndihmoj Qeverinë e

Kosovës në sigurimin e të dhënave të sakta dhe në matjen e progresit dhe identifikimin e sfidave/problemeve që dalin nga ky proces dhe që kërkon adresimin në instancat më të larta qeveritare. Ky sistem do ti ndihmoj Kryeministrit në marrjen e vendimeve dhe për raportim automatik për Komision Evropian.

Monitorimi i Planit të Veprimit do të jetë shumë strikt:

- AKZHIE do të përgatisë një herë në muaj (në fillim deri në mes të muajit) një raport të shkurtër për Kryeministrin (dhe Qeverinë). Kjo duhet konsideruar si sistem i paralajmërimit të hershëm nëse implementimi po shkon mirë apo ka nevojë për intervenim nga ana e Kryeministrit.
- Raporti i shkurtër do të përgatitet nga AKZHIE çdo tremujor për Qeverinë (sa më i hollësishëm që është e mundur, duke u përqendruar në fushat problematike me rekomandime për qasjen ndaj tyre me përpjekje të shtuara) si dhe për Komisionin Evropian në mënyrë më të gjerë (jo aq të hollësishëm) të përqendruar rezultatet e arritura dhe duke theksuar fushat ku nevojitet ndihmë/intervenim më i madh nga ana e komunitetit ndërkombëtar.
- Çdo gjashtë muaj (në qershor dhe shtator), AKZHIE do të përgatisë, ndërsa Qeveria të shqyrtojë dhe miratojë, një Raport më të gjatë dhe më të hollësishëm për Progresin në implementimin e rekomandimeve të Partneritetit Evropian.
- Mekanizmi monitorues dhe Raportet mund të jenë shumë të dobishme për të përgatitur më mirë të gjitha takimet me Komisionin Evropian si dhe aktorët tjerë ndërkombëtarë dhe për të shfaqur përparimin në arritjen e qëllimeve (në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt).

PVPE-ja do të shqyrtohet çdo vit, me qëllim të azhurnimit dhe avancimit të tij, në pajtim me raportet vjetore të progresit të Kosovës nga Komisioni Evropian dhe dialogut tw vazhdueshwm qw Qeveria e Kosovws e zhvillon me Komisionin Evropian.

2 KOMPONENTI NARRATIV I PVPE-SË 2009

2.1 KRITERET POLITIKE

2.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

a. Kushtetuta

Kushtetuta e Kosovës është miratuar nga Komisioni Kushtetues dhe është certifikuar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil në Kosovë. Kuvendi ka miratuar Kushtetutën në një seancë të veçantë më 9 prill dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.
Kushtetuta e Kosovës konsiderohet të jetë një nga kushtetutat më moderne demokratike, e cila përqafon në kapitujt e saj të drejtat themelore dhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të saj. Kushtetuta përbëhet nga kapitujt që përfshijnë: Preambulën, dispozitat themelore, të drejtat dhe liritë themelore, të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kryetari i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, sistemi gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, marrëdhëniet ekonomike, qeverisja lokale dhe organizimi territorial, sektori i sigurisë, institucionet e pavarura, dispozitat përfundimtare, si dhe dispozitat kalimtare.

b. Kuvendi

Në procesin e përafrimit të Republikës së Kosovës me anëtarësimin në BE dhe përafrimin e legjislacionit me *Acquis communautaire*, Kuvendi, në kapacitetin e tij si pushtet legjislativ, përfaqëson një faktor të rëndësishëm në përcaktimin e dinamikës së përmbushjes së standardeve të domosdoshme për hyrje në BE.

Rregullorja e Punës së Kuvendit e datës 20 maj 2005, e ndryshuar më 1 qershor 2006 përcakton hollësisht procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve dhe akteve tjera. Rregullorja e Punës gjithashtu përcakton instrumentet dhe procedurën përmes të cilës Kuvendi ushtron kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi veprimet e organeve të pushtetit ekzekutiv, si dhe çështjet tjera që dalin nga kompetencat e Kuvendit, siç janë emërimi dhe shkarkimi i Presidentit të Kosovës, miratimi i gjykatësve dhe prokurorëve, etj. Për të siguruar funksionimin efektiv të këtij rendi ligjor parashikohet fuqizimi i plotë i Rregullores së Punës së Kuvendit.

Duke marrë parasysh realitetin e ri, të krijuar në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, është themeluar Grupi Punues për hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit i cila rregullore pritet të miratohet gjatë muajt qershor të vitit 2009.

Kuvendi punon sipas programit vjetor të punës, ku para çdo seance plenare publikohet kalendarit dy-javor i punës. Komisionet parlamentare punojnë sipas planeve tre-mujore, gjashtë-mujore dhe vjetore të punës.

Koncentrimi i veprimtarisë së Kuvendit në Komisione siguron diskutime gjithëpërfshirëse eksperte në legjislaturë. Dy Komisione kryesore dhe disa funksionale shqyrtojnë mocionet për miratimin e ligjeve, drafteve dhe propozimeve, si dhe akteve tjera të përgjithshme të propozuara për miratim nga Kuvendi, si dhe çështjet tjera brenda fushëveprimit të Kuvendit. Komisionet sigurojnë përfaqësim të barabartë të anëtarëve të Kuvendit nga grupet parlamentare, si dhe të atyre deputetëve që nuk janë të organizuar nëpër grupe. Sipas Rregullores së Punës në fuqi, seancat plenare dhe seancat e komisioneve janë të hapura për publikun. Megjithatë, procesi i rishqyrtimit të transparencës së Kuvendit për të siguruar përgjegjshmërinë dhe hapjen e tij është në agjendë, duke vënë raportet tremujore mbi shpenzimet e Kuvendit dhe publikimit të konkludimeve nga takimet e Komisioneve Parlamentare.

Brenda kornizës së procesit të integrimeve evropiane, Kuvendi ka funksionin e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv, përmes raporteve tremujore mbi aktivitetet e ndërmarra brenda procesit të integrimeve evropiane që Qeveria i paraqet Kuvendit. Bashkërendimi mes këtyre dyjave do të përforcohet edhe më shumë duke vendosur persona kontakti dhe duke vendosur kontaktet e rregullta të Kryeministrit dhe Ministrave.

Me qëllim të ofrimit të mbështetjes aktive ndaj procesit të integrimeve evropiane të Republikës së Kosovës, në shkurt 2008, Kuvendi ka themeluar Komisionin për Integrime Evropiane (KIE), i cili ka mbajtur seanca të rregullta qysh prej themelimit të tij. KIE përbëhet nga përfaqësues të gjitha partive politike parlamentare, duke reflektuar strukturën e Kuvendit me qëllimin e sigurimit të mbështetjes së plotë mbi vendimet në lidhje me BE-në.

KIE është pararojë e respektimit të *Acquis* nga momenti i hyrjes së projekt-ligjeve në Kuvend. Komisioni diskuton çështjet në lidhje me:

- Përputhshmërinë e propozimeve për miratimin e ligjeve, pra projekt-ligjeve me legjislacionin evropian;
- Monitorimi i procesit të harmonizimit të legjislacionit kosovar me *Acquis communautaire*;
- Shqyrtimi i projektligjeve të iniciuara për miratim nga Kuvendi në kuptimin e përafrimit të legjislacionit me *Acquis communautaire*;
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me institucionet e BE-së në kuptimin e integrimit dhe anëtarësisë në BE;
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me shtetet anëtare të BE-së.

Kapaciteti administrativ i Kuvendit është adekuat për sfidat aktuale. Megjithatë, angazhimi i vazhdueshëm i personelit shtesë si dhe trajnimit të tij vazhdon të mbetet prioritet.

c. Zgjedhjet

Sipas dispozitave të Marrëveshjes për Zgjidhjen e Statusit, si dhe duke marrë parasysh statusin sovran të Republikës së Kosovës, Kuvendi ka marrë përsipër miratimin e legjislacionit plotësisht të ri mbi zgjedhjet, duke u bazuar në tri ligje bazë: ligjin "mbi zgjedhjet e përgjithshme," ligjin "mbi zgjedhjet lokale," si dhe ligjin "mbi Komisionin Qendror Zgjedhor".

Me 14 maj 2009, Presidenti ka emëruar Kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), ndërsa me 19 maj është zgjedhur kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së.

Zgjedhjet Lokale do të mbahen me 15. Nëntor 2009 KQZ, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL) dhe komunat, ka hartuar dhe nënshkruar, gjatë marsit 2009, një Marrëveshje Mirëkuptimi për zbatimin e ligjit "për zgjedhjet lokale dhe përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme lokale.

KQZ është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/9, dhe është përgjegjëse për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë. Roli i KQZ-së është ta rregullojë procesin zgjedhor përmes miratimit të rregullave zgjedhore, si dhe të mbikëqyrë të gjitha aspektet e procesit për të siguruar që zgjedhjet të plotësojnë standardet ndërkombëtare. KQZ-ja mbetet e aftë të ndërmarrë aktivitetet e saja në aspektin e organizimit të përgjithshëm të zgjedhjeve në Kosovë, duke u përqendruar në certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve në procesin e zgjedhjeve, akreditimin e vëzhguesve në zgjedhje, emërimin dhe trajnimin e Këshillave të Vendvotimeve. KQZ-ja është e përkushtuar të themelojë këshillat e veta mbi buxhetin, prokurimin, personelin dhe procedurat zgjedhore, udhëzimet dhe procedurat administrative.

d. Qeveria

Qeveria e Republikës së Kosovës e krijuar nga koalicioni PDK dhe LDK me partnerë të tjerë, vjen si rezultat i zgjedhjeve parlamentare, të mbajtura në Nëntor 2007 dhe rrjedh nga nevoja e krijimit të një klimë të re pozitive, konsensuale, moderne dhe të një menaxhimi të suksesshëm të proceseve për një të ardhme më të mirë, për një të ardhme evropiane.

Qeveria funksionon në përputhje me parimet demokratike, evropiane dhe multietnike në funksion të respektimit të vullnetit të qytetarëve, të shprehur nëpërmes votës së lirë.

Qeveria gjatë vitit 2008 ka realizuar reforma të gjithanshme politiko-shoqërore, që synon një zhvillim ekonomik të qëndrueshme, sundimin të ligjit, shoqërie shumë-etnik, dhe të përkushtuar qartë në drejtim të proceseve për Integrim Evropian, Euro-Atlantik dhe mekanizma tjerë ndërkombëtar, nëpërmjet përmbushjes së kushteve dhe standardeve më të larta të përgjegjësisë dhe të transparencës.

Qeveria ka shënuar progres në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët politikë dhe shoqëror, duke përfshirë shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, institucionet akademike dhe partnerët ndërkombëtarë.

Qeveria ka arritur të tejkaloj sfidën më të rëndësishme në historinë e Popullit të Kosovës, duke i përmbyllur ambiciet shekullore për liri dhe pavarësi dhe duke përfaqësuar e respektuar vullnetin e popullit me shpalljen e Kosovës si shtet i pavarur, sovran dhe demokratik.

Pavarësia, si e vetmja zgjidhje për Popullin e Kosovës, në interes të paqes dhe stabilitetit në vend dhe në rajon, është arritur me një bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare dhe me përkrahjen e tyre të fuqishëm.

Qeveria ka drejtuar procesin e shpalljes se pavarësisë dhe festimet më pas, ku Populli i Kosovës ka treguar një pjekuri të jashtëzakonshme duke festuar realizimin e vullnetit të tij në mënyrë shumë të dinjitetshme. Kjo dëshmoi para botës që Kosova është një shtet me një popull të përgjegjshëm, si pjesë botës së qytetëruar.

Qeveria angazhohet vazhdimisht në lobimin pë njohje të reja të shtetit të ri të Republikës së Kosovës, njohja nënkupton ndër të tjera edhe mundësinë e bashkëpunimet në nivel shtetëror dhe nevojën e funksionalizimit të institucioneve vendore, gjë që Qeveria e ka realizuar duke ngritur kapacitetet e Ministrive dhe të administratës publike.

Deri më tani Pavarësinë e Kosovës e kanë njohur zyrtarisht 62* Shtete Anëtare të Kombeve të Bashkuara, prej të cilave 22 janë Shtete Anëtare të BE-së.

Me 15 Qershor 2008 hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila përfshinë edhe legjislacionin nga pakoja e Ahtisaarit. Të gjitha proceset zhvillimore politike dhe shoqërore janë të bazuara në parimet dhe dispozitat e Kushtetutës, duke garantuar sovranitetin territorial dhe barazinë para ligjit të të gjithë qytetarëve.

Vullneti, synimi dhe destinacioni përfundimtar i Republikës së Kosovës është Bashkimi Evropian. Synimi që Republika e Kosovës të jetë pjesë e BE-së buron nga konsensusi i gjerë publik që kërkon angazhim serioz të institucioneve Qeveritare në kuadër të procesit formal të para-anëtarësimit dhe për sigurimin e statusit të Vendit Kandidat.

---

* Deri më 15 korrik 2009

Si rezultat i punës së Qeverisë, BE-ja konfirmon hapin e parë të Kosovës drejt Bashkimit Evropian, që është Studimi i Fizibilitetit, i cili pritet të përfundojë në vjeshtë të vitit 2009. Në kuadër të përkushtimit të Qeverisë për Integrim në BE, do të vazhdojë konsolidimi e institucioneve qeveritare për të përmbushur kriteret e Kopenhagës: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet Evropiane.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aplikuar politika që synojnë: rritjen ekonomike, uljen e shkallës së papunësisë, përmirësimin e kushteve sociale dhe zvogëlimin e varfërisë. Në mënyrë që të jetë konkurruese me vendet e rajonit, Qeveria ka punuar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Prioritet i Qeverisë është sundimi i ligjit dhe në veçanti përmirësimi i efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe luftimi dukurive negative si korrupsionit, krimit të organizuar dhe të ekonomisë joformale në tërësi.

Në kuadër detyrimeve Kushtetuese një vëmendje e veçantë i është kushtuar decentralizimit, fushës së sigurisë dhe krijimit të institucioneve të reja dhe minoriteteve. Zbatimi i procesit të decentralizimit vazhdon të jetë në agjendën e Qeverisë si një program ambicioz me përfitime të shumëfishta për popullin e Kosovës.

Të drejtat e komuniteteve dhe kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit, janë çështje vitale në harmonizimin e strukturave sociale në Kosovën e pavarur.

Themelimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe të Forcave të Sigurisë janë hapa vendimtar në historinë moderne të forcave të armatosura dhe një arritje e standardeve bashkëkohore. Arritja e këtyre standardeve do të krijojë bazë të sigurt për integrimin e plotë të Kosovës në strukturat euro-atlantike.

Me qëllim të intensifikimit të marrëdhënieve diplomatike, Qeveria ka themeluar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe është në proces të vendosjes së marrëdhenieve diplomatike me vendet që e kanë njohur. Themelimi i marrëdhënieve diplomatike me partnerët kryesorë ndërkombëtarë, vazhdon të jetë një ndër aktivitetet kryesore të Qeverisë.

Përshtatja e politikave të Qeverisë me ato të BE-së është një proces i domosdoshëm për të siguruar synimin afatgjatë të Qeverisë por njëherazi edhe aspiratën e popullit të Kosovës për integrimin evropian.

e. Administrata publike

Në përputhje me vendimin e Qeverisë, nr. 04/63 dt. 7 maj 2009 për miratimin e rekomandimeve të dala nga procesi i rishikimit funksional dhe organizimit institucional si dhe vendimit nr. M-MAP-V 53/2009, nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, me 27 maj 2009 Ministria e Shërbimeve Publike është transformuar në Ministri të Administratës Publike (MAP).

Administrata shtetërore e Kosovës, përkatësisht Shërbimi Civil i saj, ende është duke funksionuar në bazë të infrastrukturës ligjore të hartuar nga UNMIK-u. Me ndryshimet socio-politike dhe ekonomike në Kosovë është paraqitur nevoja e reformimit të Administratës me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarë dhe biznese. Reformimi përfshinë ndërrmin e infrastrukturës ligjore, ngritjen e kapaciteteve administrative dhe avancimin teknologjik të funksionimit të administratës. Procesi i Reformës është ndër prioritetet kryesore të Qeverisë që ndërlidhet me objektivin qeveritar për krijimin e një Administrate moderne, funksionale, profesionale, politikisht neutrale dhe të përgjegjshme përballë

kërkesave dhe nevojave të qytetarëve me qëllimin final drejt ndërtimit të një Shteti Ligjor dhe Demokratik.

Me qëllim të koordinimit të punës për zbatimin e Planit të Veprimit për Reformën e Administratës Publike është themeluar Grupi Punues me Nën-grupet e veta Punuese, të cilat janë formuar në bazë të fushave si në vijim: 1. Burimet Njerëzore, Struktura Organizative e Institucioneve dhe Menaxhimi i Administratës Publike, 2. Komunikimi me qytetarë, 3. E-Qeverisja, 4. Financimi i Administratës Publike, 5. Kundërkorrupsioni dhe 6. Politikat dhe Legjislacioni.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së administratës publike është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative e cila rregullon këtë sektor. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- Rregullorja e UNMIK-ut mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë nr. 2001/19 (ndryshuar me Rregulloret nr. 2002/5; 2005/15; 2005/53; 2006/19; nr. 2007/18; 2008/3 dhe 2008/20);
- Rregullorja e UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil nr. 2001/36 (ndryshuar me Rregulloret nr. 2006/20; 2008/12);
- Urdhëresa Administrative nr. 2001/14 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut për degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë nr. 2001/19;
- Urdhëresa Administrative nr. 2003/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil nr. 2001/36.

Për zbatimin e katër akteve ligjore të lartcekura , Ministria e Administratës Publike ka hartuar edhe 12 akte nënligjore si mëposhtë:

1. UA nr. MAP/DASHC 2003/01 për procedurat e Rekrutimit
2. UA nr. MAP/DASHC 2003/02 për procedurat e Kontratave
3. UA nr. MAP/DASHC 2003/03 për procedurat e Periudhës Provuese
4. UA nr. MAP/DASHC 2003/04 për procedurat e Disiplinës
5. UA nr. MAP/DASHC 2003/05 për procedurat e Ankesave
6. UA nr. MAP/DASHC 2003/06 për procedurat e Ndërprerjes së Marrëdhënies së Punës
7. UA nr. MAP/DASHC 2003/07 për procedurat e Përshkrimit të Detyrave të Punës
8. UA nr. MAP/DASHC 2003/08 për procedurat e Vlerësimit të Kryerjes së Punës
9. UA nr. MAP/DASHC 2003/09 për procedurat e Orëve të Punës dhe Vijimit në Punë
10. UA nr. MAP/DASHC 2003/10 për procedurat e Pushimeve
11. UA nr. MAP/DASHC 2003/11 për procedurat e Dosjeve të Personelit
12. UA nr. MAP/DASHC 2003/12 për procedurat e Mundësive të Barabarta
13. UAnr. MAP 2006/08 për masat për shtimin e efikasitetit në Administratën Publike
14. UA nr. MAP 2006/12 për masat për ngrirjen e punësimit të nëpunësve civilë në organet e administratës publike
15. UA nr. MAP 2008/04 për veshjen dhe paraqitjen e Nëpunësve Civilë.

Aktualisht, Reforma e Administratës Publike bazohet në tri dokumente strategjike:
1. Raporti për gjendjen e Administratës Publike në Kosovë,
2. Strategjia për Reformën e Administratës Publike në Kosovë, si dhe
3. Plani i Veprimit të Reformës së Administratës Publike në Kosovë.

Ndërkohë, Plani i Veprimit të Reformës së Administratës Publike ka sjellur strategji tjera sektoriale të dedikuara fushave të caktuara, si:

- Strategjia për e-Qeverisje 2009-2015; e cila është aprovuar nga Qeveria me vendim nr. 09/47 me 12/12/2008.
- Strategjia për Komunikim me Qytetarë; e cila me 3 Mars 2009 është miratuar nga ministri i MAP-së. Kjo Strategji ka për qëllim promovimin e Reformës së Administratës Publike, nxitjen e aktorëve kryesor të institucioneve për një këmbëngulësi në zbatimin e Planit të Veprimit të RAP dhe informimin e opinionit publik dhe organizatave jo qeveritare, shoqërisë civile lidhur me procesin e RAP në përgjithësi.

Korniza institucionale

Ministria e Administratës Publike,institucion bartës kryesor për Reformën e Administratës Publike dhe funksionimin e Shërbimit Civil, përbëhet nga shtatë departamente:

1. Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil;
2. Departamenti i Teknologjisë Informative;
3. Departamenti i Shërbimeve të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave;
4. Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve;
5. Departamenti Ligjor;
6. Departamenti i Prokurimit;
7. Departamenti i Administratës Qendrore.

Poashtu pjesë përbërëse e MAP-së janë tre Agjenci:

1 Instituti i Kosovës për Administratë Publike;
2 Enti i Statistikave të Kosovës dhe
3 Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Prioritetet afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra në fushën e administratës publike, MAP ka paraparë veprimet si në vijim:

- Zbatimin e strategjisë dhe planit të RAP-it;
- Freskimin e e-portalit shtetëror me shërbime elektronike;
- Dizajnimin e aplikacioneve bazike për shërbime të ndryshme për qytetarë;
- Hartimin dhe miratimin e projektligjit mbi Qeverinë e Kosovës dhe Zbatimi e Tij;
- Hartimin e projektligjit për organet e adminsitratës publike;
- Mbikëqyrja e nivelit qendror dhe lokal të Shërbimit Civil të Kosovës në lidhje me përfaqësimin e minoriteteve në të gjitha institucionet dhe shërbimet publike; Inkurajimi i vazhdueshëm i të gjitha minoriteteve për të aplikuar për punë, si në institucionet qendrore ashtu edhe në ato lokale, përmes shpalljes së konkurseve publike në mediat shqip dhe ato serbe; Finalizimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore për nëpunësit civilë, përmes modulit të përfaqësimit të komuniteteve në institucionet qeveritare; Krijmi i politikave të punësimit me qëllim të inkurajimit të pjesëtarëve të minoriteteve përmes zbatimit të masave afirmative në rekrutim, me qëllim të ngritjes së përfaqësimit të minoriteteve në institucionet e Kosovës; Raportimi në baza tre-mujore mbi përfaqësimin e minoriteteve në të gjitha institucionet e SHCK-së; Monitorimi i shpalljes se konkurseve për vende të lira të punës në mjetet e informimit, gazeta dhe radiostacione në gjuhët zyrtare; Shpërndarja e konkurseve nëpër zyrat komunale për komunitete (në të gjitha komunat);
- Rishikimin horizontal dhe vertikal të strukturave organizative të institucioneve dhe miratimi i strukturës së propozuar, etj.

Prioritetet afatmesme

Me qëllim të adresimit të prioriteteve afatmesme, MAP ka paraparë veprimet si në vijim:

- Koordinimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të "Reformës së administratën publike" (RAP);
- Aprovimin e PVRAP-it të rishikuar;
- Vazhdimin e implementimit të RAP-it përmes mekanizmave të krijuar, përmes funksionimit të rregullt të grupit dhe nëngrupeve punuese për zbatimin e planit të veprimit për RAP-in;
- Hartimin e procedurave dhe udhëzimeve, të thjeshta dhe të kuptueshme, lidhur me ofrimin e shërbimeve për qytetarë dhe biznese nga institucionet qeveritare dhe publikimi i informatorëve lidhur me këto procedura;
- Zbatimin e Strategjisë për komunikimin e reformës së administratës Publike;
- Hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për e-Qeverisje, ku kjo e fundit tanimë është aprovuar nga Qeveria.
- Gjatë implementimit të RAP-it të bashkëpunohet ngusht me MEF-in me qëllim të sigurimit të mbështjetjes financiare për secilin veprim;
- Analiza e funksionalitetit të AKK dhe ZKK-ve përfshirë edhe vlersimin e nevojave për funksionim me efikas; Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve në fushat përkatëse e personelit teknik dhe ligjor të AKK dhe ZKK-ve; Funksionalizimi i sistemit të raportimit vertikal dhe horizontal të AKK përkatsisht ZKK-ve;
- Miratimin dhe Zbatimi i Strategjisë së Kadastrit; Përfshirja e Shërbimeve Kasdastrale ekzistuese elektronike në e-portalin shtetëror dhe Monitorimi i shitblerjeve të pronave të patundshme për t'u siguruar që të parandalohen në mënyrë efektive praktikat mashtruese të regjistrimit

f. Qeverisja lokale/decentralizimi

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/50, me 2 dhjetor të vitit 2004. Përgjegjësitë e Ministrisë janë përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, KREU 5 Pika 2, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 mbi degën e Ekzekutivit të iPVQ-ve; Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 shtojca XIV, dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2007/18 për ndryshimin e Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të IPVQ-ve në Kosovë.

Synimet e MAPL-së janë që në bashkëpunim me komunat të bëjë avancimin e qeverisjes lokale dhe ate nëpërmjet koordinimit, fuqizimit dhe asistencës me qëllim të sigurimit të një shërbimi të përgjegjshëm dhe efektiv në nivel lokal dhe sa më afër qytetarëve.

Korniza ligjore

Qeverisja lokale në Kosovë administrohet në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme që rregullojnë përgjegjësitë e autoriteteve lokale dhe qendrore. Baza ligjore për pushtetin lokal deri në fundin e vitit 2007 ka qenë e rregulluar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave te Kosovës, ndërsa në fund të vitit 2007, rregullorja nr. 2000/45 është zëvendësuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/30 mbi vetëqeverisjen komunale në Kosovë. Në pajtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, përmes rregullores 2007/30, parashihen një numër përgjegjësish në menaxhim dhe rregullativë. Konkretisht, synimet kryesore strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë: rritja e kapaciteteve fiskale, konsolidimi i kornizës afatmesme dhe strategjia për zhvillimin e qeverisjes lokale, rritja e kapaciteteve komunale përmes koordinimit të ndihmës së donatorëve si dhe përmes definimit të kompetencave për shërbimet publike komunale.

Një prej prioriteteve kryesore të Qeverisë është reforma e vetëqeverisjes lokale. Në këtë mënyrë, MAPL ka paraparë hartimin e legjislacionit primar që lidhet me pushtetin lokal, detyrë e dalur nga Dokumenti Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës si dhe hartimi i legjislacionit sekondar (akteve nënligjore, konkretisht udhëzimeve administrative) për konkretizimin e legjislacionit primar, forcimin e

ligjshmërisë dhe rritjes së efektshmërisë së punës së komunave, sipas ndryshimit të sistemit të qeverisjes lokale në Kosovës sipas rregullores 2007/30, "mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës", dhe udhëzimeve dhe rekomandimeve ligjore për komunat.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2008 ka hartuar këto ligje:
Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040. - Ky ligj themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror, Qyteti i Prishtinës, si kryeqytet i Republikës së Kosovës do të qeveriset përmes një ligji të ri për Qytetin e Prishtinës. Ligji mbi vetëqeverisjen lokale do të zbatohet për Qytetin e Prishtinës, përveç nëse parashihet ndryshe në ligjin për Qytetin e Prishtinës, Legjislacion i posaçëm mund të miratohet për t'u dhënë status dhe kompetenca të posaçme qyteteve të tjera.

Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal, Nr. 03/L-041 - me këtë ligj rregullohet, organizimi territorial i vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, themelohen komunat e reja, përcaktohet territori i komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, përcaktohen kufijtë administrativ komunal, emrat dhe selitë e komunave të reja, vendosen rregullimet kalimtare në mes të komunave ekzistuese dhe komunave të reja të themeluara me këtë ligj, si dhe definohen procedurat për ndryshimin e kufijve administrativ të komunave.

Ligji për Zgjedhjet Lokale, Nr. 03/L-072 - qëllimi i këtij ligji është organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave të Kosovës.

Ligji për Financat e Pushtetit Lokale, Nr. 03/L-049 - me ketë ligj rregulloret pavarsia financiare e cila në përputhje me politikat ekonomike kombëtare dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe Qeverisë, Komunat e Kosovës kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës. Burimet financiare komunale do të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Kushtetutë dhe në LVQL.

Me qëllim të konkretizimit dhe në drejtim të zbatimit të legjislacionit primarë MAPL ka hartuar edhe një numër të konsiderueshëm të Udhëzimeve Administrative si vijojn më poshtë:

UA Për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare në Komuna, Nr. 2008/01 - ky Udhëzim Administrativ rregullon të drejten e përdorimit të rregullt dhe efikas të automjeteve në të gjitha komunat e Kosovës.

UA për themelimin e njësive për të drejtat e njeriut në komuna, Nr. 2008/02 - ky Udhëzim Administrativ themelon Njësitë Funksionale për të Drejtat e Njeriut në komuna (NJDNJK), si mekanizem i qëndrushem dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjën e të drejtave të njeriut në nivel komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës.

UA për zbatimin e përgjegjësive të MAPL-s për monitorimin dhe mbikëqyrjen e komunave, Nr. 2008/04 - ky Udhëzim Administrativ përcakton parimet, objektivat dhe procedurat për të ushtruar përgjegjësitë e MAPL-së, për monitorimin dhe mbikqyrjën e komunave, në zbatimin e përgjegjësive të përcaktuara me ligj.
UA për Zyrat Pritëse në Komuna, Nr. 2008/05 - ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ngritjen e efikasitetit të organeve komunale në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

UA për bashkëpunim të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, Nr. 2008/08 - ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që përmes bashkëpunimit të komunës më fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, të sigurojë ofrimin e shërbimeve publike efikase, si dhe përmbushjen e kërkesave ligjore të të gjithë qytetarëve të komunave.

UA për transparencën në komuna, Nr. 2008/09 - ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim forcimin e transparencës të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunave.

UA për organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komuna, Nr. 2008/10 - ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që përmes Komiteteve Konsultative në komuna të ndikojë te qytetarët dhe grupet tjera të interesit, të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjës për interes publik.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e Vetëqeverisjes lokale, Decentralizimit dhe reformës së Pushtetit Lokal, MAPL ka hartuar edhe dokumentet strategjike që janë në implementim e sipër.

Strategjia afatmesme e punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 2009-2012 - Strategjia Afatmesme e Punës e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), është dokument i cili përmban tërësinë e aktiviteteve të cilat Ministria do t'i ndërmerr me qëllim të përsosjes së funksionimit, promovimit dhe afirmimit të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe mandatit të sajë.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe veprimeve të cilat dalin nga kjo strategji, bazuar në Kushtetutën dhe ligjet e vendit, do të bëhet jo vetëm nga niveli i pushtetit lokal por edhe nga segmente të caktuara të atij qendror.

Në qendër të vizionit të MAPL-së është reforma e vetëqeverisjes lokale të cilën qytetarët do ta konsideronin të drejtë, obligim dhe përgjegjësi për të drejtuar proceset zhvillimore nëpër njësitë komunale. Për të arritur këtë synim, Ministria ka paraparë objektivat e mëposhtëm të cilët kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, sigurimin e burimeve njerëzore me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve publike në komuna, arritjen e standardeve evropiane sipas planit për veprim për partneritet evropian, si dhe në vendosjen e kornizës legale të bashkëpunimit ndërkomunal e ndërkufitar.

Secili prej objektivave ka synimet e caktuara të cilat mund të realizohen nëpërmjet projekteve të udhëhequra nga MAPL dhe partnerët politik si dhe organizata të ndryshme në kuadër të kornizës kohore të paraparë, 2009-2012.

Me këtë strategji tentohet të arrihet nivel i lartë i funksionimit harmonik dhe modernizimi i udhëheqjes së pushtetit lokal në pajtim me Kartën evropiane për vetëqeverisjen lokale, duke eliminuar praktikat e moslejimit të ushtrimit të kompetencave "të zgjedhura"nga ana e komunave të cilat do të duhej t'i takonin atyre.

Planin e veprimit për decentralizim (2008-2011) - MAPL ka hartuar Planin e veprimit për decentralizim, 2008-2011. Në planin e veprimit është pasqyruar synimi strategjik i Qeverisë së Kosovës për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes lokale në të gjithë territorin e Kosovës që do të sigurojë kushte më të mira për jetesë për të gjithë qytetarët e saj duke i kushtuar kujdes përkatës nevojave të posaçme të komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Plani i veprimit për decentralizim është aprovuar nga Qeveria dhe sipas këtij plani është fomuar Grupi Ndërministror për Decentralizim i cili përbëhet prej Ministrave të Qeverisë dhe 5 nëngrupeve punuese:

- Nëngrupi për reformim të legjislacionit;

- Nëngrupi për bartje të Kompetencave dhe Resurseve;
- Nëngrupi për themelimin e Komunave të Reja;
- Nëngrupi për ngritje të kapaciteteve dhe koordinim me donatorë; dhe
- Nëngrupi për fushatën informuese të decentralizimit.

Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut për vitin 2009 - Divizioni për të drejtat e njeriut në kuadër të Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal gjatë vitit 2009 do të vazhdoj me monitorimin e respektimit të drejtave të njeriut si në ministri ashtu dhe në komuna në këto fusha:

- Barazia Gjinore/Të Drejtat e Fëmijëve/ Kundër- Trafikimi;
- Përdorimi i Gjuhëve/ Të Drejtat e Minoriteteve;
- Kundër Diskriminimit/ Mundësitë e Barabarta / Personat me Aftësi të Kufizuar;
- Bashkëpunimin e DDNJ-së në kuadër MAPL-së, bashkëpunimin ndërministrorë dhe institucionet tjera të jashtme;
- Koordinimi i mbrojtjes të të Drejtave të Njeriut në bashkëpunim me të gjitha NJKDNJ;
- Themelimi i NJDNJK-ve në komuna sipas ecurisë së procesit të decentralizimit;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve për të drejtat e njeriut në komuna;
- Bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve që dalin nga objektivat e strategjive të aprovuara nga Qeveria, me aktorët përgjegjës të përcaktuar sipas planeve të veprimit, me komuna;
- Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe vendore si dhe Ombudspersonit sa i përket të drejtave të njeriut.

Korniza institucionale
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është strukturuar në atë mënyrë që të funksionojë në baza të efikasitetit me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive, konform legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim,MAPL ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 2008/6 për ndryshimin e UA 2007/1, për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të MAPL-së. Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të MAPL-së janë:

- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Vetëqeverisje Lokale;
- Departamenti për Reformë dhe Integrime Evropiane;
- Departamenti i Administratës dhe Mbështetjes;
- Departamenti i Prokurimit; dhe
- Zyra për informim.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian në fushën e Reformës së vetëqeverisjes lokale, mes tjerash, MAPL do të synojë kompletimin e ligjeve duke hartuar: ligjin për menaxhimin e pronës së paluajtshme komunale, ligjin për emrat e vendbanimeve në komuna si dhe ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar. MAPL do të bëjë edhe hartimin e akteve nënligjore që lidhen me pushtetin lokal, monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore të komunave si dhe harmonizimin e statuteve komunale konform ligjit për vetëqeverisjen lokale,gjithnjë duke marrë parasysh kompetencat që prekin komunat. MAPL do të bëjë identifikimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që prekin kompetencat e komunave dhe publikimin e tyre në një dokument apo doracak të veçantë. Sa i përket zbatimit të ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, komunat do të bëjnë hartimin e rregulloreve të tyre për përdorimin e gjuhëve zyrtare në komuna gjegjëse.

Respektimi i të drejtave të njeriut është njëri ndër prioritetet e MAPL-së dhe për realizimin e kësaj fushe MAPL ka hartuar Planin e veprimit për të drejtat e njeriut përmes themelimit të njësive për të drejtat e njeriut në komunat e reja dhe ish PNJK-të si dhe implementimin e programit për ngritjen e kapaciteteve

të njësive për të drejtat e njeriut në nivel lokal. Sa i përket fushës së bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, MAPL do të hartojë ligjin "për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritet", vendosjen e strukturave fillestare brenda MAPL-së për menaxhimin e bashkëpunimit ndërkufitar, themelimin e sekretariateve dhe komiteteve si dhe akterëve tjerë për menaxhimin e bashkëpunimit ndërkufitar, ngritjen e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për menaxhimin e këtij procesi si dhe identifikimin e projekteve ideore të natyrës së bashkëpunimit ndërkufitar.

Në drejtim të ngritjes së përformances nëpër komuna, MAPL do të hartojë "Doracakun për vlerësimin dhe matjen e performancës së komunave" sa i përket fushës së zhvillimit socio–ekonomik, lehtësirave për biznese dhe planifikimit për të hyra vetanake. MAPL ka paraparë hartimin e programeve për lehtësime për kategoritë me potencial të vogël taksapagues dhe lehtësive për biznese, hartimin e strategjive për realizimin dhe ngritjen e nivelit të planifikimit të të hyrave vetanake, si dhe hartimin e strategjive të reja për komunat, bazuar në metodologjinë unike për hartimin e Planit strategjik të zhvillimit socio-ekonomik të komunës.

Koordinimi i procesit të ri-pranimit dhe ri-integrimit të personave të kthyer nga jashtë është njëra nga fushat ku MAPL është institucion përkrahës dhe krijon mbështetje pushteteve lokale për të bërë identifikimin e donatorëve të mundshëm, duke i këmbyer praktikat më të mira për procesin e ri-integrimit të vendeve të rajonit dhe BE-së, zhvillimin e projekteve me komunat dhe zbatimin e strategjisë për ri-integrim.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e reformimit të administratës publike të qëndrueshme, duke përmirësuar kapacitetet administrative lokale për t'u ofruar shërbime qytetarëve në mënyrë efektive dhe të barabartë, MAPL do të bëjë vlerësimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në të gjitha komunat e Kosovës si dhe instalimin e rrjetit të gjerë të internetit në MAPL, me qëllim të ndërlidhjes të të gjitha komunave për të menaxhuar të dhënat në mënyrë elektronike. Në drejtim të forcimit të strukturave në nivelin lokal lidhur me procesin e kthimit, MAPL do të mbështet këtë proces përmes zbatimit të Marrëveshjen për Procesin e Lokalizimit, e nënshkruar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, UNHCR-së, UNDP-së. MAPL gjithashtu do të përkrah këtë proces përmes grupeve komunale për kthim.

g. Sistemi gjyqësor

Sistemi i gjykatave të rregullta të Kosovës përbëhet nga 24 gjykata komunale dhe 2 degë të gjykatave komunale, 5 gjykata qarku, Gjykata Komerciale e Kosovës, si dhe Gjykata Supreme. Gjykatat komunale merren me zgjidhjen lëndëve të shkallës e parë. Kompetencat e gjykatave komunale në zgjidhjen e lëndëve janë të parapara me ligj.

Gjykatat e qarkut janë të vendosura në secilin prej qyteteve rajonale (Prishtinë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë). Ato zgjedhin ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale, poashtu shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për vepra penale të dënueshme me burgim me më shumë se 5 vite, konteste madhore pronësore, konteste në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale.

Gjykata Komerciale është e vendosur në Prishtinë dhe ka juridiksion mbi gjithë territorin e Kosovës për shkallën e parë të kontesteve mes subjekteve afariste private, procedurave të bankrotimit, si dhe disa vepra penale komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës është organi më i lartë në sistemin e gjykatave të rregullta. Ajo funksionon si gjykatë apeli e shkallës së tretë në një numër të caktuar rastesh penale dhe trajton ankesat kundër vendimeve nga gjykatat e qarkut prej ankesave të gjykatave komunale. Ajo gjithashtu trajton ankesat

direkte në rastet që dalin nga gjykatat e qarkut, si dhe shërben si gjykatë e shkallës së parë për çështje të jashtëzakonshme dhe çështje tjera sipas ligjit (p.sh. konteste administrative).

Procesi i reformës gjyqësore në bazë të Planit strategjik të Ministrisë së Drejtësisë 2006-2011 si dhe planit të veprimit, por edhe me Planin strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për gjyqësorin e Kosovës 2007-2012, sapo është nisur.

Korniza ligjore

Sa i përket fushës së sistemit gjyqësor në fuqi,ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- Ligji për Provimin e Jurisprudencës (02/l-40),
- Ligji për Familjen i Kosovës (2004/32),
- Kodi Penal i Kosovës(2003/25),
- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (2003/26),
- Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (2004/46),
- Ligji Penal për të Mitur i Kosovës,
- Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (2004/26),
- Ligji mbi Ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës (2004/19),
- Kodi mbi Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore (2004/34),
- Ligji për Procedurën Kontestimore (03/l-006),
- Ligji për procedurën jokontestimore 03/L-007,
- Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Penal të Kosovës 03/L-002,
- Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (03/L-003),
- Ligji për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovës 03/L-053,
- Ligji për Procedurën Përmbarimore (03/l-008),
- Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (03/l-052),
- Ligji për Ndërmjetësim (03/l-057),
- Ligji për Noterinë (03/l-010),
- Ligji për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës (03/L-123),
- Ligji për avokatinë (03/L-117),
- Ligji për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (02/L-25),
- Ligji kundër korrupcionit (2004/34),
- Rregullore për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (2005/52),
- Rregulore mbi organizimin e mbrendshëm të Këshillit gjyqësor të Kosovës (07/2007),
- Rregullorja e UNMIK-ut 2006/36 (RRNJ), dhe
- Rregullore Administrative mbi Kornizën rregullative për sistemin e Drejtësisë në Kosovë.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative të lartëpërmendur, në fuqi janë një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, korrnizë e cila përbëhët nga:

- UA për Programin dhe Mënyrën e Dhënies së Provimit të Jurisprudencës (UA-152-126/09),
- UA për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi Kornizën Rregullative për Sistemin e Drejtësisë në Kosovë,
- Urdhëresë Administrative të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/52 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. (2006/8e),
- UA 2006/15,
- UA 2007/4, dhe 2005/8,
- UA 17/8, për parandalimin e elemininimin e punëve të renda për të mitur,
- Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/2,

- Urdhëresë Administrative nr. 2007/6 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës,

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e sistemit gjyqësor, dokumentet strategjike dhe memorandumet në vijim janë në implementim të sipër:

- Strategjia Legjislative 2009,
- Plani vjetor i punës së Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2009,
- Plani i punes 2008-2011,
- Plani strategjik i punës së KGJK-së 2007-2012,
- Plani strategjik tre vjeqar i IGJK-së dhe Programi trajnues,
- Programi i Vazhdueshëm i IGJK-së për Arsimim Ligjor,
- Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe KMDLNJ,
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MD dhd BKUK,
- Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të MD dhe MAP,
- Memorandum i mirëkuptimit në mes të MD dhe OAK,
- Memorandum bashkpunimi në mes të Bankës Botërore dhe KGJK-së,
- Marrëveshja mes Prokurorisë dhe AKK-së,
- Marrëveshja mes Prokurorive dhe Auditorit të Përgjithshëm dhe,
- Marrëveshja mes Prokurorive dhe MEM.

Korniza institucionale

Ministria e Drejtësisë - Roli dhe Misioni i Ministrisë së Drejtësisë është që të siguroj një sistem gjyqësor dhe prokurorial efikas, të pavarur dhe të paanshëm, para së cilit të gjithë qytetarët do të ndihen të sigurt dhe të barabartë.

Ministria siguron trajtim sa më profesional dhe sipas standardeve ndërkombëtare të të paraburgosurve, të dënuarve, viktimave të dhunës, viktimave të trafikimit dhe dëshmitarëve të mbrojtur.

Ministria harton legjislacionin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe harmonizon ligjet me standardet e BE-së, zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, si dhe siguron qasje më të lehtë në institucionet e drejtësisë për pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

Minitria e Drejtësisë ka shtatë departamente:

- Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- Shërbimi Sprovues i Kosovës;
- Departamenti për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore;
- Departamenti për Çasje në Drejtësi;
- Mandati i Departamentit për Çështje Ligjore;
- Departamenti i Administratës dhe Personelit;
- Departamenti i Prokurimit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) - siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. KGJK është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. KGJK siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës si dhe të ndjekin parimet e barazisë gjinore. KGJK është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore, për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për

gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj.

KGJK në kuadrin e saj ka tetë komisione të përhershme:

- Komisionin Disiplinor Gjyqësor,
- Komisionin Disiplinor Prokurorial,
- Komisionin për Emërim dhe Zhvillim Gjyqësor,
- Komisionin për Emërim dhe Zhvillim Prokurorial,
- Komisionin për Administrimin e Gjykatave,
- Komisionin për Buxhet Financa dhe Burime Njerëzore,
- Komisionin për Rregulla të Brendshme dhe Çështje Legjislative; dhe
- Komisionin Konsultativ për Minoritete.

Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) - është trup autonom i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). KPGJP është themeluar me qëllim të kryerjes së një rishikimi gjithëpërfshirës, në tërë Kosovën, mbi përshtatshmërinë e të gjithë parashtruesve të kërkesave për emërim të përhershëm si gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë.

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK) - është përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve. IGJK do të vazhdojë të implementojë sistemin e trajnimit fillestar, trajnimet e avancuara dhe trajnimet për jurinë dhe personelin profesional të gjykatave dhe prokurorive. IGjK do të transformohet në një shkollë studimesh pasdiplomike për profesionistët. Trajnimet e tij mbulojnë një gamë temash, duke përfshirë kodin drejtësinë dhe procedurat penale, zbatimin e vendimeve, etikën gjyqësore dhe trajnimet mbi të drejtat e pronësisë intelektuale.

Prokurori i Shtetit - është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës - është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Këshilli do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t'i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.

Komisioni për Ndihmë Juridike - siguron ndihmë juridike qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilëve deri më tani u është mohuar qasja e barabartë në drejtësi, për shkak të mungesës së mjeteve materiale. Ndihma juridike falas u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një

ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi. Duke ditur se qytetarëve të Kosovës për shkak të mungesës të mjeteve materiale i është mohuar qasja e barabartë në drejtësi, atëherë synimi kryesor i KNJ-së është që nëpërmjet shërbimeve cilësore të ofruesëve të ndihmës juridike, këta qytetarë për t'i realizojnë të drejtat e tyrë.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian do të bëhet: hartimi i legjislacionit që do të rregullojë bashkëpunimin me Tribunalin për Krime të Lufës në ish-Jugosllavi; miratimi dhe zbatimi i Projektligjit mbi Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar; hartimi dhe miratimi i Projektligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë; themelimi i Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar; themelimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe funksionalizimi i tij; miratimi i Projektligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës; miratimi i Projektligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës; zbatimi i Ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës; miratimi i Ligjit mbi Avokaturën, nxjerrjen e akteve nënligjore per implementim e Ligjit mbi Noterine; themelimi i një programi të qëndrueshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve; hartimin, miratimin dhe zbatimin e projektëligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve; hartimin e projektëligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve; miratimi i Projektligjit mbi Gjykatat; miratimi i Projektligjit mbi Prokuroritë; organizimi i provimeve te avokaturës pas themelimit të Komisionit të jurispodencës sipas ligjit në fuqi; emërimi i Drejtorit të Departamentit për çasje në Drejtësi; vazhdimi i sigurimit të softuerit të nevojshëm dhe krijimi i bazave të të dhënave dhe arkivave elektronike nga ana e MD-së për të bartur të dhënat nga DD/UNMIK në MD; miratimi i Projektligjit mbi Autopsi ; miratimi i Projektligjit mbi Mjekësinë Ligjore; hartimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër Korrupsionit; hartimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik; ndërtimi i burgut për dëshmitarë të dënuar; blerja e paisjeve të duhura (mjetet teknike, kamera, alarmeve, radiolidhjeve, makinave të veçanta për bartjen e të burgosurve; ndërtimi i burgut të sigurisë së lartë dhe shtëpive të tjera korrektuese; ndërtimi i dy qendrave të paraburgimit në Prishtinë dhe Gjilan; si dhe riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese.

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian do të bëhet: zbatimi i Ligjit për Ndërmjetësim; formimi i Komisionit per Ndermjetesim; nxjerrja e Kodit të Etikës Profesionale për Ndërmjetesim; nxjerrja e akteve nënligjore nga Ligji per Ndërmjetesim, si akti nënligjor për caktimin e taksave që duhet paguar për procedurën e ndërmjetesimit; vazhdimi i përfaqesimit gjyqësor të Qeverisë së Kosovës në të gjitha procedurat gjyqësore nga ana e MD-së, kompletimin e njësisë së transportit për të burgosurit, ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve për stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, zhvillimin e një sistemi efikas të shërbimeve juridike, ligjore dhe teknike të cilat do të ndikojnë në avancimin e pozitës së minoriteteve në institucionet e Drejtesisë, krijimin dhe funksionalizimi i një mekanizmi të Monitorimit Sistematik të trajtimit të minoriteteve në Institucionet e Drejtësisë, negocimi dhe arritja e nënshkrimit te Marrëveshjeve Bilaterale mes Kosoves dhe vendeve te ndryshme mbi ndihmën ndërkombëtare juridike ne çeshtjet penale dhe civile, hartimi i legjislacionit sekondar sa i procedurës se Ekstradimit, hartimi i Rregullores se punes se brendshme te Divizionit per Bashkepunim Juridik Nderkombetar, si dhe organizimi i trajnimeve per gjyqtare dhe prokurore lidhur me proceduren e ofrimit te ndihmes nderkomebtare juridike, dhe formimit të nje mekanizmi koordinues në mes MD, KGJK-se, MPB-se, MMPH-se dhe Komunave me qellim te mbrojtjes se drejtave pronesore.

Poashtu, synohet zbatimi i Ligjit per Proceduren Konstestimore, zbatimi i Ligjit për procedurën Përmbaruese, ndryshimi i menyrës së raportimit statistikor për sigurimin e të dhënave statistikore të sakta dhe gjithëpërfshirëse, kualitative nga raportimi mujor në raportim ditor, rritjen e numrit të gjyqtarëve në sektorin e luftimit të krimit të organizuar dhe atij financiar, ndërmarrja e një analize me

qëllim të përcaktimit të numrit të nevojshëm të stafit administrativ nëpër gjykata, hartimin e rregullave për menaxhmin e gjykatave pas miratimit të ligjit mbi gjykatat, hartimin e rregullave mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave dhe krijimin e planit strategjik për Teknologji Informative.

h. Politika kundër korrupsionit

Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e korrupsionit me mekanizmat tashmë të vendosur. Qeveria e Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë dhe përforcojë partneritetin me shoqërinë civile dhe mediat me synim të përforcimit të rolit të tyre në zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e reformave për luftimin e korrupsionit si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare në Kosovës.

Korniza ligjore
Fusha e luftës kundër korrupsionit është e rregulluar përmes dy ligjeve të cilat formojnë korniëen ligjore në Kosovë:

Ligji kundër Korrupsionit nr. 2004/34 - ky ligj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative të korrupsionit në nivel të administratës publike, eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me firmat ku personi zyrtari ose një person në marrëdhënie të afërt me të është i përfshirë.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e Funksionit Publik, Nr. 02/L-133 - qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit ndërmjet interesit publik dhe atij privat të zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, subjekteve, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe atij privat të zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit publik. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar, kur ai merr pjesë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë në një vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Korniza institucionale
Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit (AKK) është organ i pavarur dhe i specializuar për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë i cili ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin kundër Korrupsionit (2004/34). Agjensioni është themeluar në korrik 2006 dhe është funksionaluzuar me 12 shkurt 2007.

Qëllimi dhe puna e Agjensionit është e përqendruar në hetimin dhe zbulimin e rasteve korruptive, dhënien e kontributit për plotësimin e legjislacionit anti-korrupsion në Kosovë, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit, edukimin dhe ngritjen e vetëdijes anti korrupsion në Kosovë si masë themelore për zhvillimin e një lufte të suksesshme kundër korrupsionit.

Puna e Agjensionit mbikëqyret nga Kuvendi i Kosovës dhe nga Këshilli i Agjensionit. Agjensioni raporton mbi punën e kryer çdo gjashtë muaj para Këshillit të Agjensionit dhe një herë në vit para Kuvendit të Kosovës.

Këshilli është një organ kolegjial i cili kryen funksionin e politikë-bërësit të reformave anti-korrupsion dhe mbikqyr punën e AKK-së. Anëtarët e Këshillit kanë një mandat prej dy vitesh në detyrë. Këshilli aktual ka filluar punën në qershor të vitit 2008 duke trashëguar kështu një Këshill paraprak të cilit i ka

përfunduar mandati në shkurt të vitit 2008. Gjatë këtij mandati këshilli ende nuk është plotësuar me anëtarët e duhur pasi që mungon përfaqësuesi nga shoqëria civile. Gjatë vitit 2008, Këshilli ka realizuar 18 takime. Sikurse Këshilli paraprak edhe ky aktual do ta ketë mandatin dy vjeçar.

Agjensioni, bazuar në kuadrin ligjor, raporton në baza gjashtëmujore tek Këshilli i Agjensionit , në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive si dhe për gjetjet e Agjensionit në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara si dhe punën dhe aktivitetet e detajuara të kryera nga Agjensioni gjatë periudhës së raportuar.

Deri më tani, Agjensioni ka paraqitur në Këshill një raport vjetor përkatësishtë për periudhën janar – dhjetor 2007, si dhe tri raporte gjashtë mujore, për periudhën Korrik-Dhjetor 2006, Janar-Korrik 2007, dhe Janar-Dhjetor 2008.
Këshilli i Agjensionit përbëhet nga 9 anëtarë:

- 3 përfaqësues nga Kuvendi;
- 1 përfaqësues nga Zyra e Presidentit;
- 1 përfaqësues nga Qeveria;
- 1 përfaqësues nga Gjykata Supreme;
- 1 përfaqësues nga Zyra e Prokurorit Publik;
- 1 përfaqësues nga autoritetet lokale; dhe
- 1 përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli i Agjensionit ka një kryesues dhe zëvendës-kryesuesin të zgjedhur nga anëtarët e Këshillit të Agjensionit midis tyre për një periudhë prej dy vjetësh.

AKK-ja është i pari institucion i pavarur në vend i ngritur pa ndihmën paraprake të organizmave ndërkombëtare dhe është tërësisht i mbështetur në kapacitetet vendore. Fondet për funksionimin e Agjensionit sigurohen nga Buxheti i Kosovës, në bazë të propozimit dhe planifikimit të Agjensionit,gjithnjë duke u bazuar në ligjin në fuqi.

Aktualisht në Agjension janë të punësuar 35 zyrtarë në kuadër të strukturës administrative të përbërë prej tre departamenteve:

- Departamentit të Hetimeve;
- Departamentit të Parandalimit; dhe
- Departamentit të Administratës.

Përveç Drejtorit të Agjensionit i cili është i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, të gjithë zyrtarët janë shërbyes civil.

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të ZKM-së, udhëheq dhe e koordinon Grupin punues kundër korrupsion që është mekanizëm i Qeverisë në luftimin e korrupsionin. Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 27.03.2008 ka marrë vendim me Nr. 04/13 për emërimin e anëtarëve të Grupit punues ndërministror kundër korrupsionit. Qëllimi i grupit punues ndërministror është përkrahja dhe bashkëpunimi me Agjencionin Kosovar Kundër Korrupsionit në hartimin e Politikave, shqyrtimin e infrastrukturës ligjore etj.

Grupi punues ndërministror kundër korrupsionit gjatë këtij viti ka luajtur dhe po luan një rolë të rëndësishëm në procesin e hartimit të strategjisë kundër korrupsionit si dhe në zbatimin e planit të veprimit për reformën e administratës publike në Kosovë.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian në fushën e luftës kundër-korrupsionit, AKK-ja me qëllim të zbatimit të politikave efektive kundër korrupsionit e në bashkëpunim me institucionet e tjera qeveritare dhe jo qeveritare, do të pregadit Strategjinë Kundër Korrupsionit së bashku me Planin e Veprimit Kundër-korrupsionit për periudhën 2009-2011 që priten të riprocedohen për aprovim në Qeveri dhe Kuvend.

Gjithashtu do të fuqizohet baza ligjore kundër korrupsionit në Kosovë përmes procesit të përgatitjes së projektligjeve përkatëse në këtë fushë. Këtu veçmas përmendet bashkëpunimi me Qeverinë në përgatitjen e Projektligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit kundër Korrupsionit 2004/34 si dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit publik Nr. 02/L-133.

Poashtu, vazhdimi i ndërtimit të plotë të mandatit ligjor konform legjislacionit anti-korrupsion në fuqi mbetet në kuadër të prioriteteve afatmesme.

Prioritetet afatmesme
Si prioritet afatmesëm është avancimi i luftës kundër korrupsionit në kuadër të fuqizimit të bazës ligjore anti-korrupsion, me përforcimin e kapaciteteve për hetimin dhe zbulimin e kryerësve të veprave korruptive, përmirësimin e bashkëpunimit mes Agjensionit dhe mekanizmave të tjerë si policisë, prokurorisë por edhe mekanizmave të tjerë si dhe përmirësimi i këmbimit të informatave për rastet e lidhura me korrupsion mes shërbimeve të cilat janë të ngarkuara me zbulimin, hetimin dhe ndjekjen të rasteve të dyshimta korruptive.

Agjensioni do të ndërmarrë të gjitha masat që në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngushtojë mundësinë e kryerjes së veprimeve korruptive dhe kësisoj korrupsioni të shëndërrohet në aktivitet me rrezik të lartë dhe profit të ulët.

2.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetare që janë të njohura me të drejtën ndërkombëtare janë direkt të përfshira në Kushtëtutën e Republikës së Kosovës, dhe pas deklarimit të pavarësisë, miratimi i legjislacionit në këtë fushë është një nga prioritetet më të larta për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

a. Të drejtat civile dhe politike

Qeveria me datën 3 dhjetor 2008 ka aprovuar, **Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011.** Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011 është hartuar nën koordinimin e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës / Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM), dhe në bashkëpunim të ngushtë me shumë akterë të rëndësishëm të fushës të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe me institucione ndërkombëtare. Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës synon të jetë një dokument që ofron hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë për të përmirësuar zbatimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përhapjen e njohurive për të drejtat e njeriut në Kosovë. Në strategji identifikohen dhe përcaktohen detyrat më prioritare, konsolidohet koordinimi mes palëve të interesuara, vendosen afate për përmbushjen e shumë detyrave si dhe përcaktohen institucionet përgjegjëse që do të ngarkohen me detyra të ndryshme dhe përgjegjësi në kuadër të zbatimit të Strategjisë.

Korniza ligjore dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - Qeveria e është duke krijuar mekanizma dhe infrastrukturë të nevojshme ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, konform standardeve ndërkombëtare. Janë bërë përparime domethënëse në infrastrukturën ligjore, si dhe në krijimin e mekanizmave institucionalë për të komunikuar dhe koordinuar politikat, programet dhe proceset në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut brenda institucioneve të Republikës së Kosovës. Në nivelin qendror dhe lokal të Qeverisjes janë themeluar Njësitë për të Drejtat e Njeriut (NJDN-ut). Kjo ka bërë të mundur një lehtësim të realizimit të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim dhe ka ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje aktive në përcaktimin e politikave dhe aktiviteteve ekzekutive.

Republika e Kosovës në Kushtetutën e saj, ka përfshirë Instrumentet kryesore ndërkombëtare të cilat i referohen mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe te njëjtat janë drejtpërdrejt te aplikueshme në Kosovë, me këtë hap ajo ka shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e mirë politik që të marrë përsipër përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të cilat sigurojnë realizimin e të gjitha të drejtave themelore e të patjetërsueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Me 29 Prill 2009, Qeveria ka aprovuar **Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës për vitet 2009-2011**. Miratimi i këtij plani ka edhe një rëndësi simbolike, pasi që për herë të parë në Kosovë miratohet një dokument i cili në mënyrë të qartë tregon se çka duhet të bëjmë ne si institucione por, edhe si shoqëri për të përmirësuar cilësinë e jetës së të gjithë Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës. Dokumenti përfshinë komentet e sektorit joqeveritar dhe të organizatave që përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar. Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës / Zyrës për Qeverisje të Mirë, do të koordinoj procesin e monitorimit dhe të raportimit të Planit. Me qëllim të promovimit të dokumentit strategjik, ZKM/ZQM ka mbajtur një Konferencë për lansimin e këtij plani. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara është botuar edhe në shkrimin e brait, CD me teknikë akustike për personat e verbër si dhe është bërë përgatitja e DVD-ve në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër.

Kryeministri i Republikës së Kosovës me vendimin nr. 08/46 të datës 3 Dhjetor 2008 riaktivizoi **Këshillin Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara**, drejtuar nga z. Ramë Manaj, Zëvendës Kryeministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kjo strukturë e lartë reprezentative dhe këshillëdhënëse, bashkëpunon dhe lehtëson komunikimin dhe koordinimin e politikave, programeve dhe proceseve në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara, OJQ-ve, dhe shoqërisë civile në përgjithësi.

Me qëllim të koordinimit dhe bashkëpunimit ndër qeveritar për të drejtat e njeriut, Kryeministri i Qeverise se Kosovës, me 13 Maj 2009 ka marr vendim dhe ka emëruar **Koordinatorin për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Republikës së Kosovës**. Koordinatori, në bazë të vendimit të Kryeministrit, do të koordinojë punët me Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Ministritë e Linjës, me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, gjithashtu Koordinatori koordinon aktivitetet lidhur me raportimin e Qeverise së Kosovës për mekanizmat ndërkombëtare për te drejtat e njeriut.

Është finalizuar dokumenti **Strategjik dhe Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013,** dhe në qershor 2009 pritet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Pas organizimit të një varg punëtorive publike, me qëllim të konsultimit të gjerë me fëmijët, shoqërinë civile, organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, ka finalizuar dhe ka bërë inkorporimin e komenteve në Strategjinë dhe Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013**.** Procesi i zhvillimit te dokumentit strategjik ka përfshirë: Analizën e situatës së të Drejtave të Fëmijëve, analizë të legjislacionit që ka të bëjë me të Drejtat e Fëmijëve, si dhe konsultimet me shoqërinë civile, fëmijët dhe të rinjtë, si pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit të këtij dokumentit strategjik.

Me vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës me nr. 07/46 të datës 03.12.2008, është funksionalizuar **Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve**. Komiteti Ndërministrorë për të Drejtat e Fëmijëve ka për qëllim koordinimin e politikave, programeve dhe proceseve ne lidhje me çështjet e të drejtave të fëmijëve ndërmjet injstitucioneve të Republikës së Kosovës.

Qeveria në takimin e mbajtur me datën 24 dhjetor 2008, ka aprovuar **Strategjinë për integrimin e komuniteteve, Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë 2009-2015**. Strategjia ka për qëllim identifikimin e nevojave, përcaktimin e objektivave dhe prioriteteve për integrimin dhe fuqizimin e minoriteteve RAE në respektimin dhe zbatimin e plotë të të drejtave të njeriut. Në veçanti ka për qëllim të përmirësoj integrimin e përgjithshëm të komuniteteve RAE në rrjedhat e shoqërisë kosovare.
Strategjia do të ofrojë rekomandime konkrete për fushat tematike specifike, siç janë: arsimi, kultura, informimi, mediat, shëndetësia, pjesëmarrja, përfaqësim politik, punësimi, fuqizimi ekonomik, siguria sociale, banimi, vendbanimet, regjistrimi, dokumentet, kundër- diskrimini, siguria dhe barazia gjinore. Zyra per qeverisje te mirë –Zyra e Kryeministit eshte duke koordinuar procesin e monitorimit te implementimit te kesja strategjie.

Sistemi i burgjeve në Kosovë në përgjithësi është në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, vendimi për ndërtimin e një burgu të ri të sigurisë së lartë dhe standardeve të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut është në proces. Sa i përket Burgut të Dubravës, do të bëhen një numër përmirësimesh: instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë dhe sistemit kundër stuhive dhe përmirësimi i mundësive të punësimit gjatë periudhës së burgimit. Implementimi i Kodit të Mirësjelljes nga personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe raportimi mbi ankesat e të burgosurve është hap i rëndësishëm i përcaktuar me këtë dokument për të garantuar mirëqenien e të burgosurve dhe të drejtave të tyre me standarde ndërkombëtare. Programet speciale të ri-integrimit, sidomos në bujqësi, në burgjet e Dubravës dhe Lipjanit do të zhvillohen në periudhën afatshkurtë.

Liria e shprehjes është e garantuar me ligj në Kosovë. Komisioni i Pavarur i Mediave të Kosovës do të rrisë kapacitetet njerëzore me synim implementimin e legjislacionit sekondar të lëshuar nga Komisioni i Mediave.

Ombudspersoni - Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, si institucion i pavarur me mandat të shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autoritetit nga administrata ndërkombëtare që vepron në Kosovë si dhe ajo publike vendore.

Nga mesi i vitit 2000 deri në dhjetor 2005, Institucioni udhëhiqej nga një Ombudsperson ndërkombëtar, kurse dy zëvendësit e tij, ekipi i juristëve për të drejtat e njeriut dhe stafi administrativ ishin kosovarë. Nga dhjetori 2005, përgjegjësitë e Ombudspersonit ndërkombëtar u bartën në duart e zëvendësit të tij kosovar i cili u emërua si Ushtrues i detyrës së Ombudspersonit deri në emërimin e Ombudspersonit të ri nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Në muajin shkurt 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (PSSP) nxori Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/6 .

Me rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/06 poashtu u ndryshua edhe struktura organizative e Institucionit. Sipas kësaj rregulloreje, udhëheqësia e Institucionit të Ombudspersonit duhet të përbëhet nga një Ombudsperson vendor, një Zëvendës kryesor dhe tre zëvendës të tjerë të cilët duhet të emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Pas dështimit të raundit të parë për emërimin e udhëheqësisë së Institucionit të Ombudspersonit në dhjetor të vitit 2006, UNMIK-u thjeshtësoi procedurën e emërtimit të Ombudspersonit duke e zëvendësuar Rregulloren 2006/06 me Rregulloren 2007/15. Më 22 qershor 2007 Kuvendi i Kosovës aprovoi amandamentet e Rregullës Procedurale për emërimin e Ombudspersonit dhe zëvendës Ombudspersonave.

Kuvendi i Kosovës hapi konkursin e dytë për zgjedhjen e Ombudspersonit me 28 qershor 2007, konkurs ky i cili u anulua pas kritikave të mëdha nga Organizatat jo-qeveritare për të drejtat e njeriut nga arena ndërkombëtare dhe vendore lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për listën e ngushtë për postin e Ombudspersonit.

Në mars 2008, për herë të tretë, Kuvendi i Kosovës hapi konkursin për pozitën e Ombudspersonit të Kosovës. Mirëpo, megjithëse ishte përgatitutr lista e ngushtë e kandidatëve, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte vendosur të largojë nga rendi i ditës zgjedhjen e Ombudspersonit për një kohë të pacaktuar duke mos bërë të ditur motivin për një vendim të tillë, ndërsa vazhdimi i këtij procesi edhe më tej mbetet i paqartë për opinionin. Në konkursin e katërt në fillim të këtij viti pati një dështim të sërishëm pasi Kuvendi i Kosovës nuk mbeshteti kandidatët nga lista e ngusht dhe mbi 30 vota ishin shpallur te pavlefshme.

Kuvendi i Kosovës me 4 qeshor ka zgjedhur Ombudspersonin e Kosovës. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës si dhe nga rregulloret tjera që kanë pasuar i kanë shpall vlerat dhe parimet më të rëndësishme, sipas së cilave ky Institucion funksionon. Disa nga vlerat dhe parimet më të rëndësishme pa të cilat Institucioni i Ombudspersonit nuk do të mund të kishte efektin e duhur në fushëveprimin e tij janë: pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti.

Një numër i madh i raporteve të publikuara për Kosovën nga ana e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, konfirmojnë dhe vlerësojn jashtezakonisht pozitivisht, derisa një raport i fundit i Komitetit për të drejtat ekonomike dhe sociale të arrituarat e institucionit të Ombudspersonit në Kosovë numërohen si një ndër aspektet më pozitive për Kosovën.

Implementimi i Ligjit për Anti-diskriminim do të monitorohet, ndërsa në afatin e shkurtër Qeveria e Kosovës do të bëjë hulumtime për implementimin e Ligjit kundër Diskriminimit nga zyrtarët në administratë publike në nivelin qendror dhe hulumtimin mbi përceptimin e qytetarëve mbi diskriminimin dhe zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit si dhe do t'i publikojë këto hulumtime pas kryerjes së tyre.

Funksionalizimi i plotë i Njësive për të Drejtat e Njeriut në ministritë e linjës, bazuar në Udhëzimin Administrativ 2007/04 mbetet sfidë për Qeverinë dhe do të trajtohet në periudhë afatshkurtër. Për të avancuar bashkëpunimin dhe implementimin e rekomandimeve të Ombudspersonit do të mbahen takime të rregullta mujore mes ZQM/ZKM dhe Ombudspersonit.

b. Të drejtat ekonomike dhe sociale

Korniza ligjore
Parimi i të drejtave të barabarta për meshkuj dhe femra është vendosur si një nga rregullat themelore që e përmban Kushtetuta e Kosovës. Kushtetuta e Kosovës garanton të gjithë personave në Kosovë

gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në barazi të plotë dhe pa diskriminim në çfarëdo baze.

Ligjin për Barazi Gjinore - Me qëllim të arritjes së barazisë midis femrave dhe meshkujve dhe avancimit me të plotë të femrave, Kuvendi i Kosovës në vitin 2004 ka miratuar Ligjin për Barazi Gjinore. Qëllimi i LBGJ është që të promovoj dhe të krijojë barazinë gjinore si domosdoshmëri për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabart për pjesëmarrje të meshkujve dhe femrave në jetën politike, ekonomike, kulturore, apo sferat tjera.

Ligji Kundër Diskriminimit - është miratuar për të parandaluar dhe për të luftuar diskriminimin, por gjithashtu për të promovuar barazi efektive dhe për parimin e trajtimit të barabartë të personave në Kosovë. Ky ligj krahas asaj që ndalon diskriminimin e drejtpërdrejt apo të tërthorët ndaj personave duke u bazuar në gjini, në origjinë etnike dhe kombëtare, parasheh mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve pozitive, siç janë masat për të parandaluar ose për të kompensuar për dëmet për disavantazhet.

Rregullorja për Funksionimin e Këshillit Ndërministror - Agjencia për Barazi gjinore ka hartuar Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Ndërministror sipas nenit 4.9 të LBGJ, anëtar të të cilit janë të gjitha zyrtarët/ët për barazi gjinore në të gjitha Ministrit, këshill ky që i raporton ABGJ-së për kryerjen e detyrave nga aspekti i barazisë gjinore.

Projekt UA për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr/04/2007 - Agjencia për Barazi Gjinore ka përgatitur dhe dorëzuar për aprovim në Qeverinë e Kosovës Projekt udhëzimin Administrativ për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr/04/2007 Për Njësitë për të Drejtat e njeriut në Qeverinë e Kosovës. Udhëzimi i ri ka për qëllim sistemimin dhe ri-definimin e detyrave te anëtarëve të Këshillit Ndërministror dhe largimin e tyre nga këto njësi.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore –platforma e punës së ABGJ-së - konform mandatit të ABGJ-së të definuara në LBGJ-ë, Agjencia për Barazi Gjinore me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe shoqërinë civile ka hartuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, miratuar nga Qeveria e RK me vendimin Nr. 7/17 të dt. 24.04.2008. Vendimi obligon institucionet e Republikës së Kosovës për zbatimin e tij. Me miratimin e PKBGJ-së Qeveria/ABGJ përmbushë obligimin nga Neni 4.4 i Ligjit për Barazi Gjinore, obligimet e dala nga PVPE respektivisht prioriteti 39 (Të definohen dhe të adaptohen programet e qeverisë për promovimin e të drejtave të gruas në Kosovë) dhe prioritetin 116 (Të zbatohet ligji për barazi gjinore. Të sigurohet mbizotërimi i të drejtave të gruas në të gjitha politikat dhe legjislacionin ekzistues) .

PKBGJ është dokument strategjik që ka përcaktuar qëllimin, objektivat, politikat dhe aktorët kryesorë që janë përgjegjës për zbatimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës sociale dhe ekonomike, për femrat dhe meshkujt në Kosovë për periudhën 2008 -2013. Vlen të theksohet se PKBGJ përmban Planin e Veprimit me 7 objektiva strategjik si dhe koston buxhetore.

Ky program shërben si platformë pune afatgjate e ABGJ-së dhe obligon institucionet qendrore dhe lokale të ndërmarr veprimet e parapara në Planin e veprimit të fokusuar në 6 Fusha: 1)Marrëdhëniet gjinore dhe pozitat vendimmarrëse; 2) Integrimi i Grave në ekonomi; 3) Kultura dhe Mediat; 4) Arsimi; 5) Puna dhe Mirëqenia Sociale; dhe 6) Shëndetësia.

Korniza institucionale

Qeveria e Kosovës me Vendim Nr. 5/131 të datës 1 shkurt 2005 ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si organ te veçantë të Qeverisë së Kosovës konform nenit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

(Ligji Nr. 2004/2). Me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 03/2006 të datës 12.07.06 Zyra për Barazi Gjinore prej 1 Shtatorit 2006 shndërrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në Zyrën e Kryeministrit.
Agjencia për Barazi Gjinore ka mandat të zbatojë dhe të monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore duke promovuar vlerat dhe mundësitë e barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. ABGJ ka rekrutuar 7 anëtarë të stafit dhe tani numëron gjithsej 18 anëtarë.

Mekanizmat Institucional për arritjen e Barazisë Gjinore në nivelin qendror:

- Agjencia për Barazi Gjinore / ZKM;
- Institucioni i Ombudspersonit- Njësia për Barazi Gjinore;
- Zyrtaret/ët për barazi gjinore në ministri;
- Këshilli Ndër-ministror për Barazi Gjinore.

Mekanizmat ne nivelin lokal

- Zyrtarët/et për barazi gjinore në komuna

Në nivelin komunal që nga viti 2003 janë emëruar Zyrtaret për Barazi Gjinore. Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2004/18 të datës qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Konform nenit 4.15 i këtij Ligji MAPL nxjerr Udhëzimin Administrativ nr.2005/08 për përcaktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave për zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Komuna Në bazë të këtij Udhëzimi Zyrtari/ja për Barazi Gjinore bashkëpunon me Agjencinë për Barazi Gjinore. ABGJ nëpërmjet Zyrtareve për Barazi Gjinore monitoron përfaqësimin gjinor dhe zbatimin e LBGJ-se në nivelin komunal.

Në 24 komuna ka zyrtarë për barazi gjinore. Në katër komuna nuk janë zgjedhur zyrtarët/et për barazi gjinore : Prizreni , Burim, Kaçaniku dhe Kastrioti.

Konform LBGJ-së në tri komuna janë themeluar zyrat për barazi gjinore: komuna e Gjilanit, Dragashit dhe ajo e Shtimes, ndërsa në dymbëdhjetë (12) komuna nuk është themeluar zyra për barazi gjinore, por ka vetëm zyrtarë/e për barazi gjinore. Poashtu mbetet e pa qartë situata me tre zyrat e themeluara sepse ato nuk kanë linja të veçanta buxhetore.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas – Konventa CEDAË - ABGJ në bazë të LBGJ-së neni 5 pika 5.2 (e) Përgatitë raporte për Kosovën mbi përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore të cilat miratohen nga Qeveria.

Ftesa për Raportim nga ana e UNMIK-ut drejtuar Qeverisë së Kosovës është dorëzuar me vonesë prej 8 muajsh dhe ky fakt ka vonuar fillimin e punës për draftimin e Raportit.

Qeveria e Kosovës përmes organit të mandatuar ABGJ, ka finalizuar Raportin e Parë të Kosovës për Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Gruas (CEDAË). Raporti përfshinë periudhën kohore 1999-2007, është raport gjithëpërfshirës mbi gjendjen e grave dhe vajzave në Kosovë. Ky raport është hartuar në bashkëpunim me Zyrën për Çështje Gjinore të UNMIK-ut. Periudhën kohore 1999-2001 e ka mbuluar UNMIK. ABGJ/ZKM është bartëse e procesit të hartimit të Raportit për periudhën kohore 1 janar 2002 – 31 dhjetor 2007.

Raportit për Konventën e CEDAË pasqyron situatën e barazisë dhe çështjeve gjinore nën perspektivën *"De Jure"(ligjore)* dhe *"De Facto"(reale në teren)*.Raporti final është dorëzuar me logon e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kjo ka qenë e pa pranueshme nga Komiteti CEDAË. Deri më tani Komiteti CEDAË nuk ka shprehur gatishmëri për ta pranuar zyrtarisht Raportin mbi Konventën CEDAË të Republikës së Kosovës.

Prioritetet afatshkurtra
ABGJ ka realizuar dhe publikuar Raportin mbi Dhunën në Familje, " Siguria Fillon në Shtëpi", Financuar nga ËSSI/UNDP , me këtë veprim është bërë hapi i parë drejt përmbushjes së Objektivit Strategjik nr. 6. të PKBGJ-së (*Përmirësimi i situatës sociale të grave në risk nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre ndaj shërbimeve sociale cilësore*) i cili parasheh në veprimin ***6.2.4 –Hartimin e një strategjie kombëtare kundër dhunës në familje*** .

ABGJ është në fazën e parë përgatitore të inicimit të: Projekt Ligjit Mbi Dhunën në Familje i cili tani më ka hyrë në Strategjinë Legjislative të Qeverisë, dhe njëkohësisht ka ndërmarrë hapat e parë për identifikimin e partnerëve për grupet e punës (MD; MASHT; MPMS; MSH; Policia e Kosovës, Strehimoret, OJQ-të) për hartimin e Strategjisë Kundër dhunës në Familje. Kjo strategji do të shërbej si udhëzues nacional për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, për parandalimin, sigurinë, drejtësinë, dhe trajtimin e viktimave dhe abuzuesve të dhunës në familje, dhe do të ndihmoj zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e shoqërisë Kosovare. Strategjia do të fokusohet në katër shtylla kryesore: 1) Parandalimi dhe vetëdijesimi, 2) Siguria, 3) Drejtësia, 4) Përkrahja dhe Trajtimi. ABGJ planifikon ta dorëzoj Projekt Ligjin për miratim në Qeveri në muajin Korrik 2009.

ABGJ me qëllim të përmbushjes së Objektivit të 5 të PKBGJ-së (*Përmirësimi i treguesve të Punës për Gratë dhe Vajzat*) ka ndërmarrë hapin e parë në drejtim të realizimit të Hulumtimit "Gratë në Procesin e Punës dhe në Vendimmarrje" i cili synon të identifikoj problemet kyçe me kuptimet e gjinisë dhe të çështjeve gjinore në procesin e punës dhe në vendimmarrje; Hulumtimi pritet të realizohet deri në Korrik të vitit 2009.

ABGJ në mënyrë të vazhdueshme përkrahë Agjencinë për Përkrahjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, në organizimin e Panairit tashmë tradicional " Gratë në Biznes" Qershor 2009. ABGj gjatë nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2008 dhe janarit të vitit 2009 në bashkëpunim me MEF dhe MMPH ka mbeshtetur OJQ-Jemi Pjesë e Botës në realzimin e trajnimit për ngritjën e bizenseve të vogla për gratë.

Objektivi Strategjik 7 i PKBGJ-së (*Përmirësimi i imazhit të grave në media dhe kulturë)* ABGJ bën monitorimin e medieve të shkruara në perspektivën gjinore. Hulumtimin për materialet e monitoruara të vitit 2007, do të publikohet në Qershor 2009.

Prioritetet afatmesme
Objektivi Strategjik nr 1 i PKBGJ-së; (*Përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e gruas),* Agjencia për Barazi Gjinore planifikon të themeloj në kuadër të ABGJ-së Institutin për Hulumtime dhe Studime Gjinore. Ky institut / qendër do të shërbej për krijimin e rekordeve, përmbledhjen e statistikave të ndara në baza gjinore- bazës së të dhënave , fondin e librave, dhe hulumtimeve me qëllim të orientimit të politikave, dhe përfshirjes së çështjeve gjinore si çështje që ndërlidhet në të gjitha aspektet e politikave publike (gender mainstreaming) .

ABGJ ka organizuar Konferencën Dyditore Ndërkombëtare "GJINIA DHE IDENTITETI". Konferenca ishte ndarë në katër sesione dhe i zhvilloj punimet në Prishtinë, me datë 7 dhe 8 mars 2009. Qëllimi parësor i Konferencës ka qenë marrja e përvojave të shteteve rajonale dhe ndërkombëtare për themelimin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Gjinore në kuadër të ABGJ/ZKM. Pjesëmarrës në Konferencë ishin përfaqësuesit/et e botës akademike të shteteve Evropiane dhe nga SHBA, të UP, Ambasadat në Prishtinë, EULEX etj dhe shoqërisë civile .

Në Dhjetor të 2008,ABGJ ka promovuar ëeb faqen me qëllim të shpërndarjes së informatave të detajuara dhe prezantimit të aktivitetve të pikave fokale për barazi gjinore si dhe partnerëve në fushën e çështjeve gjinore.

c. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Të drejtat e minoriteteve në Kosovë janë të rregulluara kryesisht me ligj. Një hap i madh është bërë me miratimin e Kushtetutës nga Kuvendi më 9 prill, ku nenet 57, 58, 59, 60, 61 dhe 62 të Kushtetutës rregullojnë të drejtat e komuniteteve, themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete, përfaqësim në institucione publike dhe institucionet vetëqeverisëse.

Qeveria ka vazhduar të punojë për kornizën institucionale dhe ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Kuvendi ka miratuar ligjin për mbrojtjen e zonave të veçanta për të mbrojtur veçanërisht objektet e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Po ashtu, janë miratuar amendamentet për të siguruar kompatibilitetin e ligjit për planifikim hapësinor me ligjin për mbrojtjen e zonave të veçanta. Janë aprovuar shtatë rregullore që lejojnë aplikimin efektiv të ligjit për trashëgimi kulturore. Tri ligjet janë në përputhje dhe ka filluar zbatimi i tyre i harmonizuar.

Grupi Punues Ndërministror për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturore ka filluar t'i mbajë takimet e rregullta. Grupi punues ka përgatitur planin e veprimit për zonat e veçanta të mbrojtura, planin e veprimit për hartimin e ligjit për Qendrën Historike te Prizrenit, hartimin e ligjit për Hoçën e Madhe, ka organizuar takime informative me përfaqësuesit e nivelit qendror dhe lokal, është hartuar një broshurë me informacione teknike rreth zonave te veçanta te mbrojtura, është hartuar drafti i parë i ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, vazhdon harmonizimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe inkorporimi i zonave të veçanta të mbrojtura në: planet hapësinore të Kosovës, planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe rregullimi i hartave te publikuara ne gazetën zyrtare.

Siguria e trashëgimisë kulturore dhe fetare tani është përgjithësisht më e mirë. Urdhri operativ i Policisë së Kosovës për mbrojtjen e objekteve të Kishës Ortodokse Serbe është duke u zbatuar. Aktualisht Policia e Kosovës ka nën mbikëqyrje 17 objekte fetare ortodokse. Bazuar në urdhrin operativ për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, Policia e Kosovës ka paraparë një mori veprimesh operative, përmes së cilave parasheh mënyrën e ofrimit të sigurisë për trashëgiminë kulturore dhe fetare.

Memorandumi i mirëkuptimit qe është nënshkruar në mes të shërbimit të doganave dhe Ministrisë së Kulturës dhe policisë kufitare, për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe për të krijuar bashkëpunim të kontrollit të kufijve dhe mbrojtur trashëgiminë e lëvizshme kulturore, vazhdon zbatimin me një seri trajnimesh gjatë vitit 2009. Në përgjithësi, zbatimi i ligjit është përmirësuar.

Qeveria përmes Komisionit për Implementim Rindërtues ka përfunduar punët kryesore rindërtuese në tridhjetë e katër objektet religjioze ortodokse serbe të dëmtuara gjatë ngjarjeve të marsit 2004. Disa prej këtyre objekteve, përfshirë Rezidencën Ipeshkvore në Prizren, i janë dorëzuar Kishës Ortodokse Serbe. Kisha është duke planifikuar ribanimin e këtyre objekteve.

Këshilli për Trashëgimi Kulturore sipas ligjit i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, tani është funksional. Është zgjedhur Kryetarja dhe zëvendësi, janë mbajtur takimet e para dhe është hartuar drafti i parë i rregullores së punës sipas ligjit. Nga procesi i mëparshëm i inventarizimit, në një bazë të tët dhënave qendrore në Ministrinë e Kulturës, ka filluar procedimi i të dhënave për afër 3,200 objekte për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore.

Me qëllim të reformimit të institucioneve të trashëgimisë kulturore, bazuar në legjislacionin e ri, në dhjetor të vitit 2008 ka filluar rishikimi funksional i të gjitha mekanizmave administrative në fushën e trashëgimisë. Ministria e Kulturës ka angazhuar ekspertë lokalë shtesë dhe ka fituar një mbështetje nga programi TAIEX për organizimin e këtij procesi. Gjatë fazës së parë të rishikimit, është bërë analiza ligjeve dhe akteve nënligjore si dhe janë bërë intervista me zyrtarët përkatës në institucione të

trashëgimisë, për të krijuar një pasqyrë të qartë të gjendjes në këtë fushë. Reforma planifikohet të përfundojë deri në fund të vitit 2009.

Korniza ligjore

Ligji mbi të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre - është miratuar nga Kuvendi më 13 mars 2008. Ky Ligj gjithashtu ka parashikuar themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës, i cili do të ketë një rol të madh në organizimin dhe artikulimin e qëndrimeve të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat publike dhe programet me rëndësi të veçantë për ta. Në bazë të Ligjit për të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim të afërt me Këshillin Konsultativ për Pakica do të përgatisë, miratojë dhe publikojë një herë në vit një strategji gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve - është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 korrik 2006, ndërsa është shpallur nga PSSP-ja më 20 tetor 2006. Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve është i zbatueshëm bashkë me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/51. Ai garanton të drejtën e barabartë të përdorimit të gjuhëve për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe në gjitha institucionet qendrore të Kosovës, ndërsa me rëndësi shumë të madhe është përdorimi i barabartë i të gjitha gjuhëve në Kuvendin e Kosovës dhe Komisionet e tij. Në nivelin lokal, Ligji garanton që në të gjitha komunat ku komuniteti përfaqëson më shumë se 3% në atë komunë të caktuar, gjuha e caktuar e komunitetit do të përdoret me gjuhët tjera zyrtare. Sfida kryesore e Qeverisë së Kosovës është implementimi i Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve në nivelin qendror dhe atë lokal. Në këtë kuptim, monitorimi i implementimit do të ndërmerret nga ZKM-ja dhe MAPL-ja në dy nivelet, ndërsa raportet e përmuajshme me rekomandime për shërbimet e përkthimit në gjuhët zyrtare do t'i paraqiten Komisionit të Gjuhëve për shqyrtim.

Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore - është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 9 tetor 2006 dhe është shpallur nga PSSP-ja më 6 nëntor 2006. Në fazën aktuale, Ministria e Kulturës është në procesin e hartimit të legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit mbi Trashëgiminë Kulturore, duke udhëhequr drejt një reforme të institucioneve të trashëgimisë kulturore në bazë të Ligjit të ri, si dhe fillimi i një politike të integruar të trashëgimisë kulturore në nivelin nacional.

Ligji për Themelimin e Zonave Speciale të Mbrojtura - është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008 dhe pret shpalljen nga PSSP-ja. Ky ligj përligj mbrojtjen e kishave dhe manastireve të Kishës Ortodokse Serbe dhe zonat historike të rëndësisë së veçantë për Komunitetin serb në Kosovë dhe komunitetet tjera, përmes krijimit të zonave të mbrojtjes së veçantë.

Me qëllim të implementimin të politikave efektive në fushen e të drejtave për pakicat dhe mbrojtja e tyre, dokumentet në vijim janë në iplementim e sipër:

- *Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptian në Republiken e Kosovës 2009-2015.*
- *Strategjia për integrimin e romëve,ashkalinjëve dhe egjiptasve në Kosovë,përbën dokumentin themelor të politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve dhe do të zbatohet gjatë periudhes kohore 2009-2015.*

Korniza institucionale

Ministria për Komunitete dhe Kthim si institucion përgjegjës për komunitete dhe për personat e zhvendosur, ka tri departamente:

1. Departamenti për Komunitete;
2. Departamenti për Kthim; si dhe
3. Departamenti i Administrates.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropianfushën e të drejtave të minoriteteve dhe mbrojtjen e minoriteteve , mes tjerash, MKK-ja do të synojë miratimin e projektligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, do të synojë zbatimin e këtij ligji, do të përgatisë dhe shpallë një konkurs (një herë në vit) për OJQ-të për zhvillimin e projekteve të ripajtimit, tolerancës dhe shumetnicitetit , do të zhvillojë programe të partneritetit me komunat dhe palët e tjera me synim sigurimin e resurseve financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve që të mundësojë kthimin, do të synojë identifikimin e mekanizmave për nxitjen e bizneseve për minoritetet, rishikimin e gjendjes së Strategjisë komunale për kthim në koordinim me zyrat komunale për kthim, etj.

Prioritetet afatmesme
Më qëllim të adresimit të prioriteteve afatmesme , mes tjerash, MKK-ja synonë vazhdimin e procesit të deritashëm për financimin e projekteve të pjesëtarëve të komuniteteve, që ka për qëllim, zhvillimin dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare, do të realizojë projektet të cilat kanë të bëjnë me kthimin dhe kthim të qëndrueshëm, do të synojë mbështetjen dhe financimin e përhershëm të kthimit individual dhe të organizuar, organizimin e fushatave gjithëpërfshirëse me komunitetet në Kosovë me qëllim të promovimit të drejtave të njeriut dhe dialogut ndëretnik, dhe do të synojë organizimin e një cikli të trajnimeve dhe sesioneve informative në të gjitha komunat e Kosovës dedikuar të gjitha komuniteteve.

2.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE

Republika e Kosovës është e fokusuar që të krijojë dhe forcojë marrëdhëniet me shtete e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst duhet të shihet edhe krijimi i kapaciteteve të Zyrës për Çështje Rajonale në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila do të jetë e angazhuar në bashkë krijimin e politikave karshi vendeve fqinje, si dhe hapjes së ambasadave në kryeqendrat e ndryshme ballkanike.

Ministra e Punëve të Jashtme planifikon që të nënshkruajë një varg marrëveshjesh dypalëshe me këto vende. Forcimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe krijimi i një rajoni të sigurt i shërben synimit të Republikës së Kosovës për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Kjo është e qartë pasi që BE kërkon që aktivitetet të zhvillohen në përforcimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, pjesëmarrje aktive në nismat rajonale, si dhe bashkëpunim të ngushtë rajonalë në fushën e zbatimit të ligjit. Andaj institucionet dhe Qeveria e Kosovës janë fuqishëm të angazhuar për t'i arritur këto objektiva.

Krahas forcimit të marrëdhënieve dypalëshe, Qeveria e Kosovës është e angazhuar edhe në përfshirjen e Kosovës në nismat dhe organizmat rajonale. Në këtë kontekst duhet parë edhe përpjekjet për të ngritur kapacitete e Zyrë së Koordinatorit Kombëtar për Këshillin Rajonal për Bashkëpunim (RCC), që është pasardhëse e Paktit të Stabilitetit. Me anë të këtyre mekanizmave synohet që të koordinojmë prezencën e ministrive përkatëse të Kosovës, dhe prezencën sa më aktive të Kosovës në to, si përpjekjet për përfaqësimin e Kosovës në SEECP, si dhe zbatimin e Marrëveshjes Rajonale për Tregti të Lirë (CEFTA), të nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës, e të ratifikuar nga Kuvendi. Kosova aktualisht merr pjesë edhe në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETOEJL), Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), si dhe vazhdon të zbatojë dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

2.2 KRITERET EKONOMIKE

Ky kapitull pasqyron planet e Republikës së Kosovës drejt plotësimit të kritereve ekonomike të Kopenhagës, i cili kërkon ekzistimin e një ekonomie funksionale tregu si dhe ekzistimin e kapacitetit të vendit aspirant për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së.

2.2.1 EKZISTIMI I EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT

Një ekonomi funksionale e tregut arrihet kur ka një shkallë pajtueshmërie mbi themelet e shtetit, politikën ekonomike, kur arrihet baraspesha në mes konkurencës së lirë dhe forcave të tregut, kur sektori privat mbështetet nga një treg financiar i zhvilluar, si dhe kur qeveria ndërton kapacitetet e domosdoshme për të korrigjuar dështimet e caktuara të tregut, pra duke mbështetur bizneset me ndërtimin e një kornize të fuqishme rregullative të hyrjes dhe daljes nga tregu.

a. Thelbi i politikës ekonomike

Informatat më të reja mbi aktivitetet vjetore ekonomike tregojnë për një dinamizim të rritjes ekonomike në krahasim me atë të vitit 2007. Kjo rritje është mbështetur nga përmirësimet e kërkesave vendore dhe atyre të jashtme. Ekziston një deficit i lartë i ekonomik sepse ekonomia është në procesin e zhvillimit të shpejtë, me investime dhe eksporte në rritje të përshpejtuar, gjë që në anën tjetër reflecton me rritje tjera në importe.

Gjatë vitit 2008, Kosova ka pasur një rritje të BPV-së prej rreth 5.4%. Kontributin më i madh në këtë rritje kan dhënë investimet, kryesisht investimet publike, si dhe në të njëjtën kohë ka pasur një rritje të eksporteve gjë që ka ndikuar në përmirësimin bilancit tregtar dhe llogarisë rrjedhëse. Megjithatë, projeksionet për vitin 2009, janë shumë të paqarta për faktin që efektet e krizës globale janë vështirë të maten, prandaj duke marrë për bazë disa supozime mbi efektet e para direkte të kësaj krize, rritja është projektuar se do të jetë rreth 4.2%.

Sa i përket lëvizjes së çmimeve, sipas ESK-së, inflacioni mesatar nga viti në vit ka arritur në 9.4%, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit dhe naftës në nivel botëror. Në veçanti gjatë gjysmës së parë të vitit, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është rritur për reth 13%, ndërkaq që në gjysmën e dytë të vitit kemi pasur një stabilizim të çmimeve që ka ndikuar që inflacioni mesatar gjatë vitit të jetë 9.4%. Stabilzimi i çmimeve në gjysmën e dytë të vitit erdhi si pasojë e rënies së çmimeve të naftës, rënie e cila i parapriu edhe rënies së çmimeve të ushqimeve.

Trendi i lëvizjes së normës së inflacionit, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, ishte një reflektim i efektit të rënies së çmimeve botërore, në veçanti gjatë tremujorit të fundit të vitit. Ashtu siç raportohet nga ESK, norma mesatare vjetore e inflacionit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 ishte 6.2%, krahasuar me rritjen mesatare vjetore prej 12.9% gjatë gjysmës së parë të vitit 2008. Ndërkaq, norma mesatare vjetore e inflacionit gjatë tërë vitit 2008 ishte 9.4%. Në përgjithësi, gjysma e dytë e vitit 2008 është karakterizuar me ulje të normës së inflacionit të atyre kategorive që ndikuan në rritjen e theksuar të inflacionit gjatë gjysmës së parë të vitit 2008. Gjysma e dytë e vitit u shoqërua më një rënie të përshpejtuar të çmimeve të naftës, e cila filloi nga muajt korrik dhe gusht. Përderisa gjatë gjysmës së parë të vitit 2008, çmimet e naftës janë rritur me një mesatare vjetore prej 22.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjatë gjysmës së dytë të vitit këto çmime u rritën me një mesatare vjetore prej 6.0%. Ulja e çmimit të naftës ishte si rezultat i rënies së çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar, ku gjatë muajit dhjetor çmimi mesatar për fuçi ra në rreth $42 krahasuar muajt maj-qershor, kur çmimi i naftës tejkaloj vlerën prej $130 për barel.

Kriza financiare e përcjellur me rënie të ekonomisë reale në shumicën e vendeve të industrializuara, ndikoi në rënien e kërkesës për naftë në këto shtete gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, e në veçanti gjatë tremujorit të fundit. Edhe pse ulja e çmimit të naftës pritej të përcillej me rritje të kërkesës për këtë artikull kjo nuk ndodhi kështu, për faktin se shumica e vendeve të zhvilluara u goditën në masë të konsiderueshme nga kriza ekonomike gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008. Kjo krizë u reflektua me rënie të prodhimit industrial, e pasuar me ulje të eksportit nga këto vende, si dhe rritje të mëtejshme të shkallës së papunësisë. E tërë kjo situatë ka bërë të ketë një ngadalësim të aktivitetit ekonomik në botë.

Figura 1. Ndryshimi mujor nga vitit në vit i çmimeve të naftës



Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës

Përveç çmimeve të naftës, edhe çmimet e ushqimit gjatë kësaj periudhe kanë shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, megjithatë kanë vazhduar të jenë mjaftë të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, çmimet e ushqimit u rritën me një mesatare vjetore prej 10%, krahasuar me rritjen prej 25.5% që ka ndodhur gjatë gjysmës së parë të vitit. Kjo rënie e çmimeve të ushqimit në masë të madhe është ndikuar nga rënia e çmimit të naftës. Duke pasur parasysh që vendi ynë në masë të madhe është i varur nga importi, përfshirë gjithashtu edhe produktet ushqimore, efekti i një rënie të tillë është vërejtur edhe në ekonominë tonë.

Një indikator i rëndësishëm që duhet të analizohet është IÇK, duke përjashtuar çmimet e naftës dhe produkteve ushqimore. Ky indikator gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, për dallim prej totalit të IÇK-së, ka shënuar një ngritje mesatare vjetore prej rreth 2.2%. Ashtu siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm, niveli i inflacionit të IÇK-së duke përjashtuar çmimet e naftës dhe të ushqimit gjatë kësaj periudhe ka qenë dukshëm më i ulët, krahasuar me IÇK-në totale. Kjo shifër konfirmon faktin që niveli i lartë i inflacionit gjatë kësaj periudhe kryesisht ka qenë i ndikuar nga rritja e çmimeve të naftës dhe produkteve ushqimore.

Figura 2. Indeks i Çmimit të Konsumit (IÇK), ***ndryshimi në % vit për vit***



Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës

Shërbimi financiar i Kosovës është i vogël por ka rritje të shpejt në disa fusha. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është e autorizuar për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare. Sektori financiar dominohet nga bankat komerciale, të cilat kanë qenë stabile, edhe pse ka nevojë për zgjerim të mëtutjeshëm të shërbimeve financiare dhe sidomos ofrimin e huave afatgjata me kosto më të ultë për ekonominë. Edhe përkundër krizës financiare botërore, gjatë vitit 2008 sistemi bankar në Kosovë, ka qenë mjaft stabil. Vlen të ceket, se në të njejtën kohë depozitat kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, prej 26.4% krahasuar me fundin vitit të kaluar. Gjithashtu, kreditë kanë shënuar një rritje të ndjeshme, në këtë kuadër kreditë e këqija janë mjaftë të ulëta dhe si të tilla gjatë këtij viti kanë shënuar rënie, nga 4,1 % në 3.3% të vlerës së kredive të dhëna.

Shuma e deficitit tregtar të Kosovës në vitin 2008 arriti në rreth 1.7 miliard euro, ose 45.2 % të BPV-së. Kjo përqindje është më e lartë se mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore, si dhe tregon që ekonomia e Kosovës është e hapur dhe mirë e integruar në ekonominë globale. Importet e mallrave gjatë 2008-ës ishin në vlerën prej 1.95 miliardë euro, një rritje prej 23% në krahasim me vitin 2007, derisa eksportet arritën vlerën prej në 199 milionë euro, pra një rritje prej 20 % në krahasim me vitin e kaluar. Mbulimi i importeve me eksporte është përmirësuar në 10.1 % në vitin 2008, nga rreth 5% sa ishte në vitin 2005.

b. Stabiliteti makroekonomik

Çështjet ekonomike, financiare, fiskale dhe buxhetore janë përgjegjësi e institucioneve të Kosovës. Menaxhimi i shpenzimeve publike është i rregulluar me Ligjin mbi Menaxhimin e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësinë Financiare 2003/2. Në mungesë të instrumenteve dhe politikave monetare, politika fiskale mbetet instrumenti kryesor makroekonomik përmes të cilit Qeveria e Kosovës ndikon në ekonomi. Kështu, kufizimi dhe përgjegjësia në dimensionin e politikës fiskale janë thelbësore për arritjen e synimeve qeveritare. Politikat buxhetore aktuale janë fokusuar në ruajtjen e kufijve të shpenzimeve rrjedhëse duke i rritur ato në harmoni me rregullën fiskale dhe rritjen e shpenzimeve kapitale. Një politikë e tillë synon që të ndikoj drejtëpërdrejtë në rritjen dhe përimirësimin e infrastrukturës së vendit e cila do të ndikonte në përmirësimin dhe lehtësimin e ambientit për biznes.

Sistemi tatimor është i bazuar në bazën uniforme dhe të gjerë tatimore, me shumë pak përjashtime. Nivelet tatimore janë përgjithësisht të ulta dhe tentojn të adresojnë çështjet e efikasitetit dhe t'i mundësojnë autoriteteve të gjenerojnë të hyra të mjaftueshme për financimin e shpenzimeve thelbësore pa e rritur nevojën për huamarrje. Në këtë drejtim që nga janari i vitit 2009 ka filluar të implementohen ndryshimet e miratuara në sistemin tatimor, ndryshime të cilat Kosovën e bëjnë vendin me normat më të ulëta tatimore në rajon. Këto ndryshime tatimore kanë për qëllim zhvendosjen e barrës tatimore prej

tatimeve direkte në tatimet në konsum. Të ardhurat buxhetore kanë treguar një rritje të konsiderueshme në tri vitet e fundit, dhe në të njëjtën kohë shpenzimet kanë shënuar një rritje të konsiderueshme sidomos pjesa e shpenzimeve kapitale, gjatë vitit 2008 ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ka qene shumë i suksesshëm me një rritje prej 122% krahasuar me vitin paraprak.

Korniza ligjore për menaxhimin e shpenzimeve publike është mjaft solide, por problemet shtrihen në implementimin e saj, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative dhe njohjes së legjislacionit të miratuar. Këto në shumë raste krijojnë probleme në ekzekutimin e buxhetit në gjysmën e parë të vitit. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) dhe iniciativat e Programit të Investimeve Publike janë duke kontribuar në një menaxhim më transparent fiskal, edhe pse planifikimi strategjik dhe analiza e propozimeve të buxhetit mbeten të zhvillohen edhe më tutje. Aktivitetet dhe reformat në lidhje me procesin e statusit janë përfshirë në pjesën më të madhe në buxhetin e vitit 2009. Asistenca e jashtme ka qenë thelbësore në drejtim të përforcimit të kapaciteteve ligjore dhe institucionale. Megjithatë, struktura institucionale dhe planifikimi i çintegruar i asistencës së donatorëve krijon probleme në transparencë, përgjegjshmëri dhe efikasitet.

Qeveria është e përkushtuar të ushtrojë përgjegjësi në çështjet fiskale. Qeveria ka miratuar Buxhetin për 2009 bazuar në nevojën e ndjekjes së politikave të shëndosha fiskale, sidomos duke theksuar nevojën për të siguruar që politikat sociale të jenë në përputhje me qëndrueshmërinë afatgjate të financave publike.

Për të siguruar vazhdimësinë e vendimeve qeveritare, KASH do të rishqyrtohet dhe azhurnohet për të qenë në gjendje të harmonizojë prioritetet e përcaktuar në projektbuxhetin e vitit 2009 si dhe në të njëjtën kohë të kontribuoj në përgaditjen e buxhetit të vitit 2010. Ligji mbi Menaxhimin e Financave publike është amandamentuar dhe si i tillë ky ligj është duke u zbatuar duke ndihmuar në shmangjen e diskrepancave ligjore dhe institucionale. Një punë e rëndësishme parashikohet në kuptimin e vlerësimit të politikave fiskale dhe legjislacionit rrjedhës në drejtim të sigurimit të përputhshmërisë së tyre me *Acquis communitaire* si dhe për të krijuar një ambient më të favorshëm për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, duke promovuar kështu zhvillimin e biznesit në Kosovë dhe për të rritur prodhimtarinë.Në drejtim të arritjes së synimimeve të Qeverisë dhe implementimit të prioriteteve, janë paraparë masa në drejtim të përforcimit të kapaciteteve administrative për elaborimin e buxhetit dhe planifikimin strategjik si në nivelet qeveritare qëndrore ashtu edhe ato komunale.

Duke u bazuar në politikat prioritare të Qeverisë për vitin 2009 (Rritja ekonomike, Implementimi i kërkesave që dalin nga marrveshja mbi statusin, Qeverisja e mirë dhe Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social) është hartuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012. Në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive është duke u bërë azhurnimi i KASH-it me qëllim të harmonizimit të prioriteteve të Qeverisë si dhe përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2010 dhe projeksioneve për vitet 2011 dhe 2012.

Përmirësimi i shkallës së ekzekutimit të shpenzimeve kapitale ishte sfidë për Qeverinë në vitin 2008 (përkundër se Buxheti për këtë vit është aprovuar në muajin shkurt 2008) pasi që në vitin 2007 dhe viteve të mëparshme nuk ishte më i lartë se 70%. Mirëpo, me një planifikim më të mirë të buxhetimit shumëvjeçar, ndryshimet në Ligjin e Prokurimit Publik duke shkurtuar afatet e tenderimit dhe zvogëluar procedurat e prokurimit, trendi i ekzekutimit të buxhetit kapital krahasuar me buxhetimin, është rritur nga 69.8% (2007) në 79,9 % (2008).

Gjithashtu, në vitin 2009 investimeve kapitale,kanë një trend të lehtë rritjeje krahasuar me vitin 2008.

Gjatë vitit 2008, shpenzimet buxhetore kanë qenë dukshëm me të larta sesa në vitin e kaluar. Kjo rritje e nivelit të shpenzimeve nga ana e organizatave buxhetore mund të konsiderohet një hap i rëndësishëm

drejt krijimit të një administrate publike efikase në realizmin e projekteve të parapara sipas buxhetit. Shpenzimet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 kanë qenë €615.7 milionë, që është për 60% më tepër sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje e shpenzimeve është e ndërlidhur kryesisht me rritjen e shpenzimeve kapitale. Në të njëjtën kohë edhe kategoritë e tjera të shpenzimeve kanë shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shpenzimet rrjedhëse – Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, këto shpenzime kanë qenë €327.5 milionë, ose 53.2% të totalit të shpenzimeve. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pjesëmarrja e tyre në totalin e shpenzimeve ka rënë për 16.5%. Rënia e pjesëmarrjes së shpenzimeve rrjedhëse në shpenzimet totale të qeverisë ka ndodhur për shkak se ka pasur disa përmirësime në realizimin e shpenzimeve kapitale gjatë kësaj periudhe. Pagat dhe mëditjet – Kjo kategori kap shumën prej €118.6 milionë, që përbëjnë 19% të totalit të shpenzimeve për periudhën e vëzhguar. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve ka rënë për 9 %. Kjo rënie ka qenë rezultat i respektimit të vendimit qeveritar për ngadalësimin e punësimit në sektorin publik, duke përjashtuar rastet e themelimit të institucioneve të reja dhe rasteve të domosdoshme. Një faktor tjetër i kësaj rënie është edhe fakti që kategoritë tjera janë rritur në mënyrë shumë të ndjeshme në krahasim me këtë kategori.

Figura 3. Shpenzimet totale buxhetore, ***sipas kategorive ekonomike***



Burimi: Departamenti i Thesarit

Mallrat dhe shërbimet – Shpenzimet në këtë kategori gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit 2008 ishin €90.2 milionë, që përbëjnë 14.6% e totalit të shpenzimeve për këtë periudhë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë qenë më të larta për €11.3 milionë, përderisa janë për 5 % më të ulëta në raport me vitin e kaluar si pjesëmarrje në totalin e shpenzimeve të përgjithshme.

Subvencionet dhe transferet – Kjo kategori përfshin: transferet sociale, subvencionet për NPP-të dhe transferet dhe subvencionet për organizatat e caktuara buxhetore. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, shpenzimet në këtë kategori kanë qenë rreth €108.7 milionë, duke përbërë 17.7% të totalit të shpenzimeve për këtë periudhë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ato kanë qenë për 44% më të larta. Rritja e subvencioneve dhe transfereve ka qenë rezultat i pagesave më të larta për pensionistët kontribues në skemën e mëhershme pensionale, si dhe ka filluar të bëhen pagesat për të gjitha kategoritë e specifikuara në Ligjin për Dëshmorët.

Shpenzimet kapitale – Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, kjo kategori e rëndësishme ka kapur shumën prej €288.4 milionë, ose 46.8% e totalit të shpenzimeve për këtë periudhë. Kjo shumë është për 146% më e madhe se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo tregon se agjencitë buxhetore kanë bërë përmirësime në shpenzime kapitale. Përvoja nga vitet e kaluara, ku një pjesë e madhe e shpenzimeve kapitale janë bërë në gjysmën e dytë të vitit, ka qenë prezente edhe në këtë vit. Krahasuar me buxhetin e aprovuar për këtë kategori të shpenzimeve, vërehet që shkalla e ekzekutimit ka qenë dukshëm më e

lartë duke arritur në nivelin prej 80% të mjeteve të parapara. Kjo shkallë e ekzekutimit të mjeteve kapitale është shumë inkurajuese për faktin që edhe vendet me një traditë të gjatë të funksionimit nuk janë në gjendje të bëjnë ekzekutimin e plotë të këtyre mjeteve sipas planit të paraparë buxhetor.

Figura 4. Shpenzimet buxhetore sipas funksioneve të Qeverisë , *% të pjesëmarrjes në total*



Burimi: Departamenti i Thesarit

Struktura e shpenzimeve sipas funksioneve qeveritare tregon që pjesa më e madhe e buxhetit të Qeverisë së Kosovës gjatë kësaj periudhe është alokuar për kategorinë "Ekonomia dhe të Tjerat", me një pjesëmarrje prej 33% e totalit të shpenzimeve për këtë periudhë. Kjo përqindje paraqet një dallim shumë substancial në raport me vitin e kaluar, ku kategoria me pjesëmarrje më të lartë në shpenzimet buxhetore ka qenë kategoria sociale.

Në terma nominal, kemi një rritje të shpenzimeve në pothuajse të gjitha kategoritë, kjo për faktin që edhe shuma e buxhetit të aprovuar në vitin 2008 ka qenë shumë më e lartë sesa në vitin e kaluar. Nga kjo perspektivë vërejmë një trend rritjes tek të gjitha kategoritë.

Kategoria "Shërbimet e përgjithshme publike" ka shënuar një rritje në vlera nominale prej €53 milionë në raport me vitin e kaluar, që nënkupton se gjatë këtij vitit kemi pasur edhe krijimin e institucioneve të reja si rezultat i nevojave të krijimit të institucioneve të reja pas shpalljes së pavarësisë. Në këtë kuadër, edhe kategoria e "Arsimit" dhe ajo e "Shëndetësisë" kanë gëzuar një përkrahje më të madhe për faktin që në terma nominalë janë rritur me nga €13 milionë secila në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Me Pakon e shpenzimeve të pas-statusit në pajtim me Planin e Ahtissarit janë kërkuar dhe buxhetuar shpenzime shtesë për themelimin e strukturave të reja institucionale, kompetencat e reja, përfaqësime diplomatike, forca e sigurisë, decentralizim dhe borgje të jashtme. Në këtë drejtim Qeveria ka bashkëpunuar me partner ndërkombëtar në vlerësimet e shpenzimeve të pas-statusit. Gjithashtu, rezerva minimale është rritur nga 50 milion euro në vitin 2008 në 200 milion euro në vitin 2009. Në anën tjetër Qeveria është duke ndërmarrë hapa të tjerë në drejtim të përgatitjeve për anëtarësim dhe bashkërendimin me institucionet financiare rajonale dhe ndërkombëtare.

Dy institucionet kryesore të cilat merren me mbledhjen e të hyrave tatimore janë Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës. Gjatë gjithë periudhës këto institucione kanë shënuar rezultate të konsiderueshme në mbledhjen e të hyrave tatimore. Raporti preliminar i thesarit për vitin 2008 tregon se të hyrat buxhetore për periudhën korrik – dhjetor kanë qenë prej €533 milionë, ose 21% më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Këto shifra flasin qartazi për një performansë mjaftë të suksesshme në mbledhjen e të hyrave buxhetore.

Nëse shikohet struktura e të hyrave buxhetore, pothuajse të gjitha kategoritë kanë treguar rritje të ndjeshme. Kjo rritje e të hyrave buxhetore mund të jetë rezultat i shumë faktorëve të cilët kanë qenë prezent.

Figura 5. Struktura e të hyrave buxhetore, ***% pjesëmarrjes në total***



Burimi: Departamenti i Thesarit

Edhe më tutje pjesa më e madhe e të hyrave ka vazhduar të mblidhet nga tatimet në kufi, që gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 kanë përbërë 64.2% të të hyrave totale buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pjesëmarrja e kësaj kategorie është zvogëluar për 2.4%. Duke e krahasuar pjesëmarrjen e tatimeve të mbledhura brenda vendit, në këtë periudhë të vitit 2008 ato kanë qenë 21.9% të totalit të të hyrave buxhetore, ose për 0.7% më të ulëta sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përderisa shprehur në terma nominal, tatimet vendore gjatë kësaj periudhe janë shtuar për €17 milion. Vlen të ceket që gjatë kësaj periudhe, një rol të rëndësishëm në gjenerimin e të hyrave buxhetore kanë luajtur edhe të hyrat jo-tatimore, të cilat gjatë periudhës raportuese kanë përfshirë 9.1% e të hyrave të përgjithëshme të mbledhura.

Bazuar në këtë raport të thesarit, fundi i vitit 2008 tregon që të hyrat e përgjithshme buxhetore për këtë vit kanë qenë për 5.3% më të larta sesa në vitin e kaluar. Kjo rritje është më e lartë nëse i përjashtojmë të hyrat e njëhershme, të cilat janë mbledhur në vitin 2007, që nënkupton se të hyrat janë rritur më 15% krahasuar me vitin e kaluar.

Të hyrat doganore edhe më tutje mbesin gjenerues kryesor i të hyrave buxhetore të Kosovës gjatë kësaj periudhe. Faktor më i rëndësishëm që ka ndikuar në performancën më të mirë të këtyre të hyrave ka qenë edhe ngritja e çmimeve të naftës dhe produkteve ushqimore në përgjithësi. Taksat doganore – Siç ilustrohet në grafikun më poshtë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 të hyrat e mbledhura nga taksat doganore kanë kapur vlerën prej €53 milionë, që korrespondon me rritjen prej 27% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007. Rritja është kryesisht rezultat i efektit të rritjes së çmimeve të derivateve të naftës dhe të kontrollit më të mirë në pikat doganore. Vlen të përmendet se, edhe pse gjatë kësaj periudhe të vitit kemi pasur probleme me pikën doganore në pjesën veriore të Kosovës, të hyrat kanë qenë më të larta se sa që kemi pritur. Në gjysmën e dytë të vitit ka pasur një mbledhje më të mirë të tatimeve doganore, duke e pasur parasysh vëllimin e rritur të mallrave të importuara krahasuar me gjysmën e parë të këtij viti. Gjithashtu, ky dallim sezonal nuk ndodh vetëm në këtë vit, por është vërejtur edhe gjatë viteve të kaluara.

Figura 6. Të hyrat tremujore nga tatimi doganor, ***në milion euro***



Burimi: Dogana e Kosovës

Të hyrat nga taksa doganore kanë shënuar një rritje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, e cila mund të vlerësohet që është rrjedhojë e ngritjes së çmimeve në tregun botëror në përgjithësi. Të hyrat nga taksa doganore gjatë vitit 2008 në raport me vitin e kaluar, kanë shënuar një rritje prej 21% krahasuar me vitin e kaluar. Taksa e akcizës – Ky është një tatim specifik i cili mblidhet në mallrat e luksit (derivate në naftës, duhan, pije alkoolike etj.). Mbledhja e tatimit në akcizë ishte më e lartë se sa në periudhën e vitit të kaluar për 13%. Kjo rritje është rezultat i mbledhjes më të madhe të akcizës së duhanit në fund të vitit.

Figura 7. Të hyrat tremujore nga taksa e akcizes në kufi, ***në milion euro***



Burimi: Shërbimi Doganor i Kosovës

Të hyrat në fillim të këtij viti (tremujori i parë) nga kjo kategori ishin më të ulëta, kryesisht për shkak të mbledhjes më të ulët të akcizës në duhan dhe alkool, që është përcjell me rritje të madhe të mbledhjes së akcizës në tremujorin e dytë, që ka rezultuar me neto rritje prej €9.2 milionë. Në fund të vitit 2008 (muaji dhjetor) ka qenë shumë i lartë që ka ndikuar që edhe të hyrat e përgjithshme nga kjo taksë të jenë shumë më të larta, sesa në vitin e kaluar, me një rritje prej 23%. Kjo rritje e të hyrave nga kjo taksë ka ardhur si rezultat i disa faktorëve: në fund të vitit, si rezultat i vendimit të Qeverisë për ngritjen e normës së akcizës në duhan duke filluar nga 1 janari i vitit 2009, ka shtyrë bizneset që merren me import të duhanit të importojnë sasi të konsiderueshme të stoqeve me normat e vjetra; gjithashtu, gjatë vitit 2008 kemi pasur efektin e rritjes së akcizës në derivate të naftës, si rezultat i heqjes së taksës doganore për këto mallra. TVSH në kufi – Të hyrat e mbledhura nga ky tatim janë rritur për 27% gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo pjesërisht mund të jetë për shkak të rritjes së vlerës së importeve dhe pjesërisht edhe për shkak të rritjes së efikasitetit të administrimit nga Shërbimi Doganor.

Figura 8. Të hyrat tremujore nga TVSH e mbledhur në kufi, ***në miliona euro***



Burimi: Shërbimi Doganor i Kosovës

Siç tregon grafiku i mësipërm, mbledhja e TVSH-së në kufi është shumë më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa që kjo rritje ka ndodhur për shkak të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe rritjes së vëllimit të importeve të disa mallrave.

Vlen të ceket që në tremujorin e fundit kemi pasur një rritje shumë të theksuar të të hyrave nga ky tatim, që pjesërisht mund të jetë i ndikuar nga rritja e importit të duhanit në fund të vitit, si dhe pjesërisht nga rritja e efikasitetit të Shërbimit Doganor. Bazuar në të dhënat nga ESK-ja, çmimet janë rritur me një mesatare prej 9.4% krahasuar me vitin e kaluar, që nënkupton se për këtë shumë edhe vlera e mallrave të importuara ka bërë që baza mbi të cilën aplikohen taksat në kufi të jetë më e lartë.

Tatimet e mbledhura brenda vendit përbëhen kryesisht nga TVSH dhe tatimi në të ardhura personale. Për gjysmën e dytë të vitit 2008 ato kanë qenë më të larta për 17% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlen të ceket që mbledhja e të hyrave të brendëshme ka shënuar një performansë mjaftë të mirë gjatë kësaj periudhe. Efekti i ngritjes së çmimeve në tregun ndërkombëtar ka ndikuar edhe në rritjen e nivelit te të hyrave brenda vendit, sidomos sa i përket TVSH-së vendore.

Figura 9. Të hyrat e mbledhura nga TVSH e brendshme, ***në miliona euro***



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

TVSH vendore – Mbledhja është rritur gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 për 19% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo pasqyron një ngritje e vetëdijesimit të komunitetit të biznesit për tu regjistruar si tatimpagues të TVSH-së. Grafiku i mësipërm tregon se mbledhja e TVSH-së gjatë kësaj

periudhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është shtuar dukshëm, ndonëse shifrat mund të ndryshojnë për shkak të procesit të vazhdueshëm të barazimit të shënimeve në ATK. Faktor tjetër që duhet të përmendet është se gjatë kësaj periudhe të vitit 2008, ka pasur një rritje të dukshme të kthimit të TVSH-së. Gjithashtu edhe vendimi për faljen e ndëshkimeve për të gjitha bizneset të cilat hyjnë në marrëveshje me ATK-më për shlyerjen e borxheve të mëhershme ka ndikuar që të kemi të hyra shtesë sa i përket TVSH-së. Tatimi në të ardhurat personale – Vendoset për të gjitha llojet e të hyrave dhe jo vetëm për paga. Aplikohet për të hyrat nga aktivitetet e biznesit, të hyrat nga punësimi, të hyrat nga investimet, të hyrat nga pronësia intelektuale dhe industriale, të hyrat nga qiraja dhe të tjera. Të dhënat e ofruara nga ATK-ja tregojnë që mbledhja e të hyrave gjatë kësaj periudhe të vitit 2008 ka qenë më e lartë për 25%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Figura 10. Të hyrat e mbledhura nga TVSH e brendshme, ***në miliona euro***



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Në kuadër të tatimit në të ardhura personale, pjesa më e madhe e të hyrave mblidhen nga tatimi në pagë, që përben rreth 80% të këtij lloj tatimi. Kjo na sygjeron qe kemi pasur një rritje të shkallës së deklarimit të numrit të të punësuarve. Tatimi në të hyrat e korporatave – Është tatim që aplikohet në të hyrat e korporatave. Kriteri për t'iu nënshtruar këtij tatimi ka të bëjë me formën ligjore të organizmit të biznesit, e jo me qarkullimin dhe shitjet bruto ose vëllimin e aseteve, pasi këto kanë të bëjnë me tatimin në fitim.

Figura 11. Të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave, ***në miliona euro***



Burimi: Administrata tatimore e Kosovës

Të hyrat nga kjo kategori e tatimeve gjatë kësaj periudhe kanë qenë për 74% më të larta se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje kaq e lartë vjen si rezultat i rritje së shkallës së deklarimit

si dhe fillimit të nënshkrimit të kontratave për shlyerjen e borxheve (vendimi i Qeverisë për faljen e ndëshkimeve nëse bizneset pranojnë të futen në kontratë për të paguar borxhin ndaj ATK-së).

Të hyrat jo tatimore dhe të hyrat vetanake komunale kanë pasur një ngritje të theksuar prej 35% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje e kësaj kategorie të të hyrave ka ardhur si rezultat i mbledhjes dukshëm më të madhe të tatimit në pronë, që ka bërë që të hyrat vetanake të komunave të jenë dukshëm më të larta. Ndërsa, të hyrat jo-tatimore në nivelin qendror janë rritur dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Së pari, kemi pasur një ngritje të të hyrave nga interesi si rezultat i investimit të mjeteve të BKK-së në tregjet ndërkombëtare, si dhe kemi pasur edhe fillimin e ndërrimit të dokumentacionit që po ashtu ka ndikuar në ngritjen e niveli të të hyrave jotatimore.

c. Bashkëveprimi i forcave të tregut

Liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë (ekuilibri i kërkesës dhe ofertës) arrihet përmes ndërveprimit të lirë të forcave të tregut. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve përcaktohen lirshëm sipas kushteve të tregut, ku monopolet paraqiten në rast të mungesës së konkurrencës. Rregullatorët e pavarur janë themeluar me sukses dhe janë në fazën e konsolidimit.Për shkak të ekonomisë së saj të vogël, Kosova është e përkushtuar për liberalizim e mëtutjeshëm të tegut.. Qeveria po ndërmerr hapa të tjerë në implementimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe fitimit të drejtës së qasjes në regjime tjera ndërkombëtare të tregtisë.

d. Hyrja dhe dalja në treg

Ekonomia e Kosovës karakterizohet me mungesë të barrierave të rëndësishme ndaj hyrjes në treg (themelimi i firmave të reja) dhe daljes (bankrotimet, likuidimet). Një qëllim i rëndësishëm i Qeverisë është përforcimi i mjedisit afarist për t'i mundësuar firmave kosovare të konkurrojnë në tregjet rajonale dhe globale. Mungesa e qartësisë së legjislacionit dhe kornizës rregullative ekzistuese, si dhe korrupsioni në sektorin publik konsiderohen disa nga pengesat kryesore në ekonomitë në tranzicion, in këtë drejtim Qeveria është zotuar të eliminojë këto penngesa dhe të ndërtojë një mjedis të shëndoshë biznesi.Mangësitë në Rregulloret ekzistuese lidhur me themelimin e bizneseve dhe funksionimin e tyre janë shëndrruar në stimuj të fuqishëm për të mbetur në ekonominë joformale dhe joatraktivitetin e Kosovës për investime të huaja direkte. Pra, Qeveria është zotuar të eliminojë barrierat ndaj hyrjes dhe procedurave të bankrotimit dhe likuidimit të kompanive.

Sa i përket përmirësimit të mjedisit biznesor dhe kapacitetit institucional për t'u përballur me nevojën për reforma, është arritur një përparim i konsiderueshëm në miratimin e praktikave më të mira të BE-së mbi Ligjet për Kompanitë dhe sistemin e regjistrimit të bizneseve. Këto reforma të ndërrmarra janë arsyeja kryesore e ndryshimit të numrit, strukturës si dhe rolit dhe pozitës së ndërmarrjeve në ekonomi. Kosova ka disa nga indikatorët më të mirë në rajon në lidhje me regjistrimin e bizneseve (1-3 ditë pune). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), me mbështetjen e komunitetit donator, vazhdimisht ka përmirësuar sistemin e saj elektronik të regjistrimeve. Faktet nga MTI-ja tregojnë që shumica e regjistrimeve janë bërë brenda një dite të vetme, me kohë një mesatare kohore të regjistrimit prej 0.7 ditë. MTI-ja me sukses ka aplikuar një numër skemash si "One Stop Shop" për të mundësuar iniciativat e reja afariste.

Dalja nga tregu është e rregulluar me Ligjin e Bankrotimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2007. Legjislacioni përafron direktivat e BE-së për procedura të forta të daljes dhe likuidimit. Harmonizimi i procedurës së bankrotimit, përshpejtimi, kostefikasiteti dhe drejtësia karrshi kreditorëve dhe palëve të përfshira, si dhe ndërtimi i organeve efikase të monitorimit dhe implementimit, janë disa nga synimet kryesore të Qeverisë.

e. Sistemi ligjor

Qeveria është zotuar të përforcojë edhe më tutje të drejtat pronësore, sundimin e ligjit dhe qasjen e gjykatave me qëllim të promovimit të një mjedisi miqësor për bizneset. Reformat në sektorin gjyqësor, sidomos në lidhje me operimin e bizneseve, synojnë plotësimin e aktiviteteve ekzistuese në sferën e mjedisit biznesor. Garantimi dhe implementimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme është theksuar gjithashtu si pengesë e mundshme për aktivitetin e bizneseve në Kosovë, prandaj Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka vendosur një sistem të avancuar të menaxhimit të pronave, kadastrit, lejeve të ndërtimit dhe administratës gjyqësore. AKP-së do të t'i ipet mbështetje e mëtutjeshme për të themeluar një mekanizëm koordinues mes Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunave, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave pronësore. Përforcimi i kapaciteteve implementuese për ndarjen dhe administrimin e pronave, do të jetë hap i rëndësishëm për sigurimin e një mjedisi stabil biznesor.

f. Zhvillimi i sektorit financiar

Sektori i bankave komerciale përbëhet nga gjashtë banka me kapital të huaj dhe dy banka me pronësi vendore. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, pasuritë totale të bankave komerciale u rritën me 26.9%, në të cilën rritje ka ndikuar edhe inkuadrimi i TEB Bankës në kuadër të sektorit bankar të Kosovës. Kreditë gjithashtu janë rritur për 34.25% në krahasim me 2007. Kjo mund të shpjegohet me rritjen e depozitave amvisnore dhe korporatat publike jo-financiare, si dhe me rritjen e vazhdueshme te kërkesave për kredi. Kjo tregon që amvisnitë, si depozitues kryesor, po fitojnë më shumë besim në sektorin bankar, gjë që është hap i rëndësishëm në procesin zhvillimor të sistemit financiar në përgjithësi e atij bankar në veçanti. Sektori tregtar mbetet përfituesi më i madh i kredive të dhëna për ekonominë kosovare,sektor i cili në fund të vitit 2008 përbënte 56% të totalit të kredive dhëna. Megjithatë, një rritje e konsiderueshme vërehet edhe në sektorin bujqësor, edhe pse nga një bazë e ultë, i cili krahasuar me vitin 2007 evidenton një nivel rritjeje prej 29%. Trende të ngjashme mund të regjistrohen në kreditë e dhëna për industri dhe ndërtim, të cilat krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar një rritje prej 4.9% respektivisht 32%. Kjo tregon që tregtia vazhdon të dominojë ekonominë, derisa sektorët prodhues dhe bujqësorë tregojnë shenja përmirësimi, derisa aktiviteti ndërtimtar është në progres.

Sektori bankar edhe gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit 2008 ka vazhduar të ketë performansë të kënaqshme dhe të jetë financiarisht stabil. Edhe përkundër politikave të kujdesshme të kreditimit nga bankat, dhënja e kredive ka treguar një rritje të theksuar, të cilat kanë reflektuar në aktivitetin ekonomik të vendit. Profitabiliteti i sistemit bankar ka shënuar rritje më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar, që është reflektim ose i kthimeve më të ulëta të interesit ose i investimeve më të ulëta jashtë vendit. Edhe pse sistemi bankar vazhdon të jetë një prej sektorëve me përformansë më të mirë në ekonomi, bankat duhet të rrisin kapacitetet për të menaxhuar me sukses çdo efekt të mundshëm të krizës globale financiare dhe ekonomike.

Sistemi bankar në Kosovë mbikëqyret dhe rregullohet nga Banka Qendrore e Kosovës. Që nga themelimi i saj, sistemi bankar në Kosovë ka ndryshuar dukshëm në strukturën e tij. Derisa në vitin 2002 ky sistem është përbërë nga shtatë banka, ku prej tyre dy kanë qenë në pronësi të huaj, tash kjo strukturë përbëhet nga pesë banka në pronësi të huaj dhe dy banka vendore. Ky ndryshim ka ardhur pas tërheqjes së licencës së Bankës Kreditore të Prishtinës dhe licencimit të degës së një banke dhe një banke tjetër, respektivisht Bankës Tregtare Kombëtare dhe Turk Economi Bankasi.

Ndryshimi tjetër në strukturën e bankave ka ardhur nga bashkimi i bankave NLB-Kasabank dhe NLB-Banka e Re në një bankë të integruar NLB- Prishtina. Ekonomia e Kosovës është shumë specifike në sensin që përdorë euron si valutë zyrtare, që do të thotë se politikën fiskale e ka të vetmin instrument të politikave. Prandaj Mjetet e Huaja Neto (MHN) të sistemit bankar konsiderohen si element i

rëndësishëm për t'iu përgjigjur të papriturave potenciale që mund ta godasin ekonominë. Me fjalë të tjera, kur të hyrat financiare në Kosovë zvogëlohen, importet neto mund të financohen nga shfrytëzimi i MHN-ve, pa pasur ndonjë efekt të madh në likuiditetin e ekonomisë.

Figura 12. Mjetet e Huaja Neto të Korporatave Financiare (MHN), ***në miliardë euro***



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës
1/ Banka Qendrore e Kosovës (BQK); 2/ Korporatat tjera depozituese (KTD) përfshinë bankat komerciale

Gjithsej MHN-të e sistemit bankar janë rritur krahasuar me vitin e kaluar edhe pse jo në nivel të njëjtë. Më specifikisht, MHN-të janë rritur nga €1,377 milionë në €1,436 milionë. Kjo rritje e vogël është si rezultat e rritjes së ulët të depozitave të Qeverisë në BQK, që ka ardhur si pasojë e ndarjes së buxhetit më të lartë, së bashku me shkallën më të lartë të ekzekutimit të shpenzimeve publike. Me fjalë të tjera, depozitat në BQK janë rritur për €21.1 milionë, që arrin vlerën prej €870.5 milionë. Nga ana tjetër, MHN-të e bankave komerciale janë rritur për €6.2 milionë, të cilat kryesisht janë plasuar në bankat komerciale jashtë vendit. Deri në fund të vitit 2008, MHN-të e bankave komerciale kapën shumën prej €325.4 milionë.

Sistemi i përgjithshëm financiar në Kosovë ende dominohet nga sektori i bankave komerciale. Edhe pse kanë ndodhur disa ndryshime në strukturën e sektorit të bankave komerciale, janë shtatë banka që operojnë. Sido që të jetë, sa i përket rrjetit të operimit të bankave, ky sektor ka pasur një shtrirje të gjerë përmes hapjes së degëve dhe nëndegëve të reja. Kjo shtrirje erdhi kryesisht si rezultat i hyrjes së dy bankave të reja në treg, të cilat patën një ndikim të theksuar në rritjen e konkurrencës në mes të bankave si dhe i kanë kontribuar punësimit. Gjatë vitit 2008 u hapën 51 degë dhe nën-degë të reja në gjithë Kosovën, krahasuar me 16 gjatë vitit 2007. Ngjashëm numri i të punësuarve në sektorin bankar u rrit për 892 punëtorë me orar të plotë, krahasuar më 299 gjatë 2007.

Bazuar në raportet financiare të ofruara nga bankat komerciale, pozita financiare e sistemit bankar mbetet e shëndoshë dhe stabile. Gjatë 2008, asetet e bankave komerciale u rriten për 26.3% duke arritur në €1.8 miliardë. Kreditë e lëshuara u rritën për 32.7% krahasuar me fundin e vitit 2007, duke arritur vlerën prej pothuajse €1.2 miliardë. Nga ana tjetër, depozitat arritën në €1.4 miliardë, që korrespondon me rritje prej 26.1%. Si rezultat, raporti në mes të kredive dhe depozitave është ulë ndjeshëm në 82%, nga 85% sa ishte në qershor, kur arriti kulmin (maksimumin) e tij.

Struktura e bilancit të gjendjes së bankave komerciale ka pësuar një ndryshim të ndjeshëm gjatë periudhës nën vrojtim, duke kanalizuar investimet nga jashtë vendit në ekonominë vendore. Bankat ulën investimet e tyre në letra me vlerë në 2% të totalit të aseteve tyre nga 6 % sa i kishin në 2007, ndërsa në fund të 2008 rritën kreditimin nga 62% në 65% të totalit të aseteve. Prandaj kreditë mbetën kontribuesit kryesor të rritjes së aseteve totale, si dhe profitabilitetit të sektorit financiar. Ekonomitë familjare edhe më tej janë depozituesit më të mëdhenj në sektorin bankar, të cilët në fund të vitit 2008

përbënin rreth 60% të depozitave të përgjithshme. Depozitat e korporatave jofinanciare përbëjnë rreth 34% të totalit të depozitave, ku në kuadër të tyre depozitat e korporatave jo-financiare publike dhe private janë rritur me një mesatare prej 25% krahasuar me 2007.

Figura 13. Kreditë e dhëna dhe depozitët e pranuar – Ekonomitë familjare, ***në miliona euro***



Burimi: BQK

Depozitat e ekonomive familjare janë rritur për 23.4% krahasuar me 2007 duke arritur në €853.4 milionë. Nga ana tjetër, kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare janë rritur për 40.1%, duke arritur në 23.7% të totalit të kredive të lëshuara për ekonomi. Depozitat e korporatave të tjera jo-financiare u rritën për 28.3%, duke arritur në €227.4 milionë. Kreditë e lëshuara këtij sektori u rritën për 30.4%, duke arritur në €901.7 milionë deri në fund të 2008.

Figura 14. Struktura e kredive sipas industrisë, ***% e pjesëmarrjës në total***



Burimi: BQK

Tregtia vazhdon të jetë sektori kryesor i ekonomisë së Kosovës. Kjo shihet gjithashtu edhe në strukturën e kredive të lëshuara nga bankat komerciale. Kështu, 55.9% e kredive iu janë lëshuar sektorit të tregtisë, edhe pse si përqindje kjo ka rënë për 5% krahasuar me 2007. Brenda këtij sektori, pjesëmarrje më të madhe ka tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërsa sektori i hotelerisë dhe degët tjera kanë përfaqësim më të ulët.

Bujqësia ende përfaqëson rreth 4% të kredive të përgjithshme, edhe pse si vëllim kreditë e lëshuara për këtë sektor janë rritur për €8.5 milionë.

Edhe pse përfaqësojnë vetëm rreth 7% të kredive të përgjithshme, ndërtimtaria gjatë vitit 2008 ka kontribuar në zhvillimet në ekonomik. Kreditë e lejuara për këtë sektor janë rritur për 32.4% krahasuar me 2007. Rritje e kredive gjatë kësaj periudhe është vërejtur edhe në sektorin e industrisë dhe energjisë që përbëjnë rreth 17.8% të kredive të përgjithshme, ku industria përbën pjesën më të madhe me rreth 10.4% të totalit të kredive.

Gjatë periudhës së analizuar, kreditë afatgjata kanë shënuar një rritje të theksuar duke përbërë 68% të totalit të kredive. Nga ana tjetër, 84% e depozitave janë depozita afatshkurtra që do të thotë se depozitat afatgjatë mbulojnë rreth 9% të kredive afatgjata.

Figura 15. Llikuiditeti në sistemin bankar, ***në miliona euro***



Burimi: BQK

Edhe pse në aspekt të normave profitabiliteti i sektorit bankar është ulur, në aspekt të vlerës ka shënuar një rritje prej rreth €3 milionë gjatë 2008. Duke përdorur kthimin në asete (KNA) si indikator të matjes së profitabilitetit të sektorit bankar, ka rënë për 0.4 pika të përqindjes në 2.3%. Kthimi në ekuitete (KNE), gjithashtu, ka rënë nga 28.7% në 20.4%. Krahasuar me rajonin e Evropës Juglindore, me mesatare të KNA-së prej 2% dhe KNE-së prej 18%, profitabilitetit në sektorin bankar të Kosovës mbetet i lartë.

Figura 16. Indikatoret e profitabilitetit, ***në %***



Burimi: BQK

Koncentrimi në sektorin bankar të Kosovës i matur me Indeksin Herfindalh – Hirschman (HHI), u rrit ndjeshëm gjatë vitit 2008. Koncentrimi më i madh vazhdon të jetë në asetet e sektorit, ndërsa koncentrimi në depozita dhe kredi ka rënë, e cila mund të jetë si rezultat i hyrjes së bankave të reja në treg dhe konkurencës dhe produkte të reja.

Figura 17. Koncentrimi në sistemin bankar (HHI)



Burimi: BQK

2.2.2 KAPACITETI PËR T'U PËRBALLUR ME KONKURRENCEN DHE KUSHTET E TREGUT BRENDA UNIONIT

a. Kapitali njerëzor dhe fizik

Reforma e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë është një parakusht i rëndësishëm për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjate për zhvillim ekonomik të Kosovës. Qeveria është zotuar të implementojë politikat e përshtatshme për një rritje të sasisë dhe cilësisë së arsimit në gjitha nivelet. Adoptimi i programeve në arsimin para-universitar dhe profesional të bazuara në kërkesat e tregut është në vazhdim. Në këtë kuptim, Qeveria i kushton vëmendje të veçantë elaborimit dhe implementimit efektiv të Planeve të Veprimit për gjitha nivelet arsimore në Kosovë, duke përfshirë aftësimin profesional, përmirësimin e cilësisë mësimdhënëse si dhe sigurimi i pajisjeve adekuate për shkolla, me fokus të posaçëm në komunitetet RAE. Aktivitetet promovuese në drejtim të shtytjes së të rinjve për pjesëmarrje në programet e Komunitetit do të implementohen duke ofruar informata mbi programet gjegjëse të komunitetit.

Masat për zvogëlimin e papunësisë janë tejet të rëndësishme për Kosovën. Qeveria do të bëjë një analizë mbi tregun joformal të punës në Kosovë me qëllim të identifikimit të arsyeve kryesore dhe për të ofruar rekomandime dhe veprime që duhen ndërmarrë.Këtu do ti kushtohet vëmendje e veçantë masave që duhen ndërmarrë për lehtësimin e transferit nga punësimi i paregjistruar në atë të regjistruar. Krijimi i një tregu funksional të punës kërkon përfshirjen në proces të nivelit qeveritar qëndror dhe atij lokal. Qeveria është e përkushtuar të punojë në zbatimin e Projekt-Strategjisë së Punës dhe Planit të Veprimit për Punësimin e Rinisë. Hartimi dhe zbatimi i politikave aktive të tregut të punës, në bashkëpunim të afërt me komunitetin lokal të biznesit, me qëllim të avancimit të procesit në tregjet e punës, si dhe rritja e përqindjes së fuqisë së kualifikuar punëtore në fuqinë e përgjithshme të punës, janë në vazhdim e sipër.
Në këtë drejtim Qevereria e Kosovës parasheh edhe masa tjera si:

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimit të zyrtarëve të Sektorit të Dizajnimit të Politikave të Punësimit ka për synim përgatitjen e planeve dhe projekteve konkrete të punësimit;
- Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimit të zyrtarëve për sektorin e Statistikave Informuese dhe Analizave të Tregut të Punës;

- Hartimi i projekteve për përmirësimin e shkallës së punësimit të disa kategorive: rinia, grup-mosha 18-39 vjet, punëkërkimi për më shumë se 12 muaj, personat me aftësi të kufizuara.
- Hartimi i një strategjie afatmesme sektoriale për rikualifikimin e fuqisë punëtore.
- Ndërtimi i kapaciteteve përmes trajnimit dhe përmirësimit të kushteve të punës në Qendrat e Trajnimit Profesional si dhe
- Bashkëpunimi me trajnuesit e jashtëm me qëllim të rritjes së numrit të personelit të kualifikuar.

Duke pasur parasysh të dhënat e limituara mbi tregun e punës, analiza gjithëpërfshirëse e këtij sektori është sfiduese. Sido që të jetë me qëllim të prezantimit të një pasqyre solide të zhvillimeve në tregun e punës, për qëllim të këtij publikimi janë përdorur dy baza të ndryshme të të dhënave. Një burim i rëndësishëm i informatave për tregun e punës, janë ato që zakonisht mblidhen përmes zyrave të punësimit në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, duhet pasur parasysh që shifrat e prezantuara në këtë pjesë janë vetëm të dhëna administrative, apo të regjistruara. Të dhënat e regjistruara për punësimin nuk janë një tregues i saktë i punësimit të gjithmbarshëm në Kosovë, marrë parasysh që një pjesë e madhe e punësimit bëhet jashtë zyrave për punësim. Në anën tjetër, nuk është e pazakonshme që individët të regjistrohen si të papunë me qëllim të sigurimit të përfitimeve nga skemat sociale, edhe në rastet kur ata mund të jenë të punësuar në sektorin joformal. Ndërkaq si burim i dytë i informatave rreth punësimit janë të dhënat zyrtare mbi tatimpaguesit e regjistruar dhe pagat zyrtare të deklaruara. Sido që të jetë, vlen të theksohet se të dy këto burime të të dhënave nuk ofrojnë pasqyrë të gjithmbarshme të tregut të punës në Kosovë, megjithatë në këtë publikim do të përdoren si të dhëna komplementare me qëllim të prezantimit të një vështrimi mbi zhvillimet në tregun e punës.

Sipas të dhënave të regjistruara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, numri i përgjithshëm i punësimeve me ndërmjetësim në fund të dhjetorit 2008 ka arritur në 5,835, duke shënuar një rënie prej rreth 6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007. Një prej arsyeve të mundshme që shpjegon këtë trend negativ, mund të jetë numri i vogël i vendeve të reja të punës që janë ofruar gjatë kësaj periudhe nga njëra anë, si dhe niveli i lartë i hyrjeve/regjistrimeve të reja nga ana tjetër. Në këtë kontekst, numri i përgjithshëm i vendeve të punës të ofruara përmes zyrave të punësimit gjatë vitit 2008, ishte 6,937, ndërkaq numri i përgjithshëm i të regjistruarve të rinj si të papunë gjatë vitit 2008 ishte 21,979. Këto shifra flasin për një mospërputhje të madhe në mes të numrit të vendeve të ofruara të punës dhe numrit të papunësuarve të regjistruar gjatë kësaj periudhe.

Ndërkaq, vlen të theksohet se vetëm gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit (qershor- dhjetor) janë punësuar rreth 3,300 persona, e që, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit, ka shënuar një rritje prej rreth 30%. Kjo rritje mund të jetë si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend gjatë gjysmës së dytë të vitit. Në të vërtetë, një pjesë e kësaj rritje mund të jetë gjeneruar si rezultat i rritjes së punëve publike të nxitura nga rritja e madhe e shpenzimeve kapitale nga Buxheti i Kosovës. Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve kapitale gjatë vitit 2008, u orientuan në rregullimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e shkollave, me ç'rast është vërejtur një dinamizëm i madh i ndërmarrjeve ndërtimore në vend. Analizuar për nga aspekti i sektorëve, ngjashëm me periudhat tjera, numri më i lartë i punësimeve është regjistruar në sektorin e tregtisë. Punësimi në këtë sektor ka arritur rreth 26% të gjithsej punësimeve me ndërmjetësim. Kjo gjithashtu reflekton strukturën e ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë, ku shumica e tyre janë të përfshira në tregti dhe shërbime, ku pothuajse të gjitha nga ato janë të regjistruara si ndërmarrje mikro apo të vogla. Mirëpo, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar vërehet që ka pasur një ulje në përqindjen e punësimeve në shumicën e sektorëve, gjë që arsyeton një ulje në numrin e përgjithshëm të të punësuarve me ndërmjetësim gjatë kësaj periudhe.

Figura 18. Punësimi në sektorët e zgjedhur, ***të dhënat kumulative, fundi i periudhës***



Burimi: MPMS

Në kuadër të sektorëve të analizuar, sektorët e "Prodhimtarisë", "Ndërtimtarisë", "Tregtisë" dhe "Hotelet dhe Restoranet" gjatë vitit 2008 kanë punësuar numrin më të madh të punëkërkuesve me shkollë të mesme. Përderisa, në sektorin e "Arsimit" dhe "Financa", rreth 60% e të punësuarve, përmes zyrës për punësimi, i takojnë grupit të të papunëve të regjistruar me arsim të "lartë" dhe "universitar'. Ndërkaq, numri më i madh i të papunëve të regjistruar si të pakualifikuar, janë punësuar në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur një rritje e theksuar e të punësuarve në sektorin e bujqësisë, krahasuar me periudhën e njëjtë gjatë vitit të kaluar.

Ashtu siç raportohet, shkalla e punësimit është shumë më e lartë për personat me arsim më të lartë. Në mënyrë të vazhdueshme, niveli i arsimit është identifikuar të jetë ngushtë i lidhur me mundësitë më të mira për të gjetur punë. Për shembull, në fund të vitit 2008, shkalla vjetore kumulative e punësimit, e definuar si punësimet në raport me numrin aktual të të papunëve të regjistruar, për personat e pakualifikuar ka qenë 1.26%, ndërkaq për ata me diplomë universitare ka qenë 18.3%, dhe 2.65% për ata me shkollë të mesme. Prandaj personat me më shumë vite arsimi dhe trajnime profesionale janë në pozitë më të favorshme për të gjetur punë. Ashtu siç u cek edhe në hyrje, me qëllim të prezantimit të një pasqyre sa më gjithëpërfshirëse të zhvillimeve në tregun e punës, një burim tjetër i të dhënave që shfrytëzohet janë të dhënat nga Administrata Tatimore mbi numrin zyrtar të tatimpaguesve dhe pagat e deklaruara.

Sipas të dhënave nga administrata tatimore, gjatë vitit 2008, numri mesatar i të punësuarave të regjistruar ka qenë rreth 175,000 me pagë mesatare rreth €275. Pjesa dërmuese e tyre janë të punësuar në sektorin publik, rreth 75,000 prej tyre, me rrogë mesatare prej rreth €220. Sido që të jetë, vlen te ceket se numri i të punësuarve në sektorin publik ka qëndruar konstant gjatë viteve, pa ndryshime të theksuara. Duke pasur parasysh faturën e lartë për paga të shërbyesve civil, Qeveria e Kosovës është në proces të rishikimit të saj funksional, proces ky që parasheh reformën e administratës publike. Kjo reformë synon ristrukturimin e punësimit publik si dhe uljen e mundshme të punësimit në sektorin publik, me qëllim të krijimit të një administrate publike më efikase.

Shikuar nga aspekti sektorial, numri më i madh i të punësuarve janë në kuadër të sektorit të tregtisë. Analizuar edhe nga aspekti i numrit të punësuarave, por edhe nga niveli i pagës mesatare të deklaruar, ky sektor ka pasur trende përmirësimi. Ky sektor në vitin 2004 punësonte mesatarisht 19,000 punëtorë me një pagë mesatare prej rreth €180, ndërkaq gjatë vitit 2008 ky sektor arriti të punësonte mbi 24,000 persona, me një pagë mesatare mujore prej rreth €226.

Një sektor tjetër që cilësohet të jetë i suksesshëm është ai i bankave dhe financave. Numri i të punësuarve në banka dhe institucione tjera financiare gjithashtu është duke u rritur gradualisht. Ky

numër është rritur nga rreth 2,700 në vitin 2004, në mbi 4,500 gjatë vitit 2008, me një pagë mesatarë prej rreth €750. Megjithatë, vlen të ceket qe kjo pagë mesatare është paksa e rritur duke pasur parasysh efektin që kanë një numër i caktuar i pagave më të larta që i paguhen stafit menaxhues në këto institucione. Përndryshe paga mesatare në këtë sektor, duke përjashtuar rastet e pagave më të larta, mund të jetë rreth €400-500. Ky trend i rritjes së numrit të punësuarve në sektorin bankar dhe institucionet tjera financiare, gjithashtu mbështetet edhe nga fakti i rritjes së aktiviteteve të bankave, kompanive të sigurimit, si dhe institucioneve të tjera mikro-financiare.

Sektorët e tjerë që kanë shënuar rritje në numrin e të punësuarve janë sektori i industrisë përpunuese dhe ndërtimtarisë. Gjatë vitit 2008, mesatarisht rreth 18,000 persona kanë qenë të punësuar në industrinë përpunuese, me një pagë mesatare mujore rreth €220, ndërsa në sektorin e ndërtimtarisë kanë qenë të punësuar rreth 11,000 persona, me pagë mesatare mujore rreth €227. Një karakteristikë e rëndësishme qe vlen të potencohet është se që nga viti 2003 me rritjen e punësimit në sektorin privat është shënuar një rënie e vazhdueshme e punësimit në ndërmarrjet me pronësi shtetërore dhe publike. Nga mbi 14,000 të punësuar në ndërmarrjet me pronësi shoqërore në vitin 2004, numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit 2008 ishte rreth 5,000. Ndërsa në ndërmarrje me pronësi publike, ky numër ka rënë nga rreth 4,500 në vitin 2004, në rreth 460 gjatë vitit 2008.

Bazuar në të dhënat e regjistruara mbi numrin e të papunëve, numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të dhjetorit 2008 arriti në 335,942. Edhe pse papunësia ende mbetet një problem serioz ekonomik, ashtu siç tregohet edhe në grafikun 1.2 më poshtë, trendi rritjes të të papunëve të regjistruar, filluar që nga tremujori i fundit i vitit 2007 e këndej, ka qëndruar stabil pa rritje të theksuara.

Figura 19. Papunësia e regjistruar, ***kumulative, në mijëra persona***



Burimi: MPMS

Nga aspekti i nivelit arsimor, struktura e të papunëve të regjistruar është shumë e pafavorshme. Ngjashëm vitet paraprake,fuqia punëtore e pakualifikuar përbën numrin më të madh të

punëkërkuesve. Mbi 60% e të papunëve të regjistruar janë të pakualifikuar të pasuar nga ata me shkollim të mesëm. Megjithatë, ashtu siç vërehet nga shifrat, shkalla mesatare e daljeve për ata të papunë me shkollim universitar dhe shkolla të mesme është më e lartë, tregon se rreziku për të mbetur të papunë për ata me shkollim më të lartë është më i ulët.

Një çështje tjetër tejet brengosëse është kohëzgjatja e papunësisë. Mbi 90% e të papunëve të regjistruar janë të papunë afatgjatë, që mund të rezultojë në probleme serioze si për vetë të papunët, ashtu edhe për ekonominë në tërësi. Fenomeni i papunësisë afatgjate shpjegon faktin e pa ndryshueshmërisë së strukturës arsimore të të papunëve të regjistruar për një periudhë të gjatë kohore. Ky fakt është më se i rëndësishëm duke pasur parasysh se ri-punësimi i këtij grupi të punëkërkuesve është shumë i vështirë, në të njëjtën kohë, ritrajnimi i tyre është i kushtueshëm. Në këtë aspekt, është me rëndësi të ceket se një numër i konsiderueshëm i atyre të regjistruar si të papunë marrin asistencë sociale të paktën për një periudhë sa kanë qenë si të papunë, duke e kompensuar në këtë mënyrë një pjesë të të ardhurave potenciale të tyre që realisht i kanë humbur.

b. Struktura e sektorit dhe ndërmarrjeve

Përmirësimi i infrastrukturës themelore është thelbësor për promovimin e zhvillimit të biznesit. Zhvillimi i rrjeteve të transportit me vendet fqinje dhe sigurimi i furnizimit me energji do të përmirësojnë konkurrencën kosovare me tregjet rajonale dhe globale si dhe të bëhet më atraktive për zhvillimin ekonomik. Reformat e reja institucionale, gjegjësisht paraqitja e partneriteteve publiko-private në termocentralet e Kosovës janë të planifikuara për periudhën afatshkurtër dhe afatmesëm. Këto masa afatshkurtra do t'i sigurojnë Kosovës furnizim të mjaftueshëm me energji. Shpenzimet qeveritare të ofruara për këtë sektor në formë e subvencioneve, do të planifikohen për investime kapitale të ardhshme në drejtim të përmirësimi të infrastrukturës së energjisë. Në planin afat-gjatë, bazuar në politikat e hartuara në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Agjencinë Evropiane për Rindërtim dhe USAID-in, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për investime të mëtutjeshme në sektorin e energjisë (ndërtimin e termocentralit të ri – Kosova C) si dhe shfrytëzimin e resurseve energjetike ripërtritëse .

Mungesa e investimeve kapitale në projekte të infrastrukturës kanë qenë mangësi e Kosovës në kuptimin e sigurimit të një mjedisi konkurrent të biznesit.Në këtë drejtim, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ka paraqitur planet për disa investime kapitale në infrastrukturën rrugore. Dy magjistralet kryesore, Prishtinë-Shkup dhe Merdarë-Vermicë janë tenderuar apo janë në fazën përfundimtare të përgatitjeve për tenderim. Këto projekte të rëndësishme si dhe investimet në infrastrukturën rajonale dhe lokale synojnë të përmirësojnë rrjetet e transportit me vendet fqinje. Kjo do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në tërheqjen e investime të huaja direkte, si dhe avancimin e tregtisë brenda rajonit.

Privatizimi i ekonomisë së Kosovës është bërë nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM),tani Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) . Kjo Agjenci ka qenë në krye të menaxhimit të ndërmarrjeve publike dhe ristrukturimit të tyre qysh prej themelimit të saj në bazë të Rregullores së UNMIK-ut të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Deri në fund të shkurtit 2008, shumica e ndërmarrjeve shoqërore janë privatizuar. Numri i përgjithshëm i kontratave të nënshkruara dhe atyre që presin nënshkrimin është 450, ndërsa fondet e përgjithshme të privatizimit të pranuara dhe të siguruara janë 378,124,228 €. Sipas rregullores së punës, 20 % e shumës totale i është ndarë për mbulimin e detyrimeve ndaj ish-punëtorëve.

Për të avancuar me procesin e privatizimit do të elaborohet një Plan Veprimi në bazë të vlerësimit dhe analizimit të planit ekzistues të biznesit të Fondit të Mirëbesimit. Shqyrtimi i planit ekzistues të privatizimit të Ndërmarrjeve Publike (NP) synon të adresojë nevojat për efikasitet dhe efektivitet të

ndërmarrjeve publike. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), Kompleksi i Trepçës, do t'i nënshtrohen studimeve të fizibilitetit për privatizim me synim të promovimit të PPP-ve dhe elaborimit të ristrukturimit strategjik. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) po kalon një fazë transformimi, ku një pjesë e kompetencave, sidomos ato në lidhje me Ndërmarrjet Publike (NP) do t'i transferohen institucioneve të Kosovës, derisa Ndërmarrjet e mbetura Shoqërore (NSh) do të administrohen nga një organ i veçantë nën mbikëqyrjen e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Procesi i likuidimit të NSh-ve do të vazhdojë sipas parashikimit të ish Planit të Veprimit të AKM-së, edhe pse faza e transformimit pritet të krijojë një vakum të përkohshëm operativ.

Përkundër aktiviteteve të ristrukturimit dhe privatizimit, si dhe përkundër faktit që ekonomia është kryesisht pronë private dhe tregjet janë përgjithësisht të liberalizuara, ekonomia ende përballet me sfida të shumta që dalin nga jostabiliteti politik rajonal si dhe mangësitë në nivel vendi.Në këto mangësi mund të përfshihen sektori i dobët gjyqësor, dështimi në tërheqjen e investitorëve strategjikë për privatizimin e ndërmarrjeve publike si dhe dështimi i pronarëve të ndërmarrjeve të privatizuara që të bëjnë reforma dhe inovacione. Të gjithë këta faktorë kanë zhvlerësuar përpjekjet e Qeverisë dhe kanë penguar arritjen e shkallëve më të larta të rritjes ekonomike dhe rritjen e punësimit . Kjo kërkon reforma më mirë të hartuara dhe përmirësime të mëtutjeshme të mjedisit afarist. Kjo është arsyeja pse Qeveria është duke vazhduar me përkushtimin e saj ndaj reformave strukturale të cilat janë hartuar në detaje në disa projekte shtesë.

Për shkak të zhvillimeve të reja politike, Qeveria në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare në Kosovë ka iniciuar dy ndryshime të rëndësishme ligjore e institucionale, i) Ligji mbi trashëgimtarin e AKM-së dhe ii) Ligji mbi ndërmarrjet publike.

Në afat të mesëm, Qeveria do të kërkojë të përmirësojë menaxhimin dhe qëndrueshmërinë financiare të NP-ve. Do të merren masa që do të përmirësojnë shkallën e inkasimit të faturave të ndërmarrjeve publike, përmes rishikimit të planeve të biznesit dhe elaborimit të planeve të veprimit për arritjen e synimeve vjetore për inkasimin e faturave. Gjithashtu, pritet të ndërmerret një fushatë e gjerë e vetëdijesimit publik. Shthurja funksionale dhe ristrukturimi në NP në pajtim me Udhëzimet e OECD-së për Menaxhimin e Korporatave do të adresojë parametrat e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë. Asistenca teknike e huaj parashikohet për mbështetje dhe përforcim të qeverisjes së ndërmarrjeve publike. Mbështetja e NP-ve përmes kredive të jashtme bankare do të sigurojë fonde për zhvillimin e shpejtuar të NP-ve.

Qeveria po bën përgatitjet e duhura për diskutim mbi Raportin e Misionit Vlerësues të KE-së për Rregullatorët në Kosovë, me synim të ndërmarrjes së masave të domosdoshme për të siguruar pavarësinë operative dhe financiare të rregullatorëve. Korniza ligjore për funksionimin e rregullatorëve do të avancojë pavarësinë funksionale dhe financiare deri në kufijtë ku transparenca dhe përgjegjshmëria të mos rrezikohen. Përparimet kanë qenë të dukshme në këtë fushë,por themelimi i Autoriteteve Rregullative për Hekurudhat e Kosovës, Autoritetin e Aviacionit Civil dhe ndërtimi i kapaciteteve për personelin e Rregullatorëve përmes trajnimeve dhe rritjen graduale të pagave janë të parashikuara në për periudhën e ardhshme afatmesme.Për të siguruar qeverisjen efikase dhe efektive është e nevojshme një analizë e kolizioneve të ndryshme mes Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë dhe pavarësinë operative të rregullatorëve .

c. Ndikimi i Qeverisë mbi konkurrencën

Mjedisi i parashikueshëm dhe stabil biznesor do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e prodhimtarisë dhe përmirësimin e kushteve të tregut të punës. Kështu, qeveria do të shqyrtojë legjislacionin tatimor, sidomos akcizën dhe tatimet doganore, me synim të krijimit të kushteve më të mira për IHD-të. Reformat strukturore do të zbatohen për të përmirësuar mjedisin e biznesor dhe për të

zhvilluar konkurrencën e ndërmarrjeve, duke ruajtur stabilitetin makroekonomik. Në këtë drejtim, do të themelohet një strukturë e re e mbikëqyrjes së tregut. Në pajtim me strategjinë afatmesme, masa të reja do të ndërmerren për përforcimin dhe fuqizimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale.Qeveria është gjithashtu e përkushtuar të vazhdojë implementimin e Strategjisë Afatmesme për Krijimin e Sistemit të Mbrojtjes së Pronës Industriale. Në këtë drejtim pritet organizimi i fushatave të vetëdijesimit publik mbi të drejtat pronësore industriale.

Kosova është duke punuar në një mënyrë shumë aktive dhe do të vazhdojë implementimin e masave për inkurajimin e zhvillimit të bizneseve. Themelimi i një Agjencie për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) është një hap i rëndësishëm. Ndërtimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve për personelin dhe trajnimet e ofruara për ndërmarrjet janë të parashikuara (inkubatorët e biznesit). Masa të tjera institucionale do të merren për të siguruar një nivel të kënaqshëm të implementimit të Kartës Evropiane për NVM-të. Strategjia e re për Zhvillimin e NVM-ve do të iniciohet, për t'iu referuar dhe për të plotësuar Strategjinë Zhvillimore të Kosovës (SZhK). Përveç këtyre, implementimi i një strategjie afatmesme për mbështetjen e NVM-ve, duke përfshirë përforcimin e Agjencisë së mbështetjes së NVM-ve si Agjencisë për promovimin e investimeve, do të përmirësojë tutje mjedisin ku funksionojnë NVM-të. Në pajtim me rregullat e Buxhetit të Kosovës dhe strukturës organizative të Agjencisë,pritet një rritje graduale e personelit të Agjencisë për Promovimin e Investimeve, Për më shumë, Ministria e Tregtisë do të përmirësojë qasjen elektronike duke implementuar Projektin e "Teknologjisë Informative të Ndërmarrjeve".

d. Integrimi ekonomik me BE-në

Statistikat për sektorin e jashtëm tregojnë për një zvogëlim minimal në trendin e rritjes së eksporteve, ndërkaq importet kanë vazhduar të rriten me trend të ngjashëm. Deficiti tregtar ka vazhduar gjithashtu trendin rritjes.

Megjithëse paraprakisht trendi i rritjes së eksporteve ka qenë i lartë në gjysmën e parë të vitit, ky trend ka pësuar ngadalësim të ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit. Në fakt, eksportet në gjysmën e dytë të vitit janë rritur për €92.8 milionë, një rritje kjo prej vetëm 2.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërkaq, importet kanë arritur vlerën prej €1.07 miliardë, një rritje kjo prej 22.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Deficiti tregtar ka qenë €980.3 mil, apo 24.5% më i lartë se vitin e shkuar.

Zvogëlimi i konsiderueshëm i trendit të rritjes së eksporteve ka ndikuar që të ketë përkeqësim në shkallën e mbulimit të importeve nga eksportet. Ky mbulim ka rënë në 8.7% për gjysmën e dytë të vitit 2008, krahasuar me 10.3% për gjysmën e dytë të vitit 2007. Figura më poshtë pasqyron rrjedhat e tregtisë gjatë viteve.

Figura 20. Bilanci tregtar, *kumulativ, në miliona euro*



Burimi: ESK

Për dallim nga gjysma e parë e vitit 2008, ku rritja e eksporteve në aspekt të përqindjes ka qenë shumë më e shpejtë se rritja e importeve (marrë parasysh bazën e ulët të eksporteve), në gjysmën e dytë të vitit 2008 rritja e eksporteve për nga përqindja është ulur dukshëm në krahasim me rritjen e importeve. Si rezultat, edhe në terme absolute rritja e importeve ka qenë shumë më e lartë dhe ka kontribuar në thellimin e deficitit tregtar. Ulja e ndjeshme e normës së rritjes së eksporteve në gjysmën e dytë të vitit 2008 mendohet të jetë ndikuar nga rënia e kërkesës globale dhe uljes së përgjithshme të çmimeve në dy kuartalet e fundit të vitit 2008, përderisa rritja e importeve ka qenë gjithashtu rezultat i rritjes së brendshme ekonomike që ka shkaktuar kërkesë për importe nga jashtë.

Deficiti tregtar financohet përmes konsumit të sektorit të donatorëve, përmes pagave të stafit vendor të punësuar nga ndërkombëtarët, si dhe nga remitencat që vijnë nga jashtë. Përkundër faktit që deficiti tregtar është edhe deficit financiar, deficiti në shkallë prej mbi 20% të llogarisë rrjedhëse, paraqet një shqetësim për stabilitetin makroekonomik. Kjo e bën ekonominë tonë më të ndjeshme nga tronditjet e jashtme.

Në plan afatgjatë, deficiti tregtar mund të zvogëlohet përmes tkurrjes së pranisë së donatorëve, që do të rezultonte në një rënie të kërkesës agregate, mbase edhe të importeve. Por, për të ruajtur trendin e rritjes së eksporteve, Kosova duhet të mbetet konkurruese në rajon. Për këto arsye, ekonomia e Kosovës duhet të përpiqet të ruajë një shkallë më të ulët të inflacionit karshi fqinjëve të saj. Kjo është paksa e vështirë marrë parasysh që pjesa më e madhe e inflacionit në Kosovë është si rezultat i rritjes së çmimit të importeve, veçmas naftës dhe ushqimit. Prandaj, ajo që i mbetet Kosovës është të qëndrojë konkurruese me anë të rritjes së produktivitetit. Si një politikë e mundshme është ndërmarrja e investimeve publike në infrastrukturë, si kusht i domosdoshëm për uljen e kostos së brendshme, që i bën eksportet tona të jenë më të lira.

Me gjithë ngadalësimin e dukshëm në rritjen e trendit të eksporteve, "Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë" kanë përbërë rreth 61.2 % të të gjitha eksporteve në gjysmën e dytë të vitit 2008. Kjo është një rritje prej 32.1 pikash të përqindjes krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, apo një rritje prej €13.7 milionë në terme absolute. Në përgjithësi, përveç kategorisë së "Ushqimit", e cila ka shënuar një rritje prej €2.7 milionë (ose 27.8%), kategoritë e tjera kanë shënuar rënie në gjysmën e dytë të vitit 2008 krahasuar me periudhën e njejtë të vitit të kaluar. "Produktet minerare" kanë shënuar një rënie të vogël prej €0.2 milionë; "Plastika dhe druri" janë zvogëluar për €0.8 milionë; dhe "Lëkura dhe artikujt e lëkurës" janë zvogëluar me €1.2 milionë, një rënie kjo prej rreth 50% krahasuar me periudhen e njejtë të vitit të kaluar.

Eksportet e tjera që hyjnë në kategorinë e përgjithshme "Të tjera" kanë shënuar një rënie drastike prej €21.7 milionë në gjysmën e dytë të vitit 2007 në €9.6 milionë në gjysmën e dytë të vitit 2008, apo një rënie prej mbi 55%. Figura më poshtë tregon strukturën e eksporteve.

Figura 21. Eksporti sipas grupeve të produkteve, ***% e pjesëmarrjes në total***



Burimi: ESK

Eksportet drejt vendeve të BE-së janë zvogëluar në gjysmën e dytë të vitit 2008. Eksportet janë zvogëluar nga €43.7 milionë në gjysmën e dytë të vitit 2007, në €40 milionë për periudhën e njëjtë në vitin 2008, apo një ulje prej 8.6%.

Eksportet drejt BE-së kanë qenë 43% e totalit, një rënie kjo prej €3.7 milionë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritje e konsiderueshme e eksporteve për nga destinacioni është shënuar me Italinë. Eksportet drejt Italisë janë rritur nga €4.1 milionë në gjysmën e dytë të vitit 2007, në €16.4 milionë. Eksportet drejt Gjermanisë kanë shënuar rënie drastike prej €13.2 milionë në gjysmën e dytë të 2007, në vetëm €2.9 milionë në periudhën e njejtë të vitit 2008, një rënie kjo prej 78%. Eksportet drej Greqisë kanë rënë €1.8 milionë dhe €0.6 milionë drejt Sllovenisë.

Eksportet drejt vendeve të CEFTA-s tani përbëjnë rreth 32.5% të eksporteve totale, një rënie kjo prej €1.8 milionë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të shkuar. Brenda vendeve të CEFTA-s, eksportet drejt Shqipërisë kanë shënuar rritjen më të madhe, që kanë qenë për €2.6 milionë më të larta se sa në periudhën e njëjtë të vitit të shkuar, ndërsa rënia më e madhe ka qenë për eksportet drejt Serbisë, që kanë qenë për €5.7 milionë më të ulëta. Eksportet drejt Bosnjës e Hercegovinës kanë përsuar rënie, ato drejt Malit të Zi kanë shënuar një rritje të vogël, ndërsa eksportet drejt Kroacisë, edhe pse edhe më tej mbesin të papërfillshme, megjithatë kanë shënuar rënie në krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Grafiku më poshtë tregon eksportet sipas vendeve.

Figura 22. Eksportet në vendet e selektuara, ***% e pjesëmarrjes në total***



Burimi: ESK

Nëse shikohet struktura e importeve, mund të shihet që në terme absolute, është shënuar rritje në të gjitha kategoritë e importeve.

Kategoria "Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë" është rritur për €23 milionë dhe ka shënuar një rritje të vogël si pjesë e importeve totale.

"Produktet Minerare" kanë treguar një rritje prej €5.6 milionë, por kanë rënë si pjesëmarrje në totalin e importeve. Kjo ka ndodhur në rrethanat kur eksportet e këtyre mallrave kanë rënë në terme absolute.

Importet e "Makinerisë dhe pajisjeve mekanike dhe pajisjeve elektrike" janë rritur për €14.5 milionë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të shkuar. Ky është një tregues që ka pasur rritje të investimeve në terme nominale, ndonëse marrë parasysh që pjesëmarrja e këtyre produkteve nuk është rritur në masë të konsiderueshme, është një shenjë që nuk ka pasur zhvendosje të konsiderueshme nga importet për konsum në importet për investime.

"Artikujt ushqimor të përgatitur, pijet, duhani" janë rritur më së shumti në terme absolute, prej €126.5 milionë në gjysmën e parë të vitit 2007, në €153.6 milionë në periudhën e njejtë të vitit 2008, ose një rritje prej mbi €27 milionë.

"Veturat dhe pajisjet transportuese" kanë shënuar rritjen tjetër më të lartë në terme absolute, dhe tani përbëjnë rreth 7% të të gjitha importeve të mallrave.

"Produktet e industrisë kimike" janë rritur për €12.4 milionë, "Produktet bimore" për €6.5 milionë, ndërsa kategoria e importeve "Të tjera" është rritur për €71.6 milionë.

Figura 23. Importi sipas grupeve të produkteve, ***% e pjesëmarrjes në total***



Burimi: ESK

Nëse shikojmë origjinën e importeve, nuk ka dallime të mëdha nga ajo që është regjistruar më herët.

Importet nga BE përbëjnë 36.5% të importeve totale për gjysmën e dytë të vitit 2008, që është për ¾-tat e përqindjes më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të shkuar. Rritja më e madhe e importeve nga vendet e BE-së lidhet me Gjermaninë, prej nga importet janë rritur për €31.6 milionë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të shkuar. Gjithashtu, një rritje e konsiderueshme është shënuar me Greqinë, ku importet janë rritur për €14.5 milionë krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa ato me Bullgarinë janë rritur për rreth €10.9 milionë, e me Italinë për €9.7 milionë.

Importet nga vendet e CEFTA-s kanë shënuar gjithashtu rritje të konsiderueshme, dhe kanë arritur vlerën prej €396 milionë deri në fund të dhjetorit 2008, që është €69.6 milionë më tepër krahasur me periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Por, të shprehura si pjesëmarrje në importet totale, importet nga vendet e CEFTA-s kanë mbetur në 37% të totalit. Brenda CEFTA-s, ka pasur rënie të importeve nga Serbia për €1.4 milionë krahasuar me periudhën e njejtë të vitit të kaluar, ndërsa ato nga Mali i Zi kanë rënë për rreth €1 milionë.

Një rritje e konsiderueshme e importeve ka qenë nga Maqedonia, ku importet janë rritur për €46.5 milionë dhe kanë arritur vlerën €180.3 milionë. Një pjesë e kësaj rritjeje mund të jetë trend natyror, por një pjesë mund të shpjegohet si zhvendosje e tregtisë nga produktet e Serbisë drejt atyre të Maqedonisë. Me këto zhvillime të reja, Maqedonia është qartazi burimi më i rëndësishëm i importeve, me 16.8% të totalit.

Importet nga Shqipëria janë rritur konsiderueshëm për €14.7 milionë krahasuar me periudhën e njejtë të vitit të kaluar dhe kanë arritur vlerën në €33.6 milionë në gjysmën e dytë të 2008.

Importet nga vendet tjera të CEFTA-s siç janë Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina janë rritur për €6.2 milionë, përkatësisht €4.7 milionë.

Ajo që rezulton nga kjo, si për eksportet ashtu edhe për importet nga CEFTA, është që me përjashtim të tregtisë në dy drejtime me Serbinë, që ka shënuar rënie në këtë gjysmë vit, rezultatet e tregtisë me të shumicën e vendeve të CEFTA-s tregojnë rezultate pozitive.

Për një figurë përmbledhëse që tregon importet sipas vendeve, shih më poshtë.

Figura 24. Importi nga vendet e selektuara, ***% e pjesëmarrjes në total***



Burimi: ESK

Kosova ka prioritizuar kontributin e saj në implementimin e CEFTA-s, duke qenë mes vendeve të para për të përmbyllur procedurat dhe obligimin e marrë përsipër me nënshkrimin e marrëveshjes. Tregtia me anëtarët e CEFTA-s përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimit tregtar të Kosovës, 38.6%. Kjo tregon që ekonomia e Kosovës është mirë e integruar në ekonominë rajonale. Eksportet në vendet e CEFTA-s është rritur me 34.3% në krahasim me 2006-ën. Shuma e eksporteve ka arritur 47.6 milionë Euro ose rreth 49% të eksporteve totale. Importet nga vendet e CEFTA-s kanë arritur 569 milionë euro me një rritje vjetore prej 7.4%, që përbën rreth 38% të totalit të importeve. Struktura e eksporteve të Kosovës tregon një përmirësim të vogël të sektorit industrial dhe ushqimor. Një analizë e trendëve të importit tregon që rritja e vitit 2007 ka ardhur kryesisht për shkak të produkteve të përdorura për investime kapitale, pajisje e makineri dhe materiale ndërtimore.

2.3 STANDARDET EVROPIANE

2.3.1 TREGU I BRENDSHËM

a. Lëvizja e lirë e mallrave

Vizioni i Qeverisë në fushën e lëvizjës së lirë të mallrave është krijimi i kushteve sistemore për tregti, industri, krijimi i politikave të punës dhe zbatimi i legjislacionit për përkrahjen e konkurrencës korrekte, hartimin e programeve dhe legjislacionit për përkrahjen e ndërmarrjeve industriale, tregtare, turistike dhe politikave zhvillimore të sektorit privat, mbështetjen e investimeve në Kosovë duke siguruar informacione dhe ndihmë në sigurimin e dokumenteve (leje, autorizime) te nevojshme për investime për investitorët vendas dhe te huaj dhe publikimin e te dhënave te investimeve te huaja ne Kosove, shenjën e rekomandimeve për çështje të privatizimit, administrimin e regjistrit te regjistrimit të bizneseve.

Kosova është në procesin e hapjes së dosjes së plotë të tregut të brendshëm, si dhe do të sigurojë që secili akt relevant i BE-së do të transpozohet në mënyrë korrekte në kornizën ligjore të Kosovës, duke themeluar strukturën e fuqishme e të aftë të implementojë atë legjislacion, në pajtim me praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE-së. Kosova është në procesin e themelimit të kornizës ligjore horizontale mbi lëvizjen e lirë të mallrave. Ligji mbi Metrologjinë, si dhe Ligji mbi Inspektoratin e Tregut janë hartuar në frymën e legjislacionit evropian. Gjithashtu, një pjesë e standardeve evropiane tanimë është transpozuar, bashkë me transpozimin e disa Direktivave të Qasjes së Re: Direktiva 98/37/EC mbi Makinat që është transpozuar përmes UA Nr. 2007/16 mbi Rregullat Teknike për Makineri dhe elementet e tyre të sigurisë; Direktiva 73/23/EEC mbi Pajisjet elektrike me presion të ultë, e transpozuar si UA Nr. 2005/28 për Rregullat Teknike për Pajisjet Elektrike të dizajnuara për përdorim në disa presione.

Metrologjia - metrologjia në Kosovë rregullon vendosjen dhe sigurimin e matjeve të sakta dhe të besueshme në Kosovë, me qëllim të mbrojtjes se jetës, shëndetit të popullatës, kafshëve, mjedisit, konsumatorëve dhe resurseve natyrore si dhe mbështetja e cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve vendore.

Akreditimi – akreditimi u ofron të gjitha palëve të interesuara akreditimin mbi bazën e rregullave të përcaktuara në ligje dhe standarde. Ligji për akreditimin është miratuar nga Kuvendi më 13 Dhjetor 2008 me qellim të rregullimit, themelimit dhe funksionimit të organit i cili kryen punët e shërbimit te Akreditimit në Kosovë, ligji gjithashtu përcakton fushat ku kryhet akreditimi dhe roli i akreditimit në procedurat e vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregulloret teknike në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian.

Standardizimi – me anë të fushës së standardizimit Qeveria ka për qëllim: të kontribuoj në bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesit dhe veprimit me koncnesus në hartimin, adoptimin dhe adaptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare; të plotësoj kërkesat e anëtarësimit në ISO/IEC dhe CEN/CENELEC; të avancoj standardizimin kosovar në nivelin e organizmave homolog regjional dhe evropian.

Korniza Ligjore
Sa i përket fushës së lëvizjes së lirë të mallrave në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative.
Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- Ligji për Akreditim, Nr.03/L-069;
- Ligji për Metrologji;

- Ligji për Njësitë Matëse;
- Ligji për Punimet prej Metaleve të Çmueshme
- Ligji i produkteve ndertimore Nr. 02/L-14
- Ligji për Inspektoratin e produkteve të ndërtimit Nr. 02/L-62
- Ligji i standardizimit 2004/12;
- Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve Nr. 2004/17,
- Ligji për tregtinë e brendshme Nr. 2004/18,
- Ligji për tregti të jashtme 2003/15,
- Ligji për tregti me naftë dhe derivate të naftës 2004/5.

Me qëllim të zbatimit të kornizës ligjore të lartëpërmendur, në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, Qeveria ka vendosur një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, e cila përbëhët nga **27 *Udhëzime Administrative.***

Korniza Institucionale
Organ qendror në Kosovë në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ministria është e organizuar në Departamentet, Zyrat dhe Agjencitë Ekzekutive.

Departamenti i Akreditimit (DA) - është organi i vetëm kombëtar i akreditimit për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të tillë si: testim, kalibrim, certifikim, dhe inspektim qofshin në sektorët publik apo privat, të fushës vullnetare apo të detyrueshme. DA u themelua ne bazë të Ligjit Nr.03/L-069 për akreditim.

DA operon në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011 "Kërkesa të përgjithshme për organizmat e akreditimit, të cilat kryejnë akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit". Gjithashtu, DA ka për detyrë dhënien e këshillave në administratën shtetërore për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike si dhe mbajtjen, azhornimin dhe dhënien e informacionit për statusin e akreditimit të organizmave të akredituar.

Departamenti i Metrologjisë së Kosovës (DMK) - është i organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit për metrologji nr. 02/L-34, ndërsa aktivitetin e vet e zhvillon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. DMK është Institucioni i vetëm nacional në Kosovë i cili është përgjegjës për vendosjen dhe udhëheqjen e sistemit të metrologjisë në Kosovë, përfshirë edhe metalet e çmuara.

DMK përfaqëson një nga shtyllat kryesore të infrastrukturës teknike të cilësisë në Kosovë, andaj së bashku edhe me shtyllat tjera të kësaj infrastrukture si standardizimi, akreditimi, etj., krijon një bazë të fortë për zhvillim të qëndrueshëm shkencor, teknologjik dhe ekonomik, si dhe mbështet përfshirjen e barabartë të Kosovës në integrime Evropiane dhe ndërkombëtare. Po ashtu, DMK në mënyrë permanente rishikon rregullativen ligjore ekzistuese dhe harton rregullativë të re me qëllim të harmonizimit te legjislacionit me atë të BE-së.

Me qëllim të realizimit të objektivave të saj, DMK punon në zhvillimin e tri funksioneve të përgjithshme të metrologjisë në Kosovë :
- metrologjisë shkencore,
- metrologjisë industriale ,

- metrologjisë ligjore.

Departamenti i Tregtisë (DT) - në kuadër të kompetencave të veta ushtron, përcjell, sugjeron dhe analizon: zbatimin e masave për mbrojtjen e konsumatorit; lëvizjen e lirë të mallrave në tregun vendor; rijimi i kornizës ligjore të përshtatshme dhe të përafruar me Organizatën Botërore te Tregtisë(OBT); angazhimi permanent për inkuadrim të Kosovës në organizatat dhe iniciativat ndërkombëtare, (OBT, UNCTAD, UNECE, ITC); angazhim konkret për të ndihmuar prodhuesit vendor në promovimin e prodhimeve të veta në tregun e jashtëm; propozon përafrimin e infrastrukturës ligjore vendore për tregti me atë të BE-së; përgatitë materialet dhe merr pjesë në negocimet për lidhje të Marrëveshjeve për Tregti të Lirë (MTL); ushtron funksionin rreth licencimit të importit dhe eksportit nga fushë veprimtaria e vetë; krijon lidhje me institucione financiare ndërkombëtare; ndërmerr masa për stimulim dhe nxitje të eksportit, etj.

Departamenti i Turizmit – fokusohet në aktivitetet si në vijim:

- Përgatitja dhe zbatimi i infrastrukturës ligjore, institucionale dhe kushteve të tjera për afarizëm normal të ekonomisë turistike;
- Hartimi i politikave turistike vendore dhe harmonizimi i tyre me ato të BE-së;
- Hartimi dhe implementimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit;
- Nxitja e rregullimit urbanistik të mjedisit që ka rëndësi për zhvillimin e turizmit;
- Promovimi i Kosovës si pikë e destinuar turistike;
- Përcjellja e ritmeve zhvillimore turistike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Krijimi i kushteve për bashkëpunim me asociacionet ndërkombëtare turistike;
- Krijimi i politikave për lehtësim dhe krijim të klimës së favorshme për investimet në turizëm dhe hoteleri;
- Përgatitja e formave për aplikim për licenca të subjekteve hoteliere, agjencive turistike, të udhëtimit, etj.;
- Organizimi i panaireve, konferencave dhe punëtorive nga sfera e turizmit dhe hotelerisë;
- Pranimi, shqyrtimi dhe procedimi i dokumentacionit për licenca për subjektet hoteliere dhe turistike.

Departamenti i Ndërtimtarisë (DN) - në veprimtarin e vet përfshinë politika, strategji dhe kuadër rregullator instucionale të paraqitur në program pune:

- Zhvillimi i industrisë ndërtimore;
- Përmbushja e Legjislacionit për Ndërtimtari-Hartimi dhe implementimi dhe monitorimi I zbatimit te akteve ligjore dhe nënligjore me karakter teknik, në përputhje me kërkesat e dala nga Direktiva evropiane për produktet e ndërtimit 89/106/EEC në Industrinë ndërtimore,
- Konformiteti-certifikimi i produkteve ndërtimore -Përgatitja dhe vendosja e sistemit të procedurave të përputhshmërisë për produktet ndërtimore;
- Vendosja e kontakteve me prodhuesit, importuesit dhe distributorët dhe organizimi i konferenca me qëllim të njohjes së tyre me politikat institucionale ne raport me prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e produkteve ndërtimore
- Licencimi i ndërmarrjeve ndërtimore, me qellim të futjes së tyre në kuadër të përgjegjësive ligjore e teknike në ndërtimtari,
- Promovimi i resurseve minerare, për përdorim në industrinë ndërtimore.
- Themelimi i Institutit të Ndërtimtarisë, me qellim të vendosjes së kontrollit mbi produktet ndërtimore duke i nënshtruar ekspertizës dhe hulumtimit
- Trajnimi i stafit në institute dhe institucione të shteteve te zhvilluara me qëllim të ngritjes se kapaciteteve kreative dhe implementuese, përcjellja e punës, realizimi i kontakteve dhe bashkëpunimi më organizata ndërkombëtare, agjenci të specializuara si dhe organizata të tjera, më qëllim të këmbimit të përvojave lidhur më zhvillimin e industrisë ndërtimore

Agjencia e Standardizimit - është organi i vetëm kosovar përgjegjës për hartimin, miratimin, përshtatjen dhe njohjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde kosovare (SK). Agjencia u themelua më 25 prill 2005, mbështetur në Ligjin për standardizim 2004/12 dhe UA 2005/15. Objektivat e agjencisë ne fjalë janë që përmes standardeve të miratuara të stimuloj fuqishëm zhvillimin ekonomik dhe konkurrencën në rajon dhe më gjer. Njohja dhe adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në Kosovë është imediate për transpozim dhe implementim të direktivave evropiane, për rregullore teknike, si dhe për nevoja të biznesit kosovar. Në kuadër të ASK-së funksionojnë dy njësi: Njësia e standardizimit dhe Njësia e Akredimimit.

Prioritetet Afatshkurtëra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, mes tjerash, MTI-ja do të fokusohet në: ngritjen e sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas standardit ISO/IEC 17011; rritjen e numrit të vlerësueseve dhe kryevlerësuesëve, akreditimin e të gjitha laboratorëve të cilët plotësojnë kriteret dhe kërkesat e standardeve gjegjëse si dhe aplikimi për anëtarësim në EA (Evropean Corporation for Accreditation); nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet e rajonit dhe Turqinë, pregaditjen e raportit për shkëmbimet tregtare 2008; pregaditjen e raportit për lëvizjen e çmimeve 2007-2008; implementimin e Marrëveshjes CEFTA duke ndihmuar bizneset në eksportet e tyre pa barriera tarifore dhe jotarifore; pregaditjen e materialeve për hyrje në OBT; funksionimi i Këshillit për Mbrotjen e Konsumatorit; pranimin e aplikacioneve dhe licencimin e kompanive të naftës dhe derivateve të tyre.

Poashtu do të plotësohet dhe ndryshohet legjislacioni primar dhe sekondar: amandamentimi i Ligjit për Metrologji 02/L-34; hartimi i Udhëzimit Administrativ për Instrumentet Matëse të Masës – Peshoret Jo-automatike të Klasës së Saktësisë I,II,III,IIII; hartimi i Udhëzimit Administrativ për Kushtet Metrologjike për Produktet e Para-paketuara; hartimi i Udhëzimit Administrativ për Njësitë Matëse; hartimi i Udhëzimit Administrativ për Formën dhe Përmbajtjen e Shenjave të Pastërtisë, Mënyrën e Përcaktimit dhe Shqyrtimit të Shkallës së Pastërtisë së Punimeve nga Metalet e Çmuara; hartimi i Udhëzimit Administrativ për Shitësit, Shenjat e Prodhuesit dhe Importuesit të Punimeve nga Metalet e Çmuara; Hartimi I Udhëzimit Administrativ për Pagesën e Kompensimeve të Ekzekutimit dhe Vulosjes së Punimeve nga Metalet e Çmuara; hartimi dhe Miratimi i Strategjia Zhvillimore për zhvillimin e sistemit metrologjisë 2009-2013.

Gjithashtu MTI do të punoj në përgatitjen e Udhëzimit Administrativ mbi Agregatet për ndërtim rrugësh, do të bëhët licencimi i ndërmarrjeve ndërtimore, hartimi i projektit për Institutin e Materialeve ndërtimore, autorizimi i trupave testues dhe certifikues; anëtarësimi në nivelet fillestare të Organizatës ndërkombëtare të standardeve ISO dhe IEC, involvim më i thellë të bizneseve në punën e ASK-së, kompletimi i bazës ligjore.

Prioritetet Afatmesme

Me qëllim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, mes tjerash, MTI-ja do të angazhohet në krijimin e një qendre trajnuese në kuadër të Drejtorisë së Akreditimit, pranimi në EA (Evropean Corporation for Accreditation), IAF (Internacional Accreditation forum) dhe ILAC **(*International Laboratory Accreditation Cooperation)***; nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale; kompletimin e kornizës legjislacionit sekondar; implementimin e strategjisë për zhvillimin e sistemit metrologjisë 2009-2013; anëtarësimi ne Organizmat rajonale dhe ndërkombëtare për metrologji; anëtarësimi në OBT si dhe anëtarësimi në të gjithë mekanizmat ndërkombëtar si anëtare e përhershme me te drejta të plota dhe ndërtimi i Qendrës së Panaireve.

Poashtu do të zhvillohen aktivitete si në vijim: hartimi i udhëzimeve administrative për materiale ndërtimi sipas prioriteteve qe do te përcaktohen, ngritja e kapaciteteve prodhuese, tregtues dhe

certifikuese te materialeve te ndërtimit, ndërtimi dhe funksionalizimi i Institutit te materialeve te ndërtimit dhe furnizmi i laboratorëve te institutit me aparatura dhe pajisje, anëtarësimi me të drejta të plota në ISO/IEC dhe anëtarësimi në nivelet fillestare të CEN/CENELEC.

b. Lëvizja e lirë e kapitalit

Në vitin 2008 Kosova kishte një rritje të BPV-ve prej 5.4%, ajo për kapita ishte rreth 1759 € ndërsa inflacioni arriti shifrën 9.4%, Papunësia mbetet edhe më tutje një nga problemet më serioze që paraqet një çështje tejet delikate për Kosovën, si një vend me popullatë të re. Të hyrat në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës u rritën për 5.0% në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa shpenzimet u realizuan vetëm 42.4%, çka shkaktoi një suficit prej rreth -2.3 milionë euro.

Sektori financiar arriti një zhvillim të mëtejshëm në vitin 2008. Sektori bankar, i dominuar nga bankat komerciale, duke pasur rreth 1.8 miliardë euro asete të tërësishme, shënoi një rritje prej 26.3%. Me marrjen e dy bankave vendëse nga një bankë e huaj, dominimi i bankave të huaja u rrit edhe më shumë. Normat e interesit për kreditë e lejuara kanë shënuar rënie të lehtë, ndërsa janë ngritur normat e interesit për depozita, gjë që ka ndikuar në një rënie të vogël të margjinës neto të interesit gjatë vitit 2008.

BQK tanimë është një institucion stabil dhe i qëndrueshëm, duke vazhduar avancimin e organizimit të brendshëm dhe aftësimin e vazhdueshëm të stafit të vet. Të gjitha këto janë arritur me ndihmën dhe asistencën teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bashkimit Evropian, USAID-it dhe Bankës Botërore, si dhe mbështetjen e parezervë të Qeverisë së Kosovës.

Këtë institucion e presin edhe sfida të reja, të cilat pritet të tejkalohen me sukses. Në këtë drejtim, ndërtimi i kapaciteteve, si atyre teknike, ashtu edhe menaxheriale, si dhe pavarësia efektive do të jenë faktorë kritikë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij institucioni tejet të rëndësishëm për Kosovën.

Institucioni përgjegjës në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). BQK-ja është subjekt i veçantë publik me autoritetin e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare në Kosovë. BQK-ja është trashëgimtarë i, fillimisht Autoritetit Bankar të Kosovës – ABK, e cila ishte themeluar në pajtim me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, shpallur më 15 nëntor 1999 (ndryshuar më 1 tetor 2001) "mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës", ndërsa më tutje, më 24 gusht 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka nënshkruar një Rregullore të re mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, duke transformuar kështu Autoritetin e Bankave dhe Pagesave në Autoritet Qendror Bankar të Kosovës, ndërsa më 1 korrik 2008 AQBK-ja bazuar në Kushtetutën e Kosovës është shndërruar në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Qysh prej fillimit, përpjekjet e BQK-së dhe pararendësve të sajë janë mbështetur nga një komponent i rëndësishëm i ndërtimit të kapaciteteve dhe asistencës teknike, të ofruar nga institucione e partnerë të ndryshëm.
Në vazhdimësi menaxherët elaboruan një "Plan Biznesi 2007-2009", i cili mbulonte synimet kryesore të Institucionit për këtë periudhë. Në fund të vitit 2009, si dhe në bazë të këtij dokumenti, rezultatet e secilës njësi të punës do të vlerësohen dhe do të krahasohen me synimet fillestare, ndërsa tani, ka filluar përpilimi i dokumentit "Plani Strategjik 2010-2015" i cili shumë shpejt do të jetë dokument referues i punës së BQK-së

Asetet e sektorit financiar kanë arritur në shifrën 1.7 miliardë euro në Shkurt 2009, kryesisht të përbëra nga kreditë për ekonominë vendore. Asetet e sektorit bankar mbeten elementi kryesor i aseteve totale

financiare, duke marrë 88.6% në qershor 2007 Bankat e inkorporuara në sistemin bankar në Kosovë janë 8.

Struktura ekzistuese e industrisë bankare reflektoj një sistem të nivelizuar në tre 'peer grupe†':

1. Tre bankat sistemike që përfaqësojnë mbi 85% të totalit të aseteve të industrisë bankare , në pronësi kryesisht të huaj, (Procredit Bank, Raiffeisen dhe NLB)
2. Dy bankat në pronësi vendore (Banka për Biznes dhe Banka Ekonomike)
3. Bankat e reja, të inkorporuar më vonë në tregun bankar Turkish Ekonomic Bank -TEB, Banka Kombëtare Tregtare -BKT dhe Komercijalna Banka – KMB.

Gjatë vitit 2008, ka vijuar hyrja e kapitalit të huaj ne sistemin bankar, dhe është funksionalizuar marrëveshja për bashkimin e dy bankave në një duke konsoliduar më tepër konkurrencën në tregun financiar. Gjithashtu, Bordi i BQK-s ka aprovuar licencën preliminare për bankën FIMA nga Kroacia.

Sistemi bankar në Kosovë, ka vijuar me rritje të qëndrueshme edhe gjatë vitit 2008. Totali i aktivit të sistemit bankar në vitin 2008 shënoi rritje për 26.86% krahasuar me vitin 2007.

Gjithashtu "Kreditë dhe lizingjet" kanë shënuar rritje vjetore prej 34.25%.

Gjatë 2008 u aprovua edhe Rregullorja e UNMIKUT nr. 2008/28 mbi regjistrimin, licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve mikrofinanciare.

Kjo rregullore, IMF-ve u mundëson mbledhjen e depozitave dhe si e tillë paraqet indikacion per levizjen e lire te kapitalit.

Korporatat jo-financiare (KJF) vazhdojnë të thithin pjesën më të madhe të kredive, ndërsa maturimi i kredive vazhdon të zgjatet. Edhe depozitat në sektorin bankar kanë shënuar rritje për 27.9% krahasuar me vitin e kaluar Burimi kryesor i depozitave vazhdon të jetë amvisëria, derisa maturimi mbetet kryesisht afatshkurtër. Sektori bankar ka shënuar performancë të mirë, me indikatorë të fuqishëm të fitimprurjes, derisa kanë mirëmbajtur likuiditetin dhe solvencën e tyre.

Njëmbëdhjete kompani te sigurimi që veprojnë në treg, dhjete kompania te sigurimit janë Jo Jete dhe një është Kompani e Sigurimit te Jetes.

Si në sektorin bankar ashtu edhe në sektorin e sigurimeve dominon pronësia e huaj. Aktualisht ekzistojnë 5 kompani të sigurimeve të huaja, 3 me pronësi te përbashkët dhe 3 të tjera me kapital vendor. Ne përgjithësi struktura e pronësisë së kompanive kosovare të sigurimit është 35.09% vendore dhe 64.91% është me pronësi te huaj. Në kuptimin e totalit të aseteve, kompanitë e sigurimeve janë rritur me 5.18% në baza vjetore, derisa Sigurimi i Palës së Tretë (TPL) mbetet aktiviteti kryesor i kësaj industrie për 73.51%.

Përveç tregut të sigurimeve, korporatat tjera financiare përfshijnë 2 fonde pensionale, 22 ndërmjetës tjerë financiarë, si dhe 24 institucione përcjellëse financiare nga të cilat disa veprojnë si zyra të këmbimit të valutave dhe si disa si agjenci të transferimit të parave. Shuma totale e fondeve pensionale të akumuluara në skemën e detyrueshme të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) ka regjistruar një rritje vjetore prej 48.5%. Aktivitet i rritur shënohet gjithashtu tek Ndërmjetësit Tjerë Financiarë (OFI) që kanë rritur vëllimin e kredive të dhëna me 33.95%, në baza vjetore. Për më shumë,

† Grupe përafërsisht me parametra financiar të të njëjtit nivel

transferimi i parave përmes Agjencive Përcjellëse Financiare (FA) ka shënuar rritje vjetore prej 7.2%, kryesisht me transferet nga Diaspora e Kosovës

Korniza ligjore e ndërtuar nga UNMIK-u dhe BQK-ja është e zhvilluar mirë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Si rezultat, industria financiare ka kapacitet për të mbështetur zhvillimin ekonomik në mënyrë të shëndoshë dhe të sigurt, në bazë të një tërësie gjithëpërfshirëse dhe moderne të Rregulloreve ne fuqi, Ligjit mbi Bankën Qendrore te Republikës se Kosovës, rregullave te brendshme te BQK-se si dhe letrave këshilluese që BQK lëshon për udhëzim të aktereve të sektorit financiar .

Sot, sektori financiar në Kosovë përfshin praninë e aktorëve nga rajoni i Ballkanit dhe BE-ja. Megjithatë, ende ka hapësirë për integrim më të gjerë ndërkombëtar të sektorit financiar të Kosovës, gjegjësisht përmes lidhjeve të avancuara kapitale dhe operacionale me aktorët financiarë nga rajoni, gjegjësisht nga vendet më të zhvilluara.

BQK do vazhdoje të përforcojë mbikëqyrjen e sektorit financiar përmes implementimit të kornizes ligjore Përbrenda këtij konteksti, BQK-ja do të azhurnoje ne vazhdimësi kornizën ligjore ne fuqi drejt harmonizimit dhe peraferimit te saj me direktivat e BE. Kjo do të arrihet përmes rishikimit të kornizës ekzistuese ligjore, me qëllim të sigurimit të një mbikëqyrjeje efektive dhe permanente, si dhe menaxhimit të ankesave në sektorin bankar, te sigurimeve, fondeve pensionale dhe institucionet tjera financiare jo-bankare.

Korniza ligjore që ka ndikim të drejtpërdrejt për Bankën Qendrore dhe për institucione financiare që licencohen, mbikëqyren dhe rregullohen nga Banka Qendrore, përbehet nga legjislacioni primar në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Ligji për Pensionet në Kosovë.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative të lartëpërmendur, në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, e cila përbëhët nga këto Rregullore dhe Urdhëresa Administrative:

- Rregullore Nr. 1999/21 për Licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave;
- Rregullore Nr. 1999/4 për Valutën e lejuar për përdorim në Kosovë;
- Rregullore Nr. 2001/25 mbi Licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e Kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit;
- Rregullore Nr. 2001/26 mbi Transaksionet e Pagesave;
- Rregullore Nr.2008/28 mbi Regjistrimin, licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve mikrofinanciare;
- Urdhëresë administrative nr. 2001/24 ndryshimi i urdhëresës administrative nr. 1999/2 mbi zbatimin e rregullores nr. 1999/4 për përdorimin e valutës së lejuar në Kosovë;
- Urdhëresë administrative nr. 2002/12 zbatimi i rregullores së unmik-ut nr. 2001/35 për pensionet në Kosovë;
- Urdhëresë administrative nr. 2002/13 zbatimi i rregullores së unmik-ut nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë;
- Urdhëresë administrative nr. 2006/11 për implementimin e rregullores 1999/21.

Bordi Drejtues i Bankës Qendrore, me qëllim të implementimit të legjislacionit në fuqi dhe ushtrimit të kompetencave për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Kosovë, ka nxjerrë ***134 Rregulla***.

c. Dogana dhe tatimet

Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është themeluar në gusht të vitit 1999 nga shtylla e e IV-të e UNMIK-ut, për të siguruar aplikimin e drejtë dhe të njëtrajtshëm konform rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Më 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u transferua në Doganën e Kosovës. Ky tranzicion u mundësua me anë të Kodit të ri Doganor dhe Akcizës i miratuar me 11 nëntor 2008 nga Kuvendi i Kosovës. Ky Kod është në pajtim të plotë me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe ndër të tjera ka si objektiv edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Përpos detyrimeve doganore që vilen nga Dogana, gjithashtu TVSH-ja dhe Taksa mbi akcizën vilen nëpër kufij. Përveç vjeljes së të hyrave, Dogana e Kosovës e mbron shoqërinë nga kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të krimit ekonomik si dhe evazionit në të hyra.

Dogana Kosoves është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe është i financuar tërësisht nge Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Dogana gjithashtu përfiton nga përkrahja teknike nga BE-ja përmes programit TACTA, e cila ka ndihmuar në zhvillimin e bazave të legjislacionit, organizimit, strukturës, në trajnimin dhe zhvillimin e stafit. Personeli i Doganës është i përbërë kryesisht nga nacionalitetet kosovare, prej tyre 12 % janë minoritarë.

Dogana e Kosovës vjel rreth 70% e të hyrave të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës me një mesatare 2 cent për 1 euro. FMN ka lavdëruar vazhdimisht Doganën për performancën e tij, duke e krahasuar në një nivel me Administratat Doganore të Evropës Perëndimore.

Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojta e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Pra, misioni i Doganës mund të ndahet në dy kategori kryesore:

1. *Kontributi në çështjet ekonomike*
    - Mbledhja e taksave doganore: si, Taksa doganore, Tatimit mbi vlerën e shtuar; Akcizën për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;
    - Kontrollimi i importit dhe eksportit, mbrojtja e ekonomisë, mbrojtja e markave tregtare etj; dhe
    - Statistika të sakta mbi tregtinë me jashtë.
2. *Kontributi për sigurinë*
    - Luftimi i aktiviteteve ilegale;
    - Rritja e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare; luftimi i krimit kufitar; luftimi i trafikut të drogës etj; dhe
    - Mbrojta e popullatës dhe ambientit, parandalimi i kontrabandimit të armëve dhe substancave eksplozive.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është themeluar më 17 janar 2000, nën administrimin e UNMIK-ut. Më 18 shkurt 2003, autoriteti për Administratën Tatimore iu transferua MEF-it. Qysh prej atëherë, ATK-ja ka funksionuar si organizatë e pavarur, menaxhuar plotësisht nga punëtorët vendorë, mbështetur nga këshillat e organizatave ndërkombëtare si USAID-i, Shtylla IV e BE-së dhe CAFAO-UNMIK nga BE-ja.

Gjatë historisë së saj të shkurtër, ATK-ja ka zhvilluar një strukturë funksionale organizative e cila në pjesën më të madhe është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ajo ka një qendër të centralizuar te Teknologjisë Informative për procedimin e dokumenteve, përmes të cilës përpunohen te gjitha deklarimet e tatimpaguesve. ATK-ja ka te punësuar përafërsisht 650 zyrtarë. Zyra Qendrore është përgjegjëse për ekzekutimin e politikave tatimore, përcaktimin e standardeve dhe organizimin e implementimit te Ligjeve dhe Rregulloreve ne fuqi. ATK-ja është e përberë prej 8 zyrave Regjionale te cilat janë përgjegjëse për implementimin e ligjeve tatimore, edukimin e tatimpaguesve, kontrollin dhe mbledhjen e tatimeve. Gjithashtu funksionon edhe njësia e tatimpaguesve te mëdhenj e cila po ashtu ka te njëjtat përgjegjësi sikurse edhe zyrat regjionale.

Legjislacioni tatimor është pranuar nga FMN-ja dhe Komisioni Evropian si transparent dhe cilësor. Legjislacioni i ATK-së në një masë të madhe është në përputhje me Direktivën e Gjashtë të BE-së. Në vitin 2008, inkasimi tatimor ka tejkaluar projeksionet për 10%. Vjeljet vjetore tregojnë rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e kaluara, edhe në një ekonomi me rritje të ultë ekonomike.

ATK-ja është përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave të qeverisë qendrore, duke përfshirë: TVSH-ne mbi furnizimin e brendshëm, Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Kontributet Pensionale dhe administrimin e Ligjit për Lojërat e Fatit.

Korniza ligjore
Korniza gjithëpërfshirëse legjislative e Doganës së Kosovës, bazohet në:
- *Kodi Doganor dhe i Akcizës 03/L-109;*
- *Ligji për Normat e Tatimit të Akcizës 03/L-112;*
- *Ligji për TVSH 03/L-114;*
- *Ligji për afarizmin e tregëtisë së jashtme;*
- *Rregullorja 2004/2, për shpërlarje parash;*
- *Rregullorja 2006/2, për ndalesa dhe kufizime të import/eksportit;*
- *Rregullorja nr. 2008/22 – IPR;*
- *Ligji Kundër Korrupsionit; dhe*
- *Kodi i Mirësjelljes së Doganës.*

Me qëllim të implementimit të Kodit Doganor, dokumentet strategjike në vijim janë duke u implementuar ndërsa që disa tjera pritet të implementohen pas fuqizimit të tyre:
- Korniza Strategjike Operacionale e Doganës së Kosovës 2009-2011 (SOF);
- EU Customs Blueprint;
- Memorandumet e Mirëkuptimit; dhe
- Plan-programi i Doganës për Trajnime.

Sa i përket fushës së tatimeve është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative, e cila rregullon fushen e tatimeve. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:
Ligji Nr.2004/48 per Administraten Tatimore dhe Procedurat i plotesuar dhe i ndryshuar ne Ligjin Nr.03/L-071 per Administraten Tatimore dhe Procedurat i cili ka hyre ne fuqi me 11 shkurt 2009 - Sipas këtij Ligji, ATK-ja ka statusin e Agjencisë Ekzekutive, e cila funksionon me autonomi të plotë operative brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Funksioni i ATK-së sipas këtij Ligji është të administrojë dhe zbatojë dispozitat e ligjit aktual dhe legjislacionit në fuqi në Kosovë që kërkon administrimin e çfarëdo tatimi si dhe te zbatoje autorizimet dhe detyrat tjera te deleguara nga Ministri për Ekonomi dhe Financa te cilat janë ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Rregullorja Nr.2004/51 per Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave i plotesuar dhe i ndryshuar, i shnderruar ne Ligj Nr.03/L-113 per Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave i cili ka hyre ne fuqi me 01 janar 2009 - Sipas ketij Ligji eshte mundesuar themelimi i nje ligji te vetem mbi te ardhurat e korporatave ne Kosove permes se

ciles percakton se kush eshte tatimpagues qe i nenshtrohet ketij ligji, kush eshte objekt i tatimit, te ardhurat e tatueshme, shkalla e tatimit, te ardhurat qe lirohen nga tatimi, shpenzimet , fitimet dhe humbjet ne kapital, humbjet ne biznes, likuidimet dhe riorganizimet, çmimet e transferimit dhe shmangia e tatimeve te dyfishta , etj.

Rregullorja Nr.2004/52 per Tatimin ne te Ardhurat personale i plotesuar dhe i ndryshuar, i shnderruar ne Ligj Nr.03/L-115 per Tatimin ne te Ardhurat Personale i cili ka hyre ne fuqi me 01 janar 2009. - Qellimi i ketij Ligji ka qene vendosja e nje tatimi te vetem e gjitheperfshires ne te ardhura ne Kosove ne te cilin perfshihen te ardhurat nga te gjitha burimet te cilat merren ose shtohen nga individet ne menyren qe eshte ne pajtim me praktikat me te mira nderkombetare dhe me standardet europiane.

Rregullorja Nr.2001/11 per Tatimin mbi Vleren e Shtuar i plotesuar dhe i ndryshuar, i shnderruar ne Ligj Nr.03/L-114 per Tatimin mbi Vleren e Shtuar i cili ka hyre ne fuqi me 01 janar 2009. - Sipas ketij ligji eshte percaktuar vendosja e tatimit mbi vleren e shtuar dhe regjistrimi per TVSH, llojet e furnizimeve, furnizimet me zero, furnizimet e perjashtuara dhe rabati , faturat tatimore , momenti i lindjes se detyrimit dhe pagesa si dhe rregullon kompetencat dhe detyrimet e institucioneve te cilet menaxhojne kete ligj.

Ligji Nr.2004/35 per Lojerat e Fatit - Sipas këtij ligji ATK-ja është përgjegjëse per administrimin dhe implementimin e Ligjit dhe akteve nenligjore per lojërat e fatit, lëshimin e licencave për Lojërat e Fatit si dhe mbikëqyrjen e përmbushjes së obligimeve të veprimtarive nga lojërat e fatit konform këtij Ligji.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e tatimeve, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, e cila përbëhët nga:

- UA Nr.05/2005, date 29/04/2005, per Administraten Tatimore dhe Procedurat;
- UA Nr.01/2005, date 02/2005, per Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave;
- UA Nr.02/2005, date 02/2005, per zbatimin e Tatimit ne te Ardhurat Personale;
- UA Nr.01/2005, date 31/05/2001, për zbatimin e Tatimit mbi Vleren e Shtuar;
- UA Nr.02/2006, date 29/09/2006, për zbatimin e Ligjit per Lojerat e Fatit;
- UA Nr.03/2008 date 24/04/2008 per Venien e Urdher-Vjeljeve ne llogarite bankare dhe llogarite e mbajtura ne instiucionet tjera financiare.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e tatimeve, *Plani Strategjik i ATK-se 2007-2010*, i rifreskuar ne Plani Strategjik 2008-2010 të datës 27 Qershor 2008 janë në implementim e sipër.

Korniza institucionale

Dogana e Kosovës përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 4 Drejtori, secila e ndarë në Departamente:

1. Drejtoria e Operimit të të hyrave
   - *Departamenti Qendror;*
   - *Kufijtë Jug-Perëndim;*
   - *Kufijtë Veri-Lindje.*
2. Drejtoria e Zbatimit të Ligjit
   - *Departamenti i Hetuesisë dhe Inteligjencës;*
   - *Departamenti Anti-kontrabandë;*
   - *Departamenti i Përmbushjes.*
3. Drejtoria Ligjore
   - *Departamenti për këshilla dhe procedura ligjore.*
4. Drejtoria për Financa dhe Sisteme
   - *Burimet njerëzore;*
   - *Financat dhe Logjistika;*

- *Prokurimi;*
- *Teknologjia informative.*

Në fundvitin e 2008, me qëllim të realizimit të mëtutjeshëm të detyrave të saj, Dogana ka themeluar edhe 3 sektorë të reja:

1. Sektori për Marrëdhënie me jashtë dhe Integrime Evropiane;
2. Sektori për Inspektim të Brendshëm;
3. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (IPR).

ATK në baze te organogramit akual eshte e perbere nga keto drejtorate dhe zyra te pavarura te cilat i raportojne direkt drejtorit te pergjithshem te ATK-se:

1. Drejtoria e Permbushjes;
2. Drejtoria e Operatives;
3. Drejtoria e Sherbimeve te perbashketa;
4. Drejtoria e Teknologjise Informative;
5. Drejtoria e Lojerave te Fatit.

Kurse zyret e pavarura jane:

1. Zyra e ankesave;
2. Zyra e auditimit te brendshem;
3. Zyra ligjore;
4. Zyra e standardeve profesionale;
5. Zyra e personelit.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian, përveç detyrave kryesore Dogana përkushtohet në zbatimin e plotë të Kodit Doganor e që është në përpuethshmëri të plotë me legjislacionin Evropian. Ky Kod do të përcillet me një Udhëzim Administrativ me anë të të cilit do të bëhet edhe implementimi i tij. Ndërkaq me qëllim të implementimit të Rregullores 2008/22, Dogana ka krijuar nën sektorin për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (IPR) dhe njëherazi ka hartuar dokumente përcjellëse (Qarkore dhe Formularin) me të cilat përcakton procedurat që duhen zbatuar për ndërmarrjen e masave doganore ndaj mbrojtjes së IPR.

Në fushën e tatimit, do të ndermerren keto veprime: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Tatimore në harmoni me Acquis; Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave në harmoni me Acquis; Hartimi I Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar; Krijimi i GP-së për hartimin e strategjisë për arkat fiskale dhe të udhëzimit administrativ; Fillimi i implementimit të arkave fiskale bazuar në rekomandimet e GP-së; Krijimi i njësive te reja, siç është Njësia për Analizën e Riskut; Deklarimi dhe pagesa përmes formularëve me bar-kode; do të bëhet analiza e nevojave për ngritjen e kapaciteteve administrative të ATK-së, etj.

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e Doganës, Dogana mes tjerash synon të luftoj korrupsionin, krimin ndërkufitar dhe shmangien nga detyrimet doganore. Për arritjen e këtij objektivi do të fuqizohet edhe më tutje implementimi i rekomandimeve që do të dalin nga konferencat ndërkombëtare, luftën kundër korrupsionit, falsifikimit dhe krimit të organizuar. Trajnimi i vazhdueshëm i kapaciteteve njerëzore do të mundësoj edhe krijimin e mekanizmave mbrojtës të këtyre dukurive. Hartimi i një U.A do të forcoj tutje infrastrukturën e brendshme ligjore në fushën e Trajnimeve. Dogana përmes bashkëpunimit ndërkombëtar do të siguroj se është duke u zbatuar ligji doganor dhe që po i njëjti mbrohet. Ky bashkëpunim do të formalizohet me nënshkrimin e

Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në çështjet doganore me vendet fqinje dhe ato Evropiane, të cilin hap Dogana po e përcjell me përkushtim të madh.

Në fushën e tatimit, do të ndermerren keto veprime: Rishikimi i legjislacionit tatimor te vendit me qellim te harmonizimit me ate te BE-se; Shtimi i vetedijesimit te punetoreve per etiken dhe kodin e mirësjelljes; Permiresimi i identifikimit te mosdeklaruesve dhe atyre qe kane nderprere deklarimin; Permiresimi i sistemit te menaxhimit te informatave dhe Permiresimi i sistemeve te bazuara ne rrezik.

d. Prokurimi publik

Më 15 janar 2004 u miratua Ligji mbi Prokurimin Publik (LPP) Nr. 2003/17. Më 8 shkurt 2007, u miratua Ligji për Ndryshimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 2007/02-L99. Ligji i ri, në pajtim me standardet evropiane dhe praktikat e mira ndërkombëtare, siguron ndryshimet e rëndësishme, mes të cilave, shkurtimin e gjitha afateve të prokurimit dhe zvogëlimin e procedurave të prokurimit nga shtatë në gjashtë. Më tutje, Ligji mbi Prokurimin Publik është thjeshtuar, derisa disa funksione të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe MEF-it i janë transferuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRrPP). Autoritetet kontraktuese kanë fituar më shumë pavarësi në zgjedhjen e procedurave të prokurimit.

Në bazë të këtij Ligji, përveç kompetencave ekzistuese, KRPP-ja është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e rregullave të prokurimit dhe sistemit të prokurimit publik të Republikës së Kosovës. LPP-ja përcakton edhe themelimin e organeve të reja, si Organi Shqyrtues i Prokurimit, Agjencia e Prokurimit Publik, dhe organe tjera që sigurojnë implementimin e Ligjit. Për më tepër, LPP-ja parashikon hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar për zbatimin e plotë të këtij ligji. Megjithatë, organet e lartpërmendura nuk janë themeluar ende (Organi Shqyrtues i Prokurimit) apo ende nuk janë konsoliduar (tjerat). Gjithashtu, ka një mungesë të legjislacionit sekondar për zbatimin e plotë të LPP-së.

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian në fushën e prokurimit publik, mes tjerash, KRPP-ja do të synojë kompletimin e akteve nënligjore për zbatimin e LPP-së, duke përfshirë Udhëzimin për Implementimin e LPP-së, Dosjes së Tenderit dhe Udhëzimeve për Përdorim, miratimin e Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe Udhëzimet për Kornizën e Kontratës. Në plotësimin e kornizës institucionale, parashikohet themelimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, anëtarët e të cilit do të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe zhvillimi i kapaciteteve administrative të këtij organi. Themelimi i një organi të tillë të pavarur do të ketë një ndikim në zbatimin e sigurt të rregullave të prokurimit dhe në luftimin e keqpërdorimeve.

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiannë fushën e prokurimit publik, KRPP-ja, mes tjerash, do të synojë të sigurojë zbatimin e duhur të rregullave të prokurimit publik përmes mbikëqyrjes së autoriteteve kontraktuese. Veprimet tjera të rëndësishme përfshijnë ofrimin e rekomandimeve dhe masave të propozuara kundër autoriteteve në kundërshtim të dispozitave të LPP-së. Për më tepër, përmirësimi i efikasitetit në KRPP do të arrihet përmes rekrutimit të personelit të ri dhe trajnimit të personelit aktual në zbatimin e LPP-së. Gjitha këto veprime do të mundësojnë përmbushjen e prioriteteve për këtë nën-fushë dhe do të rrisin efikasitetin e organeve të prokurimit publik.

e. Të drejtat e pronësisë intelektuale

Të drejtat e pronësisë intelektuale janë të ndara në dy nën-fusha: pronësia industriale e cila përfshin zbulimet, markat tregtare, dizajnin industrial si dhe indikacionet gjeografike të burimeve; si dhe e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta e cila përfshin veprat letrare dhe artistike si novelat, filmat, veprat muzikore, pikturat, fotografitë dhe dizajnet arkitektonike.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së drejtes së pronësisë intelektuale në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- Ligji mbi Patentat Nr. 2004/49 më 27 shtator 2004,
- Ligji mbi Markat tregtare Nr. 2006/02-L54 më 23 shkurt 2006,
- Ligji mbi Dizajnin Industrial Nr. 2005/02-L45 më 21 nëntor 2005, si dhe
- Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave Autoriale dhe të drejtave tjera të përafërta Nr. 2004/45 më 29 qershor 2006.

Për zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve janë miratuar edhe këto akte nënligjore:

- UA "Për Procedurat e Regjistrimit të Patentave",
- UA "Për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare",
- UA "Për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit Industrial",
- UA "Për njohjen e të drejtave të objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në ish-Jugosllavi",
- UA "Për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale" dhe
- UA "Për Përfaqësuesit e autorizuar në Sferën e Pronësisë Industriale.

Korniza institucionale
Për implementimin e legjislacionit të sferës së pronësisë industriale është themeluar Zyra e Pronësisë Industriale; zyra është mandatuar, brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Zyra deri në (Mars 2008) ka pranuar 600 kërkesa për mbrojtjen e të drejtave të pronës industriale.

Të drejtat e pronësisë intelektuale janë ndarë në dy nën-fusha: pronësia industriale e cila përfshin zbulimet, markat tregtare, dizajnin industrial si dhe indikacionet gjeografike të burimeve; si dhe e drejta e kopjimit, e cila përfshin veprat letrare dhe artistike si novelat, filmat, veprat muzikore, pikturat, fotografitë dhe dizajnet arkitektonike.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, MTI-ja, MKRS-ja dhe IGjK-ja mes tjerash do të synojnë implementimin e masave që janë parashikuar për zhvillimin e kapaciteteve administrative/gjyqësore për luftimin e shkeljeve masive. Synimi është sigurimi i implementimit të ligjeve në fushën e pronësisë intelektuale, pasi që ka tanimë prapambetje të theksuar, përforcimi i kapaciteteve administrative përmes rekrutimit dhe trajnimeve, si dhe kapacitetit në IT, aktet nënligjore që sigurojnë të drejtat autoriale dhe të përafërta do të përgatiten, ndërtimi i kapaciteteve të Zyrës së Pronësisë Industriale (ZPI) është parashikuar përmes trajnimeve, themelimi i Zyrës për të Drejta Autoriale dhe ndërtimi i kapaciteteve administrative për këtë Zyrë, si dhe aktivitetet përgatitore për nënshkrimin e konventave/marrëveshjeve në nën-fushën e pronësisë industriale.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiannë fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, mes tjerash, MTI-ja do të miratojë dhe zbatojë Strategjinë për Krijimin e Sistemit të Mbrojtjes së Pronës Industriale, do të implementojë fushata vetëdijesimi mbi të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta, si dhe do të përqendrohet në avancimin e kapaciteteve administrative.

f. Punësimi dhe politikat sociale

Qeveria është e angazhuar maksimalisht për zbutjen e problemeve sociale, ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të punësuarit në Kosovë, si dhe për krijimin e kushteve për punëkërkuesit, që të

aftësohen në ato profile që i kërkon ekonomia e tregut.

Për t'i realizuar këto qëllime, është dashur që në radhë të pare të krijohet infrastruktura ligjore, andaj prioritet i punës sonë është hartimi i projektligjeve në përputhje me standardet e shoqërive demokratike me çrast MPMS-ja do të vazhdoj edhe më tej plotësimin e infrastrukturës ligjore në bazë të standardeve evropiane.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së punësimit dhe mirëqenies sociale është një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative, e cila rregullon këtë sektor. Kjo kornizë përbehet nga legjislacioni primar si në vijim:

- Ligji Nr. 2002/1 mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë se pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë
- Ligji Nr.2002/9 mbi inspektoratin e punës në Kosovë
- Ligji Nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë
- Ligji Nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës
- Ligji Nr.2003/23 për pensionet e personave më aftësi të kufizuara në Kosovë
- Ligji Nr.2006/02L-17 për arsimin dhe aftësimin profesional
- Ligji Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare
- Ligji Nr.02 L-2 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmoreve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës
- Ligji Nr.03/L-017 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9
- Ligji Nr.03/L-22 për përkujdesjen materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara
- Ligji Nr.03/L-100 për pensionim të parakohshëm të pjestarëve të TMK-së
- Ligji Nr.03/L-084 për Fondin Pensional të Kosovës
- Ligji për aftësimin dhe riaftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e punësimit dhe mirëqenies sociale, në fuqi janë *88 Udhëzime Administrative*.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e punësimit dhe politikave sociale dokumentet strategjike në vijim janë në implementim dhe hartim e sipër:

- Strategjia e Punësimit e Kosovës 2008-2013;
- Strategjia Sektoriale e MPMS-së (në hartim e sipër);
- Plani i Veprimit për Punësimin e të Rinjve;
- Plani Social i Veprimit për Implementimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Çështje Sociale në kuadër të Traktatit për Komunietin e Energjisë.

Korniza institucionale
Roli dhe misioni i MPMS-së është hartimi dhe zbatimi i politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e punësimit, mbrojtjes sociale, aftësimeve profesionale, dialogut social dhe çështjeve të tjera nga fusha e punës dhe mirëqenies sociale si dhe mbikëqyrja e zbatimi të tyre.

Në kuadër të Ministrisë veprojnë shtatë (7) Departamente dhe Inspektorati i Punës.

Departamenti i Shërbimit Qendror të Administratës - është përgjegjës për aspektet financiare, administrative, menaxhimin e resurseve njerëzore, logjistikën dhe infrastrukturën.

Departamenti i Mirëqenies Sociale (DMS) – DMS është përgjegjëse për menaxhimin e skemave dhe shërbimeve sociale, zhvillimin dhe promovimin e politikave adekuate, implementimin e legjislacionit zyrtar, planifikimin për njësitë vartëse, mbikëqyrjen e punës së QPS-ve dhe institucioneve tjera që

ofrojnë shërbime 24 orë (shtëpia për persona të moshuar, Instituti special në Shtime dhe shtëpitë me bazë në komunitet, etj.)

Departamenti i Punës dhe Punësimit (DPP) - Është përgjegjës për implementimin e politikave të punësimit, hartimin e strategjisë së punësimit, aftësimeve profesionale, ofrimin e ndihmës teknike, mbikëqyrjen e njësive vartëse organizative, bashkëpunimin me organizma që merren me lëmin e punës dhe punësimit,etj.

Departamenti i Administrates Pensionale të Kosovës (DAP) - DAP ka përgjegjësinë e menaxhimit, mbikëqyrjes dhe administrimit të skemave pensionale dhe benificioneve për të gjithë qytetarët e Kosovës. Përmes këtij Departamenti bëhet procedimi i:

- skemës së pensioneve themelore-bazike;
- skemës së personave me aftësi të kufizuara;
- skemës së pensioneve të parakohshme (ish punëtorët e Trepçës); dhe
- ndihma për realizimin e pensioneve të jashtme sipas konventave ndërkombëtare.

Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFDIL) - përkujdesja për familjet e Dëshmorëve, për invalidët e luftës dhe viktimat civile është përgjegjësi e këtij Departamenti.

Departamenti i Institutit të Politikës Sociale (DIPS) – Ka për objektiv që të promovoj standarde profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare**,** të bëj licencimin e profesionistëve të kësaj fushe, të trajnoj dhe jap këshilla profesionale, të bëj hulumtime, anketa, analiza dhe publikime përkatëse për çështje, fenomene e dukuri të caktuara shoqërore.

Departamenti Ligjor (DL) - Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është i organizuar dhe i strukturuar në dy divizione (1) Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit dhe (2) Divizioni për mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve. Departamenti harton legjislacionin primar dhe sekondar të MPMS-së, kujdeset për harmonizimin e ligjeve me legjislacionin e BE-së, bën përfaqësimin e Ministrisë në gjykata si dhe regjistrimin e organizatave sindikale, etj.

Poashtu pjesë përbërëse e Ministrisë së Punës dhe Mireqenies Sociale është edhe:

Inspektorati i Punës - mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Rregullores 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, dispozitave të Ligjit Nr.2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, Rregullores Nr.2004/01 mbi Masat Higjienike dhe Teknike të Sigurisë në Punë, Rregullores Nr.2005/02 mbi Vlerësimin e Rrezikshmërisë në Punë dhe Lidhur me Punën, Kontratën e Përgjithshme Kolektive, e zbaton Vendimin nr.81/06 për marrjen e pëlqimit për punë dhe dispozitave tjera të aplikueshme ku rregullohet lëmi i punës, punësimit, sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës. AEIP-ës, ushtron mbikëqyrje në tërë territorin e Kosovës.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e punësimit dhe të politikave sociale do të ndërmerren këto veprime: do të bëhet ndërtimi i dy zyrave të punësimit për ofrim të shërbimeve të komuniteteve, Zyra Komunale e Punësimit në Shtimje dhe Zyra Komunale e Punësimit në Podujevë, do të bëhet transferimi i nënzyrave komunale të punësimit në zyra komunale të punësimit në vendbanime ku do të shëndrrohën në Komuna me qëllim të riorganizimit të zyrave Komunale të Punësimit në Komunat e reja, për ngritjen e cilësisë së shërbimeve përmes trajnimeve të ofruara dhe nxitjen e punësimit përmes projekteve tek grupet e të rinjve dhe përsonave me aftësi të kufizuara. Do të bëhet funksionalizimi i plotë i shtëpive të komunitetit në Deçan dhe Dardanë për

persona me aftësi të kufizuara mendore dhe funksionalizimi i shtëpive për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare në Skenderaj dhe Burim/Istog.
Njëherit do të ofrohen shërbime për personat me atësi të kufizuara dhe të moshuar, të vendosur në shtëpitë e komunitetit nëpër disa regjione të Kosovës

Poashtu, do të ndërmerren veprime konkrete në Instalimin e Bazës së të dhënëve në Departamentin e Institutit për Politika Sociale - për menaxhimin e të dhënave për fëmijët e identifikuar në punë në Kosovë, të identifikuar nga KLV (Komitetet Lokale të Veprimit për MPF) nga të gjitha komunat e Kosovës, do të punohet në ngritjen e kapaciteteve në nivelin Lokal të partnerëve me qëllim të vendosjes së strukturave Lokale për MPF në të gjitha komunat e Kosovës (Krijimi i Komiteteve Lokale të Veprimit), do të organizohen tryeza prezantuese në secilën Komunë të re me së paku 15 autoritete (Subjekte- partner) të larta të nivelit lokal të qeverisjes lokale.

Prioritetet afatmesme
Në periudhën afatmesme, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e punësimit dhe të politikave sociale do të ndërmerren këto veprime: do bëhet ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimeve në Sektorin e Dizajnimit të Politikave të Punësimit, me qëllim të pregatitjes së planeve dhe projekteve konkrete të punësimit, parashihet ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimeve në Sektorin e statistikave të informimit dhe analizave të tregut të punës, do të punohet në hartimin e projekteve për ngritjen e shkallës së punësimit për këto grupe të caktuara; të të rinjve grup-mosha 18-39 vjeç,b) të papunët afatgjatë që presin për punësim mbi 12 muaj, c) personat me aftësi të kufizuara, gjithashtu do ketë angazhim maksimal nga të gjitha strukturat e punësimit në vend për gjetjen e mënyrave të pershtatshme për krijimin e Marrveshjeve të Mirëkuptimit për ndërmjetësim në punësim sezonal jashtë vendit.
Do të hartohet strategjia afatmesme e ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve dhe përmirësimi i kushteve të punes për Qendrat për Aftësim Profesional, me sektorin për rikualifikim të fuqisë punëtore do të bashkëpunohet me ofertues të jashtëm të trajnimeve me qëllim të shtimit të numrit të punëtoreve të kualifikuar.

Poashtu do të bëhet ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimeve në Sektorin e Dizajnimit të Politikave të Punësimit, me qellim të pregatitjes se planeve dhe projekteve konkrete te punësimit.

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me komunitetin lokal te biznesit me qëllim të nxitjes dhe rritjes së kërkesës për forcën e punës do punohet në hartimin e projekteve të përbashkëta që kanë për qëllim rritjen e kërkesës për forcën e punës në tregun e punës në sektorin publik dhe privat.

g. Arsimi dhe hulumtimi

Përcaktimi i arsimit nga Qeveria si një nga prioritetet themelore ka për qëllim që sisitemi arsimor t'i shërbeje një shoqërie të bazuar në dije, perspektivë ekonomike dhe punësim. Ngritja e kualitetit qeverisës përmes udhëheqjës dhe menaxhimit cilësor dhe efikas të sistemit ofron mundësine për gjithëpërfshirjen e gjeneratës së re në arsim fillor dhe të mesem, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimdhënje dhe mësimnxënie. Duke ndërtuar lidhje të qëndrueshme të arsimit me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore do të aktualizohet rëndesia e kualifikimeve në fushën e arsimit professional dhe të arsimit të larte për nevojat e ekonomisë dhe tregut të punës.

Vizioni i përgjithshëm i Qeverisë është që Kosova të bëhët një shoqëri e bazuar në dije dhe shkathtësi konkurruese brenda dhe jashtë saj, e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për avansimin personal të të gjithë individëve që jane të aftë dhe të përgaditur të kontribojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social, kulturor, politik dhe shoqëror.

Misioni i Qeverisë është që Kosova të jetë shoqëri demokratike e integruar në rrjedhat evropiane, që ofron kushte dhe mundësi të barabarta për zhvillimin personal të të gjithë qytetarëve, ku qasja në përfitim të dijes, të aseteve kërkimore – shkencore dhe të përfitimit të shkathtësive, janë për të gjithë të interesuarit të ofruara dhe në funksion të zhvillimit të përshpejtuar dhe të qëndrueshëm të shoqërisë dhe kapaciteteve konkurruese jashtë Kosovës.

Korniza ligjore

Sa i përket fushës së arsimit është një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative e cila rregullon sektorin e arsimit. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë Nr.2002/2,
- Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë Nr.2002/03,
- Ligji mbi Inspeksionin e Arsimit në Kosovë Nr.2004/37,
- Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve Nr.02/L-24,
- Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr.02/L-42,
- Ligji mbi Veprimtarinë Kërkimore – Shkencore Nr.2004/42,
- Ligji mbi Edukimin Parashkollor Nr.02/L-52,
- Ligji mbi Botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik Nr.02/L-67,
- Ligji mbi Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-68,
- Ligji për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore 03/L-018 dhe
- Ligji për Kualifikimet Kombëtare Nr.03/L-060

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse e akteve nënligjore e përbërë prej *47 Udhëzimeve Administrative*.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë, dokumentet strategjike në vijim janë në implementim e sipër:

- Strategjia për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2007-2017,
- Strategjia e Arsimit të Lartë në Kosovë 2005-2015, dhe
- Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2007- 2017.

Korniza institucionale

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) si institucion përgjegjës për ç'është arsimore, ka dhjetë Departamente:

- Departamenti për Koorodinim të Zhvillimit dhe Integrime Evropiane,
- Departamenti i Administratës së Arsimit Parauniversitar,
- Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar,
- Departamenti i Arsimit të Lartë
- Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë,
- Departamenti i Inspeksionit,
- Departamenti Ligjor,
- Departamenti i Prokurimit,
- Departamenti i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Teknike, dhe
- Departamenti i Financave dhe Personelit.

Poashtu pjesë përbërëse të MASHT-it janë edhe:

- Universiteti i Prishtinës,
- Instituti Albanologjik,

- Instituti i Historisë,
- Bibloteka Kombëtare dhe Universitare,
- Qenda e Studentëve,
- Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik, dhe
- Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsimin e Lartë, Shkencë dhe Teknologji (QBNASHT).

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropiannë fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjise do të zhvillohen aktivitete që lidhen me realizimin e projekteve të parapara që realizohen me buxhet të këtij viti si: ndërtimi i objekteve, renovimi i shkollave, blerja e librave, furnizimi me invertar, do të bëhet studimi i fizibilitetit "Sector Approch" në gjithë sektorin e arsimit, në të gjitha nivelet; Adresimi i rekomandimeve të dala nga studimi i fizubilitetit; Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës prioritare; Përgaditja dhe kompletimi i dokumentacionit për projekte (para- masat dhe parallogaritë) e ndërtimeve në objektet shkollore; Ndërtimi i hapsirave të reja shkollore dhe mbikqyrja e punimeve të renovimit në teren; Përmirësimi i hapsirave ekzistuese shkollore (renovim), dhe mbikqyrja e punimeve të renovimit në teren; Paisja e shkollave me materiale dhe mjete mësimore.

Poashtu do të hartohet Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Arsimin Parauniversitar; do të hartohet Plani i Veprimit në konsultim me të gjithë akterët dhe të interesuarit e sistemit të lartë; do të implementohet Strategjia për Arsimin e Komuniteteve RAE. Do të bëhët: kompetenca e arsimit 2007-2017; zhvillimi i plan-programit në gjuhën rome si gjuhë fakultative; hapja e tenderit për tekstin shkollor për gjuhën rome me elemente të historisë dhe kulturës; vlerësimi i dorëshkrimeve të gjuhës rome me elemente të historisë dhe kulturës; botimi i teksteve shkollore të gjuhës rome me elemente të historisë dhe kulturës; trajnimi informativ i arsimtarëve RAE për plan-programe dhe tekste shkollore të gjuhës rome me elemente të historisë dhe kulturës; trajnimi i përhershëm i mësimdhënësve të komunteteve RAE; përfshirja e fëmijëve të komuniteteve RAE në arsimin parashkollor; regjistrimi i nxënësve të komuniteteve (turq, boshnjak, rom, ashkanli, egjiptian dhe kroat) në shkolla të mesme në drejtime të ndryshme; sigurimi i teksteve mësimore (dorëshkrime, autorësi, lektura, përkthime) në gjuhët amtare të minoriteteve; etj.

Prioritetet afatmesme

Në periudhën afatmesme, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë do të bëhet: Monitorimi i Implementimit të strategjise dhe planit të veprimit për edukim parauniversitar; Monitorimi i Implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit për edukim të lartë; Caktimi i niveleve të aftësimit dhe arsimit bazuar në kornizën e kualifikimeve europiane; Akreditimi i Institucioneve të Arsimit të lartë në Kosovë, etj.

Poashtu do të organiziohen punëtoritë me arsimtarë (filozofia e planprogramit në zbatim, këshilla, udhëzime etj.); Bashkëpunimi me Qendrën për Sigurim të cilësisë në UP dhe inicimi i themelimit të zyrave të njejta në të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë; Bashkepunimi i Agjencionit të Akreditimit të Kosoves dhe DAL me Zyrën për Sigurim të Cilesisë në UP dhe me të gjitha zyrat e njëjta të IAL në Kosovë; Zhvillimi i procesit të akreditimit të dytë për IAL; Ngritja e kapaciteteve profesionale të inspektoreve arsimor; etj.

Sa i përket zhvillimit të politikave për inkujarimin e kërkimeve, do të bëhet: Hartimi i Udhëzimit Administrativ për themelimin e QITT; Themelimi dhe funksionailizimi i QITT-se; Incitimi i procedurës për rishikimin e Ligjit për Veprimtarinë Kerkimore-shkencore; Financimi i botimit të punimeve shkencore si dhe ndihmë në botimin e revistave shkencore; Themelimi dhe funksionalizimi Këshillit

Kombtar për Shkencë; Krijimi i Grupit Punues për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Shkencës; Hartimi I Programit dhe Strategjise Kombetare te Shkencës.

2.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE

a. Industria dhe NVM-të

Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare janë pajtuar mbi Kartën për Ndërmarrjet e Vogla për të përmirësuar mjedisin afarist për ndërmarrjet e vogla. Me inkurajimin e autoriteteve publike në gjitha nivelet për të shkëmbyer përvojat e punës së tyre mbi politikat e kësaj fushe, secili mund të mësojë nga shembujt të cilët kanë funksionuar për të tjerët, duke shpejtuar përmirësimin e tyre.

Përveç Shteteve Anëtare të BE-së, Karta gjithashtu është miratuar nga Norvegjia, shtetet Euro-Mesdhetare, shtetet në Ballkanin Perëndimor dhe nëntë rajonet evropiane. Karta është vërtetuar si vegël e suksesshme edhe për të ndihmuar Kosovën në politikat e saj në NVM në përgatitje për anëtarësim në BE.

Duke marrë parasysh që orientimi përfundimtar i Kosovës është Bashkimi Evropian, mbikëqyrja dhe organizimi i tregtisë, pronës industriale, ndërtimtarisë, hotelerisë, industrisë dhe turizmit janë fusha të përqendrimit special për Qeverinë. Kjo do të kërkojë zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e investimeve dhe garantimin e investimeve.

Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës fizike për NVM-të në Kosovë, është punuar në programin e hapësirave të punës që në vete përmban:

- Parqet e Biznesit,
- Parqet Industriale,
- Zonat Industriale dhe
- Inkubatorët e Biznesit.

Parku i Biznesit në Mitrovicë - Ky Park Biznesi përfshinë një sipërfaqe prej 3.5 ha, nga i cili kanë përfituar gjithsej 21 NVM. Deri më tani në këtë park, nga 21 biznese të selektuara 3 prej tyre kanë ndërtuar objektet e tyre afariste ndërsa 2 te tjera janë në ndërtim e sipër. Faza e dytë e punimeve është në përfundim e sipër nga Agjencina Evropiane për Rindërtim.

Parku Industrial në Drenas - Parku Industrial në Drenas është alokuar në fshatin Koreticë e Ulët dhe shtrihet përgjatë rrugës kryesore Prishtinë-Pejë, 5 km nga Aeroporti i Prishtinës 7 km nga Stacioni Hekurudhor, 75 km nga Shkupi 280 km nga Porti i Durrësit Hapësira totale e Parkut Industrial është 24ha. Nga ky park do të përfitojnë gjithsej 72 ndërmarrje me një strukturë të parcelave si në vijim:

- 1,000 m² - 13%,
- 3,000 m² - 38%,
- 6,000 m² - 30%.

Panairi "Gratë në Biznes" - Ne lidhje me këtë janë grumbulluar te dhënat nga OJQ-të dhe bizneset tjera me pronare të gjinisë femërore, është përpunuar baza e të dhënave, është bërë selektimi për pjesëmarrje në panair dhe është përgatitur konkursi për pjesëmarrje në panair.

Kllasterët - Është bërë fokusimi dhe identifikimi i tre grupeve të kategorive të veçanta për kllasterizim si:

- Kllasteri i Gurëve në Gjurgjevik të Klinës,
- Kllasteri i përpunimit të arit në Prizren dhe
- Kllasteri i Verës në Rahovec.

Skema Vauqer e Këshillimeve dhe Trajnimeve për Ndërmarrësi - Ngritja e nivelit të aftësisë ndërmarrëse tek pronarët dhe menaxherët e NVM-ve është një sfidë tjetër e agjencisë e cila kërkon një qasje serioze për të ngritur me këtë aftësinë konkurruese të NVM-ve.
Agjencia për Mbështetje të NVM-ve këtë fushë aktualisht është duke e mbuluar përmes projektit "Skema Vauqer e Këshillimeve dhe Trajnimeve".

Këshilli Konsultativ i NVM-ve - Në bazë të nenit 1, alineja 2. te Rregullores se Punës së Këshillit konsultativ të NVM, nr. 291 MTI, "Këshilli është forum i pavarur i përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm të biznesit, asoacioneve të bizneseve, të institucioneve shkencore dhe ekonomike, të emëruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me mandat trevjeçar'. Këshilli është një mekanizëm këshillues që funksionon pranë AMNVM-ve.
Bazuar në planin dinamik te Agjencisë për mbështetje te NVM-ve për vitin 2008, janë bërë të gjitha përgatitjet për emërimin ose riemërimin e anëtarëve të KK për vitin 2008 dhe janë propozuar tek strukturat vendimmarrëse.

Teknologjia Informative në Ndërmarrje (TIN) - Projekti ka për qëllim krijimin e një baze të dhënave për bizneset në mënyrë të qasjes më të lehte përmes formës elektronike në kontakte me institucionet qeveritare. Deri në këtë periudhë raportuese është arritur krijimi i bazës së të dhënave me mbi 1000 ndërmarrje.

Strategjia e Mësimit të Ndërmarrësis - Pas miratimit dhe publikimit të Strategjisë kombëtare për arsim dhe aftësim në ndërmarrësi nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, gjatë kësaj periudhe kohore me qëllim të implementimit të Trajnimit të Mësimdhënësve për shfrytëzimin e moduleve të reja të arsimit dhe aftësimit në ndërmarrësi, Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve ka ofruar bazën e të dhënave të trajnerëve dhe këshilltarëve, Projektit KOSVET – III. Në kuadër të trajnimit për Arsimim dhe Aftësim në Ndërmarrësi Niveli V, nga KOSVET III janë Certifikuar 21 trajner ndër ta dhe zyrtarë nga Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve.

Karta Evropiane e Ndërmarrjeve të Vogla - është një instrument strategjik i Komisionit Evropian i cili aplikohet në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor si një metodë planifikimi për vitet e ardhshme që këto vende të arrijnë standardet Evropiane në të dhjetë linjat e veprimit të Kartës.

Gjatë kësaj periudhe janë duke u përcjellur të arriturat e progresit në 10 linjat e Kartës, me qëllim të raportimit para Drejtoratit Gjeneral të Komisionit Evropian për ndërmarrje të vogla.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së Industrisë dhe NVM-të është një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative, e cila përbëhet prej dy ligjeve:

- Ligji për mbështetjen e NVM-ve, 02/L-5;
- Ligji Nr. 02/L-33 Mbi Investimet e Huaja;
- Ligjit për Kërkesa Teknike dhe Vlerësim të Konformiteti NR.03/L-093 ;
- Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve 02 L-21;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-5 për Mbështetjen e NVM-ve, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës me nr. 03/L-031.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e Industrisë dhe NVM, në fuqi janë këto Udhëzime Administrative:

- UA për funksionimin e Agjencisë, nr 2006/28.
- UA për Themelimin e Këshillit konsultativ të NVM-ve. Aprovuar nga Ministri i MTI-së në shtator të vitit 2008, me nr. 2008/14.

- UA për Organizimin e Brendshëm të Agjencisë, në shqyrtim të grupit punues.
- UA për funksionimin e Skemës Vaucher të këshillimeve, në shqyrtim të grupit punues.
- UA Nr. 2009/2 për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës.
- UA Nr. 2009/4 për caktimin e tarifave për akreditim.
- UA Nr.2008/10 për përbërjen dhe rregullimin e këshillit të akreditimit.
- UA Nr. 2008/19 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimin e emblemës së akreditimit.

Korniza institucionale

Departamenti i Industrisë në kuadër të MTI-së, është një mekanizëm që në mënyrë institucionale mbështet krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit industrial në mënyrë që të jetë konkurrues në tregun vendor, rajonal dhe me gjerë. Harton politikat industriale të zhvillimit mbi shfrytëzimin dhe përdorimin efektiv të burimeve natyrore dhe njerëzore për zhvillim që ndikon në rritjen e prodhimit vendor dhe rritjen e eksporteve, po ashtu harton legjislacioni Industrial konform Direktivave te BE-së dhe kompatibil me praktikat e OBT-së;

Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve te Vogla e te Mesme në kuadër te Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë, është ngritur mbi bazat e Ligjit për Mbështetjen e NVM-ve me nr. 02/L-5. Ligjit Nr. 02/L-5 përcakton qëllimin e themelimit të Agjencisë që nënkupton implementimin e këtij ligji.

Roli i Agjencisë është:

- Agjencia zbaton politikat dhe strategjitë e përcaktuara nga Ministria Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje dhe zhvillim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (në tekstin e mëtejmë NMVM);
- Agjencia bënë organizimin dhe hartimin e programeve që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë e NMVM, që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, si dhe koordinimin me programet e donatorëve;
- Koordinimin e programeve që lidhen me krijimin dhe zhvillimin e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si: inkubatorët e biznesit, parqet e biznesit, parqet industriale, parqet teknologjike, programet e trajnimeve dhe të këshillimeve, si dhe hartimin dhe zhvillimin e programeve të reja në mbështetje të NMVM në Kosovë;
- Krijimin e lehtësive për kreditimin e NMVM-ve, si dhe paraqitjen e propozimeve për përmirësimin e legjislacionit me të cilin rregullohet sektori privat për të investuar në NMVM;
- Krijimi i kushteve për një zhvillim të balancuar të MNVM-ve në Kosovë;
- Zhvillimi i kulturës ndërmarrëse dhe promovimi i ndërmarrësisë.

Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve, ka arritur të krijojë një bazë të shënimeve me informata për më shumë se 100 kompani, si dhe ka përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme për emërimin e anëtarëve të Këshillit Konsultativ për NVM-të. Gjithashtu, kjo Agjenci është përgjegjëse për koordinimin e gjithë punës për implementimin e Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme si dhe përparimit të tyre drejt linjave të veprimit të kësaj Karte.

Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovës (APIK) - është agjenci e themeluar nga Ligji Nr. 02/L-33 'Mbi Investimet e Huaja' me 2005, dhe ka për qëllim që të: Siguroj integrimin e plotë të Kosovës në regjion, në ekonomitë Evropiane dhe Botërore duke inkurajuar transferin e kapitalit, teknologjisë moderne, të dijes, shërbimeve financiare dhe intelektuale përmes tërheqjes së Investitorëve të huaj. Njëkohësisht qëllim primar është që nëpërmjet realizimit të projekteve të nxitë eksportin e prodhimeve vendore dhe të ndikon në zvogëlimin e bilancit negativ në shkëmbimet tregtare.

Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) bënë regjistrimin e bizneseve të reja dhe ri-regjistrimin e tyre si:

- Biznese Individuale;
- Ortakëri të përgjithshme;
- Ortakëri të kufizuar;
- Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- Shoqëri aksionare;
- Kompani të huaj;
- Ndërmarrje shoqërore;
- Ndërmarrje publike;
- Kooperativa bujqësore;
- Ndërmarrje të tjera nën juridiksionin e AKM-së.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropiannë fushën e industrisë dhe NVM-ve, mes tjerash, MTI-ja do të implementojë strategjinë afatmesme për mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve, duke përfshirë përforcimin e Agjencisë për Mbështetjen e NVM-ve dhe Agjencisë së Promovimit të Investimeve, por edhe implementimin e Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla. Ajo gjithashtu do të përforcojë kapacitetet institucionale dhe implementimin e strategjive, planeve të veprimit dhe projekteve konkrete në promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Aspekti institucional përfshin trajnimet për personelin ekzistues, si dhe punësimin e mëtutjeshëm në këto agjenci, miratimi dhe implementimi i një strategjie zhvillimore të sektorit privat, si dhe një plan veprimi afatmesëm për mbështetjen e NVM-ve. Brenda kornizës së promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, aktivitetet përfshijnë: inkurajimi i shfrytëzimit të plotë të inkubatorëve të biznesit, themelimi i një sistemi efektiv për menaxhimin e të dhënave, themelimin e Parqeve të Biznesit në qytetet e vogla, implementimi i vazhdueshëm i Skemës së Konsulencës dhe Trajnimit Voucher për biznese, promovimi i ndërmarrëseve, si dhe analiza e funksionimit të bizneseve dhe ofrimi i rekomandimeve.

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiannë fushën e industrisë dhe NVM-ve, mes tjerash, MTI-ja do të bënë: Vlerësimin e konkurrencës së sektorit privat dhe futja në përdorim e mekanizmave për nxitje të investimeve; Hartimi dhe miratimi i strategjisë për eksport; Rifreskimi i bazës së të dhënave të eksportit në baza periodike; Promovimi i resurseve vendore përmes organizimit të dy konferencave ndërkombëtare me investitorët e jashtëm; Negocimi për zgjerimin e marrëveshjes për garantim të investimeve me vendet e (CEFTA) Kroaci, Mali i Zi, BdheH, Moldavi dhe Serbi, etj.

b. Bujqësia dhe peshkataria

Kosova ka rreth 1.1 milion ha sipërfaqe, prej të cilës 53% është sipërfaqe bujqësore, ndërsa 41% sipërfaqe pyjore. Bujqësia është sektori dhe aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik, i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovën e pasluftës. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla, prodhimtari të ulët dhe mungesë të shërbimeve këshilluese. Bujqësia kontribuon rreth 25% të Bruto-Prodhimit Vendor dhe përfaqëson rreth 25% deri në 30% të punësimit total, kryesisht në sektorin joformal, si dhe përbën 16% të vlerës totale të eksporteve.

Vizioni i përgjithshëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë është "të sigurohet një kontribut i baraspeshuar në ekonomi, mjedis, shoqëri dhe mirëqenie kulturore në zonat rurale të Kosovës si e tërë, përmes partneritetit efektiv dhe fitimprurës mes sektorit privat, qeverisë qendrore dhe lokale dhe komunitetet lokale brenda kontekstit evropian".

Strategjia e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është të lehtësojë ndryshimet strukturale në ekonominë rurale dhe të themeloj një kornizë ekonomike dhe mekanizma për mbështetjen e zhvillimit bujqësor dhe rural në Kosovë, ajo duhet të ndihmon krijimin e ndjenjës në mesin e popullatës rurale të Kosovës se hyrja në BE dhe proceset e integrimit kanë diçka pozitive për t'i ofruar.

Në maj 2003 është hartuar Libri i Gjelbër si dokument i parë në Kosovën e pasluftës i cili përcakton politikën dhe strategjinë e zhvillimit të bujqësisë në Kosovë. Ky dokument ka dhënë: Pasqyrën e përgjithshme të Rregullimit Makroekonomik për Bujqësi dhe Sektorin Rural (Kapitulli I), Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim të qëndrueshëm (Kapitulli II), Prioritet strategjike nën-sektoriale (Kapitulli III) dhe Resurset Njerëzore dhe Ekonomike (Kapitulli IV).

Ndërkaq, më 4 prill 2007, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor (PZHRB) 2007-2013, i cili përbëhet nga strategjitë sektoriale. Ky dokument është përgatitur nga autoritetet kombëtare kompetente, në konsultim me partnerët ekonomiko-shoqërorë dhe palët e tjera të interesuara, komunat, bizneset dhe shoqëria civile, në procesin e elaborimit të prioriteteve dhe veprimeve të përzgjedhura për zbatim në sektorin rural të Kosovës gjatë 2007-13.

PZHRB 2007-13 është diskutuar në KE dhe donatorët tjerë, i cili është konsideruar hapi i parë për Kosovën që të mësojë teknikat e planifikimit të zhvillimit në stilin e BE-së, me konsultim të ngushtë në mes niveleve të ndryshme të partnerëve qeveritar dhe social që do të ngris institucionet e nevojshme për të menaxhuar shfrytëzimin e fondeve strukturale të BE-së në të ardhmen.

PZHRB 2007-13 është përgatitur në atë mënyrë që të afrohet udhëzimeve të KE. Kosova duhet t'iu bindet rregulloreve të BE-së për të pasur qasje në fondet strukturale që do të jenë në dispozicion nën IPARD.

Kapitulli i I-rë rishqyrton kontekstin e zhvillimit agro-rural të Kosovës, analizon dallimet mes zonave rurale dhe urbane, si dhe rishikon dallimet në mes Kosovës dhe BE-se. Gjithashtu shqyrton përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet edhe veprimet e mëparshme të donatoreve dhe të tjerëve. Veprimet e hollësishme janë identifikuar në kapitullin e II-të që do t'i lejojnë Kosovës të ndërtohet në përparësitë ekzistuese, të tejkalojë dobësitë, të shfrytëzojë mundësitë dhe të zvogëlojë kërcënimet e identifikuara.

PZHRB 2007-13 identifikon objektivat e përgjithshme për zhvillimin agro-rural në Kosovë. Strategjia e përgjithshme për arritjen e objektivave te PZHRB 2007-13 është që:

1. Të ndërmerren masa që do të kapërcejnë vështirësitë që janë duke penguar zhvillimin e qëndrueshëm rural në Kosovë dhe
2. Të fillohet linjëzimi i sektorit rural të Kosovës me katër boshte të strategjisë së zhvillimit rural të BE-së të cilat janë:
    a. Boshti 1- Aftësia konkurruese.
    b. Boshti 2- Mjedisi dhe përdorimi i përmirësuar i tokës.
    c. Boshti 3- Diversifikimi rural dhe cilësia e jetës rurale.
    d. Boshti 4- Strategjitë për zhvillimin e komuniteteve të bazuara në nivel lokal.

Në aspektin e kompletimit të infrastrukturës legjislative, MBPZHR ka identifikuar legjislacionin vendor që mundëson implementimin e këtij plani zhvillimor, i cili konsiderohet të jetë i përafruar me *Acquis communautaire*.
Në fillim të vitit 2009 PZHRB është rishikuar, është plotësuar dhe përshtatur për periudhën 2009-2013.

Korniza ligjore

Rregullativa ligjore përcakton qëllimin e zbatimit të legjislacionit për fushën e Bujqësisë përkatësisht zbatimin e PZHRB 2007-13.

Njëzet e gjashtë (26) projektligje janë hartuar, prej të cilave 23 janë miratuar nga Kuvendi, si dhe janë shpallur nga PSSP-ja dhe janë dekretuar me Dekret të Presidentit, ndërsa tri janë në procedurë. Disa nga ligjet më të rëndësishme janë miratuar, ndërsa projektligjet në procedurën e shqyrtimit dhe miratimit janë:

1. Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht;
2. Projektligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural (06.11.2008);
3. Ndryshim-plotësimi i Projektligjit për Pyjet e Kosovës Nr.2003/9 është i përgatitur në Grupin punues qeveritar.

Ligjet e miratuara në Kuvend dhe të shpallura nga PSSP si dhe ato të dekretuara nga Presidenti për vitet përkatëse janë:

Ligji për Pyjet e Kosovës, Nr. 2003/3 të dt. 20 Mars 2003 - Ky ligj është miratuar me qëllim të krijimit të bazës ligjore për pyjet si resurse kombëtare dhe administrimin, mbrojtjen, ruajtjen, shtimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit të përgjithshëm pyjor të Kosovës dhe të prodhimeve të tjera pyjore jo drunore.

Ligji i Kosovës për Farëra, Nr. 2003/5 të dt. 15 Prill 2003 - Ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtimin me farëra të varieteteve bimore dhe patateve për farë në prodhimtarinë bujqësore.

Ligji për Kooperativat e Bujqve, Nr. 2003/9 të dt. 23 Qershor 2003 - Ky ligj është miratuar me qëllim të rregullimit, të themelimit dhe të punës së Kooperativave të bujqve në funksion të zhvillimit të bujqësisë dhe rritjes së produktivitetit të punës së bujqve.

Ligji për Plehrat Artificiale, Nr. 2003/10 të dt. 23 Qershor 2003 - Ky ligj është miratuar me qëllim të vendosjes së rregullave të mbrojtjes së prodhuesve e konsumatoreve të plehrave artificiale dhe sistemit rregullues të plehrave në Kosovë për të mbrojtur konsumatorin e plehrave.

Ligji për Pesticide, Nr. 2003/20 të dt. 8 Dhjetor 2003 - Ky ligj ka për qëllim rregullimin e prodhimit, importit, eksportit, shpërndarjes, shitjes dhe përdorimit të pesticideve në Kosovë.

Ligji për Materialin Fidanor Nr. 2004/13 të dt. 28 Maj 2004 - Ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin, tregtimin, importin, eksportin, kontrollin si dhe regjistrimin e prodhuesve dhe tregtuesve të materialit fidanor.

Ligji për Veterinarinë Nr. 2004/21 të dt. 30 Korrik 2004 - Me këtë ligj rregullohet luftimi dhe parandalimi i sëmundjeve infektive të kafshëve, praktika mjekësore veterinare, qarkullimi i kafshëve të gjalla, produkteve me origjine shtazore, kontrolli veterinar i importit, eksportit, kalimit transit të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të institucioneve qeveritare dhe komunale, si dhe të individëve në këtë fushë.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës Nr. 2004/29 të dt. 14 Tetor 2004 - Ky ligj është miratuar duke pasur parasysh nevojën për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës për krijimin e kushteve që ligji të gjejë zbatueshmëri të plotë dhe duke pasur parasysh ndryshimet me Kodin Penal të Kosovës.

Ligji për Blegtorinë e Kosovës Nr. 2004/33 të dt. 14 Tetor 2004 - Ky ligj ka për qëllim rregullimin e mbarështimit të kafshëve shtëpiake, tregtimin e ushqimit dhe aditivëve për kafshët shtëpiake, standardet e kualitetit sa i përket klasifikimit dhe kategorizimit të prodhimeve blegtorale të prodhuara në fermë të shitura industrisë përpunuese dhe standardeve zooteknike për rritjen e kafshëve shtëpiake.

Ligji për Përkujdesjen Ndaj Kafshëve Nr. 02/L-10 të dt. 9 Maj 2005 - Me këtë ligj rregullohet mbajtja, kujdesi, strehimi, mbarështimi, transportimi dhe çështje të tjera të lidhura me përkujdesjen ndaj kafshëve.

Ligjin për Verëra Nr. O2/L-8 të dt. 14 Tetor 2005 - Me këtë ligj rregullohet prodhimi dhe qarkullimi i rrushit për prodhimin e verës, prodhimi dhe kushtet e vënies në qarkullim të verës dhe produkteve të tjera të përpunimit të rrushit dhe verës, mbrojtja e verës së prodhuar në rajonin e caktuar gjeografik e cili dallohet me kushtet e veçanta klimatike, tokësore dhe kushteve tjera.

Ligji për Ujitjen e Tokave Bujqësore, 02L-9 të dt. 25 Nëntor 2005 - Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore për themelimin dhe funksionimin e subjekteve që afrojnë shërbimet dhe shfrytëzuesit e shërbimeve si dhe organizimin e mirëfilltë të tyre në mënyrë që të krijohen kushtet optimale për ujitjen e tokës bujqësore në Kosovë dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve të prodhimeve bujqësore.

Ligji për Tokat Bujqësore 02/L-26 të dt. 23 Qershor 2006 - Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçante dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera, përveç në rastet e paracaktuara me këtë ligj dhe me dispozitat e tjera te nxjerra në bazë të tij.

Ligji për Gjuetinë O2L-53 të dt. 11 Gusht 2006 - Me këtë ligj rregullohet menaxhimi i qëndrueshëm, kultivimi, mbrojtja, gjuetia dhe shfrytëzimi i faunës së egër si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë 02/L-85 të dt. 20 Dhjetor 2006 - Me këtë ligj rregullohet menaxhimi me resurse peshkore dhe veprimtaria e peshkatarisë dhe akuakulturës që ushtrohet me ujërat e territorit të Kosovës.

Ligji për Mbrojtjen e Bimëve 02/L-95 të dt. 31 Janar 2007 - Miratimi i këtij ligji është bërë me qëllim të rregullimit ligjor të mbrojtjes së shëndetit të bimëve, paraqitjes dhe parandalimit të përhapjes së organizmave të dëmshme në bimë.

Ligji për Bujqësinë Organike Nr.02/L-122 të dt. 8 janar 2008 - Ky ligj rregullon prodhimin e veçantë dhe të qëndrueshëm në Bujqësi dhe Pylltari, i prodhuar në pajtim me rregullat e prodhimtarisë organike të BE-së.

Ligji për Bletari Nr.02/L-111 të dt. 8 shkurt 2008 - Me këtë ligj rregullohet mbarështimi i bletëve, masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bimëve, mbikëqyrjen e *objekteve të prodhimit dhe ruajtjen e prodhimeve të bletëve.*

Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve Nr.02/L-98, dt. 16 maj 2008 - Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i procedurave për mbrojtjen e varieteteve të bimëve, shenjën dhe mbrojtjen e të drejtës së seleksionuesit të bimëve.

Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.2003/9 për kooperativat e bujqve Nr.03/L-004, dt. 3.10.2008. Shpallur me Dekretin Nr. DL.-050-2008, dt.13.10.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës - Ky ligj është miratuar duke pasur parasysh nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 2003/9 për

Kooperativat e Bujqve i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut NR>2003/21 të datës 23 qershor 2003, për krijimin e kushteve për zbatimin e tij.

Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve Nr.03/L-042, dt. 07.11.2008. Shpallur me Dekretin Nr. DL-061-2008, dt. 27.11.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës - Ky ligj është miratuar me qëllim të rregullimit ligjor të vendosjes në treg të substancave aktive, autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe qarkullimin dhe përdorimin e tyre.

Ligji për inspekcionin bujqësor Nr.03/L-029, dt. 20.11.2008. Shpallur me Dekretin Nr.DL.065-2008, dt. 13.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës - Me këtë ligj përcaktohet puna, kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit.

Ligji për ushqim Nr. 03/L-016, dt. 12 shkurt 2009. Shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. DL. 004-2009, dt. 06.03.2009 - Ky ligj është miratuar më qëllim të krijimit të bazës ligjore për rregullimin e kërkesave në fushën e ushqimit, mbrojtjes së shëndetit publik dhe përcaktimit të cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.

Për periudhën 2003-2009 janë nxjerrë gjithsejtë 156 akte nënligjore (Udhëzime Administrative) në funksion të kompletimit të rregullativës ligjore dhe implementimit sa më të plotë dhe efikas të ligjeve.

Korniza institucionale
MBPZhR është themeluar me 17 prill 2000 me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 200/27 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DABPZHR).

Mandati i Ministrisë – MBPZhR krijon politika dhe zbaton ligjet për zhvillimin e bujqësisë duke përfshirë blegtorinë, prodhimtarinë bimore, zhvillimin rural dhe vendosjen e standardeve për mirëmbajtje; krijon politika për të ndihmuar administrimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen, aktivitetet e ripyllëzimit, vetëmbajtjen, parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, dezinfektimin kundër insekteve dhe sëmundjeve të ndryshme, licencimin për prerjen e drunjve dhe kontrollimin e gjuetisë dhe peshkim; rregullon aktivitete të ndryshme në lëmin e bujqësisë; lehtëson zhvillimin e skemës kreditore për mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rural në sektorin privat; mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve veterinare, duke përfshirë ndër të tjera parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, të zoonozës dhe përmirësimin e cilësisë së kopeve dhe tufave të shpezëve si dhe ofron ndihmë në çështjet që ndërlidhen me veterinarinë, bën kontrollin fitosanitar dhe të cilësisë së shtazëve dhe produkteve shtazore që kalojnë transit nëpër vend kalimet kufitare administrative dhe shtetërore të ushqimit dhe lëndës së parë bujqësore, të bimëve dhe produkteve bimore.

MBPZHR përbëhet prej shtatë departamenteve, por këtu do të përmendim pesë të cilat janë rëndësishëm në fushën e bujqësisë dhe peshkatarisë:

Departamenti i Politikave Zhvillimore - Krijon politika dhe strategji sektoriale në funksion të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në nivel nacional dhe përcjell realizimin e tyre, raporton dhe propozon masa në funksion të përmirësimit të shkallës së implementimit dhe të mbështetjes së bujqësisë dhe fermerëve në përgjithësi.

Departamenti i Zhvillimit Rural dhe Shërbimeve Këshillimore - Menaxhon dhe mbikëqyrë të gjitha punët që janë të lidhura me Zhvillimin Rural nën koordinimin e MBPZHR gjithashtu koordinon aktivitetet e zyrtarëve të Zhvillimit Rural në zyrat fushore te Ministrisë.

Departamenti i Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve - Përgatit politikat për përmirësimin e produktivitetit në fermat bujqësore duke përvesuar sistemet e kultivimit që janë të qëndrueshme, bënë

formulimin dhe hartimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore për prodhimin e bimëve, mbrojtjen e bimëve, prodhimin dhe vendosjen në treg të farës, plehrave, pesticideve, materialit riprodhues fidanor, mbrojtjen e tokës bujqësore.

Departamenti i Blegtorisë **-** Harton politika mbështetëse të prodhimit blegtoral, krijon dhe implementon ligje dhe akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjet lidhur me blegtorinë si dhe përafrimin e tyre me ligjet dhe direktivat e BE-së.

Departamenti i Pylltarisë **-** Harton planet vjetore nga silvikultura, planet vjetore nga lëmi i prodhimtarisë së fidanëve klasike dhe industriale, programe për ngritje të pyjeve artificiale, programe për kujdesen e pyjeve natyrore.

Po ashtu, në kuadër të MBPZHR-së janë edhe institucionet si në vijim:

Agjencia e Pyjeve të Kosovës **-** është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike dhe pyjeve në Parqet Nacionale në Kosovë, përveç atyre çështjeve që ligji në mënyrë të veçantë i cakton ndonjë autoriteti tjetër të Qeverisë.

Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës **-** AVUK bënë parandalimin dhe evitimin e sëmundjeve infektive te kafshëve, kontrollimin e sigurisë së ushqimit me prejardhje shtazore, mirëqenien e kafshëve, monitorimin dhe inspektimin e qarkullimit të mbeturinave me origjinë shtazore si dhe përgjegjësi tjera.

Instituti Bujqësor i Kosovës **-** bënë mbështetjen teknike dhe shkencore për departamentet teknike të MPBZHR-së, kontrollon cilësinë e imputeve bujqësore, ushqimit dhe ruajtjes së ambientit jetësore, hulumtimin e varieteteve bujqësore në kushte agroekologjike të Kosovës.

Enti i Vertarisë dhe i Vreshtarisë **-** është themeluar në bazë Udhëzimit Administrativ MA-Nr.04/2007 dhe ka për qëllim në bashkëpunim me komunat vreshtarë mbajtjen e kadastrës dhe regjistrit të vreshtave.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropianme përmirësimin e strukturës së brendshme të MBPZHR-së synohet të qartësohen kompetencat. Në këtë kontekst, UA mbi Sistematizimin e Vendeve të Punës do të ndryshohet, si dhe do të nënshkruhet një numër Memorandumesh Mirëkuptimi me autoritetet e qeverisjes lokale për të qartësuar kompetencat mes nivelit qendror dhe atij lokal. Miratimi i Ligjit mbi Ushqimin dhe themelimi i Agjencisë gjegjëse për implementimin e tij janë gjithashtu të parashikuara (Ligji mbi Ushqimin është miratuar). Përveç themelimit të agjencisë, ky ligj do të zbatohet përmes një numri udhëzimesh, një prej të cilëve është UA mbi Organizimin e Agjencisë.

Përveç këtyre, do të hartohet një plan për modernizimin e ndërmarrjeve të prodhimit ushqimor, që do të zbatohet përmes një partneriteti të afërt me biznesin privat. Në këtë aspekt, do të ndërmerren aktivitete në ofrimin e ndihmës për këto ndërmarrje në modernizim. Në lidhje me funksionalizimin e Sistemit të Identifikimit të Kafshëve dhe Regjistrimit të Lëvizjes së Kafshëve, do të ndërmerret një fushatë mediale për vetëdijesimin e bujqve për identifikimin e kafshëve dhe sistemin e regjistrimit. Për më shumë, do të bëhet licencimi për tregjet, subjektet që merren me transportin e kafshëve, si dhe përforcimi i inspektimit të thertoreve dhe funksionalizimi i PDA-ve.

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiando të ndërmerret një reformë e qëndrueshme e tokës dhe mbrojtjes së tokës pjellore nga zhvillimi i paplanifikuar urban, përmes një projekti gjithëpërfshirës. Veprimet e parashikuara përfshijnë hartimin e një strategjie për reformën e qëndrueshme të tokës, implementimi i Ligjit mbi Tokën Bujqësore dhe ndërlidhjen e tij me ligjet tjera relevante, implementimi i UA mbi Ndryshimin e Destinimit të Tokës, riaktivizimin e disa komisioneve qeveritare dhe një numër aktivitetesh informimi.

Në lidhje me modernizimin e ndërmarrjeve bujqësore/ushqimore në pajtim me kërkesat e BE-së, do të përgatitet një program i kësaj fushe për t'u implementuar në bashkëpunim me sektorët e linjës. Në fushën e kontrollit efektiv mbi prodhimin vendor të perimeve, do të vazhdojë zbatimi i Ligjit mbi Mbrojtjen e Bimëve, bashkë me hartimin dhe implementimin e akteve nënligjore, si UA mbi Listat I /A, II/ A dhe IV/ A të bimëve dhe produkteve bimore, sipas kërkesave specifike të BE-së, mbi përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave mbi prodhuesit, përpunuesit, importuesit, shpërndarësit dhe depozituesit, etj. Gjithashtu, do të zërë vend edhe përforcimi i kapaciteteve institucionale me trajnime dhe pajisje për Institutin Bujqësor të Kosovës.
Me synim të zhvillimit të strukturës adekuate për menaxhimin e pyjeve, sidomos në luftimin e prerjeve dhe zjarreve pyjore, parashikohet hartimi dhe implementimi i një Strategjie Zhvillimore të Pyjeve të Kosovës 2009-2013, bashkë me një plan veprimi për parandalimin e zjarreve pyjore. Më tutje, kompletimi i infrastrukturës legjislative synohet të arrihet përmes hartimit të legjislacionit sekondar, themelimin e Departamenteve të Agjencisë Pyjore të Kosovës, si dhe implementimit të një plani veprimi për parandalimin e zjarreve pyjore, si dhe aktivitete tjera.

c. Mjedisi

Mbrojtja e mjedisit dhe planifikimi hapësinor, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, etj., ka ndikim direkt në zhvillimin ekonomik e social dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik. Një situatë e vështirë është trashëguar në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, mjedisit, menaxhimit dhe mbrojtjes së resurseve ujore,menaxhimit të mbeturinave, ndotjes se ajrit,ndotjes se tokës dhe humbjes se llojllojshmërisë biologjike, me shfrytëzimin e pakontrolluar të resurseve natyrore, zhvillimin e pakontrolluar të kapaciteteve industriale dhe afariste. Në gjithë këtë ndikon edhe zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve ekzistuese dhe mungesa e disa të tjerave. Qeveria do të përgatisë një kornizë ligjore, ndërsa në nivelin e implementimit, do të inkorporojë dhe zbatojë normat ndërkombëtare për adresimin e këtyre problemeve mjedisore.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, në fuqi është një kornizë legjislative e cila rregullon këtë fushë dhe përbëhet nga ky legjislacion primar si në vijim.

Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr.2003/14, 03 Korrik 2003 - ky ligj rregullon planifikimin hapësinor në terë territorin e Kosovës.

Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 03/L-106, 10 Nëntor 2008.

Ligji për Ndërtimin Nr. 2004/15, 14 Tetor2004 - ky ligj përcakton kërkesat kryesore për projektim, ndërtim, përdorim të produkteve ndërtimore, mbikëqyrjen profesionale si dhe procedurat e lejeve të ndërtimit, lejeve të përdorimit dhe inspektimin e ndërtimit.

Ligji mbi Mbrojtjen e Ajrit, Nr.2004/48, 25 Nëntor 2004 - qëllimi i ligjit është të mundësoj mjedis të shëndetshëm për popullin e Kosovës konform standardeve Evropiane.

Ligji për Ujërat e Kosovës Nr.2004/24, 14 Tetor 2004 - qëllimi i ligjit është të siguroj zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin shoqëroro-ekonomik të Kosovës, të themeloj procedurat dhe parimet udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore.

Ligji për Ruajtjen e Natyrës Nr.2006/22 , 24 Prill 2006 - ky ligj krijon bazën ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj dhe ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë.

Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike Nr. 2007/2, 09 Janar 2007. – ky ligj rregullon punët hidrometeorologjike dhe mënyrën e kryerjes së tyre.

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura , Nr. 03/L-039. 20 Shkurt 2008 - ky ligj do të sigurojë mbrojtjen e Manastireve Ortodokse Serbe, Kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për Komunitetin Serb si dhe për komunitete tjera në Republikën e Kosovës, përmes themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura.

Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 2008/15, 17 Mars 2008 - qëllimi i ligjit është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në bazë prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis.

Ligji për Kemikate, nr.2008/8, 08 Shkurt 2008 - ligji rregullon administrimin e qëndrueshëm të kemikateve, duke i përfshirë masat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut prej ndikimit të dëmshëm nga kemikatet.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 2009/03 L-025, 19. Mars 2009. ky ligj e nxjerrë nga fuqia ligjin e mëparshëm Nr. 2003/9 - qëllimi i ligjit është të promovoj themelimin e një mjedisi të shëndosh dhe të qëndrueshëm për popullatën e Kosovës në harmoni me standardet Evropiane të mjedisit.

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Nr. 2009/03 L-015, 06 Mars 2009 - ky ligj rregullon kushtet, mënyrën dhe veprimet për vlerësimin e ndikimit të disa planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Nr, 2009/ 03 L-024, 19 Mars 2009 - qëllimi i ligjit është të pengoj ose zvogëloj ndikimin negativ në mjedis nga projektet e ndryshme të propozuara.

Ligji për Mbeturina, Nr.2006/31, O5 Maj 2006 - ligji ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga ndotja nga mbeturinat, duke përfshirë edhe mbeturinat dhe materiet e rrezikshme.

Ligji për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (PKIN/IPPC), Nr o3/L-139, 2009, 23.04.2009 - qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes i cili vjen si pasojë e veprimtarive industriale, menaxhimit të mbeturinave dhe aktivitetet tjera, e në veçanti duke parandaluar dhe redukuar, emisionet në ajër, ujë dhe tokë.

Ligji për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Ndërtesave në Bashkëpronësi, Nr. 03/L-091, i aprovuar me 12.03.2009 – qëllimi i ligjit është sigurimi i autoritetit të përbashkët për mirëmbajtjen e banesave në bashkëpronësi.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse e akteve nënligjore, e cila përbëhet nga ***54 Udhëzime Administrative.***

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e mjedisit, në implementim e sipër janë dokumentet në vijim:

Strategjia për Mjedisin e Kosovës - Më 14 korrik 2004, Qeveria e Kosovës e aprovon Strategjin për Mjedisin e Kosovës e cila identifikon problemet kyçe mjedisore dhe përcakton orientimet strategjike për zgjidhjen e tyre, fillimisht me kompletimin e legjislacionit mjedisor të përafruara me standardet e BE-së, me ngritjen e institucioneve kompetente, ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis (PKVM) - Më 30 qershor 2007, Qeveria e Kosovës miratoi PKVM, i cili u hartua në pajtim me Ligjin ekzistues për Mbrojtjen e Mjedisit (LMM), si dhe sipas prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë për Mjedis. PKVM-ja përmban 52 projekte, dhe definon prioritete mjedisore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe sigurimin e qëndrueshëm të mjedisit në Kosovë i cili ndikon edhe në shëndetin e popullatës.

Korniza institucionale

MMPH si institucion përgjegjës për zhvillimin e politikave për çështjet mjedisore dhe planifikim hapësinor, ka shtatë departamente dhe një drejtori:

- Departamentin për Mbrojtjen e Mjedisit,
- Planifikimi Hapësinor,
- Banimi dhe Ndërtimi,
- Departamentin e Ujërave,
- Administrata Qendrore,
- Departamentin e Prokurimit,
- Drejtoria për Menaxhimin e Parqeve Nacionale.

Gjithashtu, kuadër përbërës të MMPH janë edhe dy Institute:

- Instituti Hidrometereologjik i Kosovës, dhe
- Instituti për Planifikim Hapësinor.

Në kuadër të MMPH-së është edhe një Agjencion dhe Inspektorati:

- Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, e themeluar në vitin 2006, dhe
- Inspektorati i MMPH-së dhe Inspektorët në nivelin lokal.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropiannë fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor parashikohet miratimi i Projektligjit mbi Programet e Banimit Social, hartimi i Planit të Veprimit për identifikimin e Vendbanimeve joformale, hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Rregullimin e Vendbanimeve Joformale. Gjithashtu, për adresimin e këtij Prioriteti do të vazhdohet me trajnimet e planifikuesve urban komunal për përfshirjen e vendbanimeve joformale në planet hapësinore urbanistike dhe do të vazhdohet me një fushatë gjithëpërfshirëse edukative për nevojën e parandalimit të vendbanimeve joformale dhe për rregullimin e tyre.

Në periudhën afatshkurtër, gjithashtu parashihet që të filloj zbatimi i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe ngritja e kapaciteteve institucionale për zbatimin e këtij ligji.

Do të vazhdohet me implementimin e Planit të Kosovës për Veprim në mjedis e që do të ketë ndikim në shëndetin publik përmes zbatimit të vazhdueshëm të Udhëzimit Administrativ për Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes, fillimin e rehabilitimit të deponive në komunat: Kaçanik, Fushë Kosovë, Prishtinë, Klinë, Gjakovë, Podujevë, Ferizaj dhe Lipjani. Do të fillon ndërtimi i impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive, krijimit të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe do plotësohet Ligji i Ujërave me UA për Hartimin e elaborateve për caktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit që përdoret për pije dhe UA për ndërmarrjen administrative për mbrojtjen e akumulimeve.

Do të vazhdohet me përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me standardet evropiane me miratimin e ligjit për produkte biocide, Ligjit për rrezatimin Jo-jonizues, Jonizues dhe Siguria Nukleare, ligjit të ri të mbrojtjes së natyrës dhe ndryshimit të Ligjit të Ujërave, hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen e ajrit, ndryshimit të dhe plotësimit të ligjit për mbrojtjen e ajrit, fillimi i zbatimit të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollën e Integruar të Ndotjes (IPPC), zhvillimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiverzitet dhe Planit Strategjik të Kosovës për Administrimin e mbeturinave. Gjithashtu do të miratohen një numër i konsiderueshëm i Udhëzimeve Administrative nga Ligji i Mbeturinave dhe ai i Kemikateve.

Do të vazhdohet me përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me standardet evropiane me miratimin e Ligjit për produkte biocide, Ligjit për rrezatimin Jojonizues, Jonizues dhe Siguria Nukleare, Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e Integruar të Ndotjes (IPPC), Ligjit të ri të mbrojtjes së natyrës dhe ndryshimit të Ligjit të Ujërave, hartimi i Strategjisë dhe planit të Veprimit për mbrojtjen e ajrit, Ndryshimit të dhe plotësimit të Ligjit për mbrojtjen e ajrit, zhvillimit të Strategjisë dhe planit të Veprimit për Biodiverzitet dhe Planit Strategjik të Kosovës për Administrimin e mbeturinave. Gjithashtu do të miratohen një numër i konsiderueshëm i Udhëzimeve administrative nga Ligji i Mbeturinave dhe ai i Kemikateve.

PVPE 2009 parashikon edhe vetëdijesimin publik dhe përfshirjen e shoqërisë civile në çështjet mjedisore, përmes veprimeve si rritja e përfshirjes së lëndëve mjedisore në planprogramet e gjitha niveleve arsimore, implementimi i Projektit rajonal "Paketa e gjelbër", mbajtja e ligjëratave për çështje mjedisore në 60 shkolla fillore të Kovës, bashkëpunimi i rregullt me OJQ-të përmes zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të MMPH dhe OJQ-ve, bashkëpunimit me pushtetin lokal, si dhe publikimi i një reviste mjedisore, në baza mujore që ka për qëllim informimin e vazhdueshëm të publikut rreth çështjeve mjedisore.

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiannë fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, për fuqizimin e planifikimit hapësinor do të ndërmirën një serë veprimesh, si prezantimi i Ligjit mbi themelimin e Zonave të veçanta të mbrojtura nëpër komunat e Kosovës, hartimi i Ligjit për qendrën historike të Prizrenit, hartimi i ligjit për Hoqën e Madhe, përgatitja e broshurës me informacione teknike për zonat e veçanta të mbrojtura, prezantimi i Ligjit për ndryshimin e ligjit për planifikim hapësinor, ndryshimi i UA për provimin profesional dhe licencim nga fusha e planifikimit hapësinor, hartimi i UA për bazën e të dhënave për planifikim hapësinor, hartimi i UA për objektet me rëndësi për Kosovën për të cilat MMPH lëshon leje urbanistike, hartimi i Planit hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr", hartimi i Planit menaxhues për Parkun Nacional "Mali Sharr", formimi i Këshillit për Planifikim Hapësinor në nivelin qendror, hartimi i normave dhe standardeve për planifikim hapësinor, hartimi i rregullave teknike të ndërtimit, krijimi i bazës të dhënave në GIS, përcaktimi i standardeve dhe normave për izolim termik, plotësimi i bazës ligjore për zbatimin e normave për kursimin e energjisë në ndërtesa. Gjithashtu do të bëhet fuqizimi i punës së Inspektoratit për planifikim Hapësinor dhe të atij për Ndërtim si dhe bashkëpunimi i Inspektoratit me Policinë, Gjykatën dhe organet tjera.

Në ndërtimin institucional dhe forcimin e kapaciteteve, duhet përmendur themelimi i njësive komunale të planifikimit, trajnimi i personelit ekzistues dhe punësimi i 20 punëtorëve të rinj në MMPH, por edhe një bashkërendim më i mirë dhe qartësim i kompetencave mes MMPH-së dhe komunave. Përfundimisht, PVPE 2009 parashikon bashkërendimin e çështjeve mjedisore me politikat sektoriale, sidomos energjinë dhe transportin. Kjo, mes tjerash, lidhet me zbatimin e Nenit 4 të Direktivës për Mbrojtjes së Zogjve të Egër 79/409/EEC, me transpozimin e saj në Ligjin e ndryshuar dhe plotësuar mbi Mbrojtjen e Natyrës, por edhe duke ngritur grupe pune ndërsektorale me synim të implementimit

dhe koordinimit të legjislacionit mjedisor me politikat tjera sektoriale. Do të bëhet identifikimi dhe shpallja e zonave IBA (Important Bird Area) dhe zbatimi i mbrojtjes së tyre. Do të bëhet edhe hartimi i Planit hapësinor për Zonën e veçantë "Fusha e Mihjës së Re".

d. Politikat e transportit

Duke marrë parasysh gjendjen e tanishme të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si dhe rëndësinë e shërbimeve të komunikimit, Qeveria e Kosovës synon të përmirësojë këtë infrastrukturë në pajtim me standardet evropiane për t'u bërë motor i zhvillimit ekonomik.

Infrastruktura rrugore është në fazën e zhvillimit. Kjo ka rëndësi të veçantë në sistemin ekonomik të Kosovës. Rreth 90 % e transportit të mallrave dhe udhëtarëve në Kosovë kryhet përmes transportit rrugor. Sipas shënimeve të MTPT-së, Kosova ka 8522 kilometra rrugë publike, pa llogaritur rrugët në qytete dhe zona rurale.

Gjatësia e rrugëve magjistrale: 647 km,
Gjatësia e rrugëve rajonale: 1304 km
Gjatësia totale e rrugëve kryesore dhe rajonale: 1951 km
Gjatësia e rrugëve lokale: 6571 km.
Urat në rrugët kryesore dhe rajonale: 354
Gjatësia e tuneleve: 2081m.

Rrugët magjistrale dhe rajonale në Kosovë janë kryesisht me dy shirita. Në segmentet rrugore rreth Prishtinës janë zhvilluar rrugë me 4 shirita dhe në vazhdim është zgjerimi i rrugëve kryesore nacionale si ajo Prishtinë- Pejë dhe Prishtinë- Mitrovicë.

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit këtë vit planifikon të fillojë realizimin e segmentit A Morinë – Prizren në gjatësi prej 20 km të autostradës 7 Morinë – Merdare si pjesë e rrjetit bazik të Evropës Juglindore. Gjithashtu gjatë këtij viti pritet përfundimi i projektit zbatues për Autostradën 6 Prishtinë - Hani i Elezit .

Tabela 1. Programet e infrastrukturës rrugore që do të realizohen në vitin 2009

Programi	Buxheti 2009	Të kontraktuara në vitin 2008	Të pakontraktuara
Mirëmbajtja e Rrugëve	8,500,000.00	2,688,000.00	5,812,000.00
Mirëmbajtja e Urave	12,000,000.00	9,864,640.00	2,135,360.00
Rehabilitimi i Rrugëve	53,241,485.00	39,328,000.00	13,913,485.00
Sinjalizimi i Rrugëve	2,500,000.00	93,341.00	2,406,659.00
Bashkëfinancimi me Komuna	11,875,000.00	9,293,182.00	2,581,818.00
Ndërtimi i Rrugëve të reja	23,300,000.00	13,342,853.00	9,957,147.00
Totali	**111,416,485.00**	**74,610,016.00**	**36,806,469.00**

Transporti rrugor është në fazën e zhvillimit të tij. Në transportin e brendshëm të udhëtarëve pothuajse 35% të qytetarëve shfrytëzojnë transportin publik me autobus për të lëvizur nga një qytet në një qytet tjetër, ndërsa transporti i mallrave mbi 90% ushtrohet si transport rrugorë si dhe në një masë më të vogël përmes hekurudhës.

Në transportin ndërkombëtarë të udhëtarëve janë të vendosura linjat e rregullta ditore me të gjitha vendet në rajon, si dhe ato dhe javore pothuajse me të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore në të cilat jetojnë dhe veprojnë qytetarët nga Kosova.

Pothuajse mbi 90% të transportit publik të udhëtarëve dhe 100% të transportit rrugorë të mallrave dhe mallrave të rrezikshme ushtrohet mbi baza komerciale dhe nga operatorët privat.

Për nevoja të komuniteteve në vendbanime të caktuara dhe me qëllim të sigurimit të lëvizjes së qytetarëve MTPT ka siguruar shërbimet e veçanta të transportit me autobus dhe tren duke subvencionuar transportin në 25 relacione me mbi 50.000 km/muaj për autobus si dhe qarkullimin e përditshëm të trenit duke ndarë kështu mbi 2.5 milion € në vit.

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës dhe kanë një rrjet me gjatësi prej 333 km linjë e hapur hekurudhore, 106 km në stacione dhe 103 km vijë industriale të shtrira gati në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga ky rrjet, për shkak të dëmtimeve të mëdha dhe pamundësisë së investimeve, aktualisht janë jashtë funksionit linja hekurudhore lindore Bardhosh – Podujevë – kufiri me Serbinë dhe linja jug perëndimore Xërxë – Prizren. Është me rëndësi të përmendët se linja kryesore hekurudhore (e njohur në korridoret Pan Evropiane si Linja e dhjetë hekurudhore), ka lidhje direkte me shtetet fqinje; përmes Leshakut me Serbinë dhe përmes Hanit të Elezit me Maqedoninë.

Kompania e Hekurudhave të Kosovës pretendon të jetë organizatë dinamike dhe e qëndrueshme që ndihmon në shtyrjen përpara të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës duke plotësuar nevojat e tregut me anë të transportit të sigurt e konkurrues të udhëtarëve dhe mallrave. Për transportin e udhëtarëve janë në funksion treni Prishtinë – Shkup, Treni i Pejës dhe Treni i Lëvizjes së Lirë. Subvencionimi nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës mbulon humbjet për operimin të transportit të udhëtarëve dhe krijon mundësinë që këta trena të jenë funksional. Kurse krijimi i të hyrave për mbulimin e shpenzimeve operative të Hekurudhave të Kosovës mundësohet nga transportimi i mallrave si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Kosovës. Në vitin 2008 janë transportuar 832.256 neto ton mallra, gjë që krahasuar me vitin 2007 kemi një rritje prej 243.576 neto tonësh, apo llogaritur në përqindje 41.4% më shumë. Në pronësinë e tyre Kompania e Hekurudhave ka 4 lokomotiva të llojit Di3, 4 lokomotiva të tipit 661, pastaj 4 trena motorik, 1 lokomotivë të re G1700, 10 vagonë udhëtarësh, 70 vagonë mallrash, dhe dy lokomotiva manovruese të reja.

Transporti ajror ka shënuar përparim në Republikën e Kosovës. Kosova është anëtare e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) me të drejta të plota, qysh prej 2006-ës, kur shtetet anëtare të BE-së nënshkruan Marrëveshjen e ECAA-s me vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo Marrëveshje obligon Kosovën që të pasqyrojë gjithë legjislacionin evropian mbi aviacionin civil në legjislacionin vendor.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) vazhdon më avancim në aspektin teknik dhe të sigurisë, ndërsa MTPT-ja planifikon të ndihmojë në këtë drejtim. Aeroporti gjatë vitit 2008 ka arritur numër rekord të udhëtarëve, me gjithsej mbi 1.200.000 udhëtarë janë pranuar dhe përcjellur. Më 2009, gjatë periudhës janar-mars në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i fluturimeve dhe udhëtarëve është rritur për rreth 15%.

Korniza ligjore

Sa i përket fushës së transportit është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative e cila rregullon sektorin e transportit. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- *Ligji mbi Rrugët, nr. 2003/11* **-** Me këtë ligj rregullohet pozita juridike e rrugëve publike, ndërtimi, mirëmbajtja e rrugëve, masat mbrojtëse, qeverisja, financimi dhe mbikëqyrja e rrugëve publike;

- *Ligji për Transporin Rrugor nr. 2004/1 dhe Ligji nr. 02L/127 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Transportin Rrugor nr. 2004/1* **-** Me këtë ligj rregullohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave;
- *Ligji për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, nr. 2004/6* **–** Me anë të këtij ligji synohet të parandalohet rreziku dhe të shtohet mbikëqyrja dhe sigurimi i komunikacionit gjatë transportit të mallrave të rrezikshme të cilat me vetit vetëndezëse, helmuese, shpërthyese, avulluese, infektuese dhe radioaktive paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit, ky ligj gjithashtu rregullon kushtet për transportin e mallrave të rrezikshme në sektorin individual të transporti, obligimet e personave të përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme, kompetencat dhe përgjegjësit e autoriteteve përkatëse rreth mbikëqyrjes lidhur me zbatimin e këtij ligji;
- *Ligji për Sigurinë në Komunikacion Rrugor, nr. 02/L-70* – Ky ligj përcakton parimet dhe kushtet me të cilat rregullohet sektori i sigurisë në rrugë, i cili është i harmonizuar me përvojat më të mira ndërkombëtare;
- *Ligji për Aviacion Civil, nr. 03/L-051* **–** bënë rregullimin teknik dhe ekonomik dhe promovimin e aviacionit civil në Kosovë si dhe nxitjen e zhvillimit të sigurt të kësaj fushe në përputhje me normat ndërkombëtare.
- *Ligji për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-076* **–** Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së sajë dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e transportit, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, e cila përbëhet nga ***36 Udhëzime Administrative.***

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e transportit, në implementim e sipër janë dokumentet në vijim:

1. *Strategjia e Transportit Multi-Modal dhe Plani i Veprimit* - ka për qëllim që të forcoj kapacitetin e planifikimit të transportit multi-modal të MTPT-së, si dhe përgatitjen e një Strategji dhe Politike gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit të transportit në Kosovë deri më 2025, duke përfshirë këtu një Plan Veprues prioritar,i cili do të mbuloj infrastrukturën rrugore, transportin rrugor, transportin urban dhe hekurudhor.

Korniza institucionale
Përgjegjësit e MTPT-së ushtrohen në bazë të Kushtetutës së Kosovës, Rregullores 2001/19 dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Ministria krijon politika dhe implementon ligje për sigurimin e shërbimeve dhe objekteve në sektorët e infrastrukturës rrugore, transporti rrugor, hekurudhor dhe ajror si dhe të postë-telekomunikacionit dhe teknologjisë informative.

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit si institucion përgjegjës në çështjet e transportit në përbërje të vet ka katër departamente në këtë fushë dhe atë:

1. Departamenti i Infrastrukturës rrugore;
2. Departamenti i Transportit Rrugorë;
3. Departamenti i Hekurudhave dhe Aviacionit Civil;
4. Departamenti i Automjeteve.

Sektori i infrastrukturës rrugore zhvillon programe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, si dhe siguron financimin dhe organizon dhënien e koncesioneve sipas nevojës. Mbikëqyrë financimin dhe menaxhimin e infrastrukturës, duke përfshirë edhe kryerjen e punëve teknike, organizative dhe

zhvillimore përkitazi me ndërtimin, pastaj bënë mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike si dhe kontrollon gjendjen e rrugëve, mirëmban dokumentacionin për rrugët publike dhe trafikun rrugor.

Sektori i transportit rrugor për personave dhe mallra mbikëqyrë procedurat e licencimit të ndërmarrjeve, automjeteve dhe shoferëve. Jep autorizime operative (itinerarin dhe intervalin kohor) në bazë të konkurrencës dhe mbështet sigurimin e shërbimeve humanitare dhe shërbimeve tjera speciale si dhe mbikëqyr sigurinë e transportit, duke përfshirë këtu ndërmarrjen e aksioneve dhe hetimeve të nevojshme s që rreziku për jetë dhe dëmet tjera të jenë sa më të vogla.

Sektori i shërbimeve të transportit hekurudhor dhe ajror merret më krijimin e legjislacionin dhe politikat sektoriale, përkujdeset për të siguruar dhe promovuar transport të besueshëm për të gjithë shfrytëzuesit. Në sektorin e aviacionit civil bën rregullimin ekonomik dhe promovon aviacionin civil, bën nxitjen dhe zhvillimin e sigurt të kësaj fushe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil që është themeluar ne bazë te Ligjit te Aviacionit Civil ka plotësuar dhe është duke i plotësuar një numër obligimesh sipas kërkesës së ECAA-s.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e transportit, do të synojmë krijimin e një Autoriti Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës me pavarësi operacionale dhe financiare, themelimin e një bordiMbikëqyrës për ARAC-në, si dhe implementimin e plotë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe Ligjit të KE-së mbi Aviacionin, analizimin dhe identifikimin e kundërthënieve të mundshme në mes të Ligjit mbi Telekomunikacionin dhe Ligjin mbi Financat Publike si dhe hartimin dhe miratimin e amendamenteve të Ligjit mbi Telekomunikacionin.

Në fushën e infrastrukturës të vazhdohet me pjesëmarrje në zbatimin e MeM (SEETO) në të gjitha nivelet, përmes Takimeve të Ministrave, Komitetit Drejtues, Koordinatorëve Kombëtar dhe Grupet Punuese, implementimi i segmenteve për drejtimin rrugore 6 (kompletimi i projektit zbatues) si dhe kompletimi i projektit zbatues dhe fillimi i punimeve ne segmentin A te drejtimit rrugor 7, të vazhdohet me përgatitjet e duhura rreth projekteve prioritare të identifikuara për drejtimet rrugore 6 dhe 7, linjën hekurudhore 10 dhe Aeroportin Ndërkombëtar te Prishtinës.

Në sektorin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave të bëhet hartimi i planit shumë vjeçar i veprimit për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, si dhe miratimi i këtij plani, përgatitja e kornizës për zbatimin e planit shumë vjeçar të veprimit për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, të vazhdohet me konkludimin e marrëveshjeve bilaterale mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave me vendet fqinje dhe të tjera, përgatitja e legjislacionit mbi Marrëveshjen Evropiane, që ka të bëjë me punën e ekuipazheve të automjeteve të angazhuara në Transportin Ndërkombëtar Rrugor (AETR), të iniciohen aktivitetet trajnuese për përgatitjet dhe implementimin e tapografit digjital, të bëhet harmonizimi i planeve lokale të transportit për planifikimin e transportit në nivel qendror, të vazhdohet me përmirësimin e kualitetit të rrjetit ekzistues të transportit rrugor ndër-urban me qëllim që të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm për biznesin si dhe me adekuat për shfrytëzuesit, të iniciohet pjesëmarrje në iniciativat rajonale që forcojnë lehtësimin e tregtisë dhe të transportit si dhe të vazhdohet anëtarësimi ne baze vjetore në Unionin Ndërkombëtar të Transportit Publik (UITP).

Sa i përket sigurisë rrugore, do të bëhet hartimi dhe miratimi i planit shumëvjeçare mbi sigurinë rrugore dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ mbi Auditimin e Sigurisë Rrugore, futjen në përdorim të proceseve adekuate, si dhe marrja pjesë në aktivitetin e SEETO-së mbi Auditimin e Sigurisë Rrugore.

Strategjia për transport multimodal dhe Plani i Veprimit ndërsektorial për transport multimodal tash më ka përfunduar dhe është dorëzuar nga ana e ekspertve relevant dhe jemi në fazat finale të diskutimit të këtij plani strategjik, i cili mundëson planifikimin dhe zhvillimin afat gjatë të sektorit të transportit deri në vitin 2025. Andaj, për këtë fushë duhet të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve institucionale për planifikimin e transportit multimodal, të vazhdohet me përmirësimin e bazave të të dhënave të informatave rrugore dhe të bëhet vlerësimi ekonomik i projektpropozimeve si instrumente për programim dhe buxhetim të programit për menaxhim të aseteve rrugore.

Në sektorin e infrastrukturës rrugore të bëhet përgatitja dhe miratimi i sistemit të kontraktimit shumë vjeçar bazuar në performancë për mirëmbajtjen rrugore verore dhe dimërore, rikategorizimi i rrjetit ekzistues rrugor, si dhe të fillohet me një projekt ne sektorin e transport për PPP-të.

Në sektorin hekurudhor të bëhet hartimi i strategjisë zhvillimore mbi hekurudhat, e cila mes tjerash siguron përputhshmëri me strategjinë e zhvillimit ekonomik, themelimi i trupave tjerë rregullatorë mbi hekurudhat, të behet hapja e tregut vendor për operatoret tjerë hekurudhore, të behet anëtarësimi në Unionin Ndërkombëtar të Hekurudhave si dhe përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve te operimit ne drejtim te zhvillimit te sigurt te transportit hekurudhore.

Sa i përket Aviacionit, të bëhet implementimi i planit të cilësisë dhe kualitetit dhe menaxhimi i sistemit te sigurisë, miratimi i anëtarëve të Bordit të Autoritetit të Aviacionit Civil, sistemi i mbulueshmerise se Radio Komunikimeve, të përpilohet baza adekuate ligjore në bazë të së cilës do të bëhet përzgjedhja, struktura dhe përgjegjësia e organeve drejtuese (menagjuëse në ANP), të vazhdohet me zbatimin e dispozitave që dalin nga Marrëveshja e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), rishtresimi i pistës, zgjerimi i parkingut dhe hapësirës së nevojshme për manovrimin e avionëve [taxiëay], pastaj ndërtimi i rrugës perimetrike dhe ndriçimi aeroportual i fushës ajrore, drenazhimi i ujërave brenda hapësirës së aeroportit, shpronësimi i tokës për nevojat e ANP, implementimi i planit trajnues për përmbushjen e kërkesave te certifikimit dhe licencave, si dhe ndërtimi i pirgut te ri kontrollues dhe ndërtesës se Administratës.

Në sektorin e automjeteve të bëhet përmirësimi i mënyrës së testimit të kandidatëve sipas rekomandimeve te CIECA, licencimi dhe rilicencimi i pyetësve (egzaminerëve) si dhe aftësimi permanent i tyre, zbatimi i kornizës legjislative për kontrollim të reduktimit të gazrave ndotësve të liruara nga automjetet, si dhe licencimi dhe rilicencimi i inspektuesve të automjeteve.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e transportit, do të synojmë vlerësimin dhe analizimin e zbatimit te ligjit mbi sigurinë rrugore, hartimin e strategjisë për rritjen e sigurisë rrugore, pastaj zbatimin e programit te mirëmbajtjes dhe rehabilitimit te rrjetit rrugor te Kosovës, zbatimin e projekteve strategjike për drejtimet rrugore 6 dhe 7 si dhe zbatimin e strategjisë të transportit multimodal.

e. Energjia

Sektori i energjisë konsiderohet sektor kyç që përbën bazën dhe shtyllën kryesore të zhvillimit të gjithëmbarshëm ekonomik dhe shoqëror të Kosovës.

Sistemi i energjisë elektrike përbëhet nga dy miniera sipërfaqësore të linjitit në Bardh dhe Mirash, termocentralet Kosova A dhe Kosova B, rrjeti i transmisionit dhe dispeçingu, rrjeti i shpërndarjes dhe furnizimit. Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar elektro energjetik në termocentralet është 1478 MË, ndërsa operativ vlerësohet në 930 MË. Gjithashtu ekzistojnë tri hidrocentrale – ai i Ujmanit me kapacitet të instaluar 32 MË (2x16 MË), ai i Lumëbardhit me kapacitet të instaluar prej 8.3 MË, dhe ai i Radavcit

me kapacitet te instaluar (1x0.17 MË + 0.18 MË) 0.35 MË. Kapaciteti total elektrogjenerues i instaluar ne Kosove eshte 1,524 MË.

Ne TC Kosova A, blloqet A_1, A_2 janë jashtë funksionit ndërsa është bërë riparimi (remonti) i bllokut A3 në 2006, A4 në 2007 dhe bllokut A5 në vitin 2008. dhe ato tani janë në funksion.

Sektori elektroenergjetik në Kosovë dominohet nga kompania e gjenerimit të energjisë, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a), është një sistem pothuajse vertikalisht i integruar. Përveç rrjetit te transmetimit dhe dispeçingut dhe dy hidrocentraleve te Ujmanit dhe Lumëbardhit, te gjitha asetet e tjera te përmendura me sipër janë ne pronësi te KEK-ut sh.a.

Furnizimi i qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike paraqet element kyç për joshjen e investimeve private të huaja dhe vendore, investime këto që janë vlerësuar të jenë promotori kryesor i zhvillimit te ardhshëm ekonomik të vendit tonë. Potenciali zhvillimor i sektorit të energjisë elektrike kryesisht bazohet në rezervat e pasura të linjitit për gjenerimin e energjisë elektrike, të cilat vlerësohet të jenë në rreth 11.5 – 14 miliard tonelata. Eksploatimi i rezervave të linjitit dhe gjenerimi i energjisë elektrike kanë potencial të shndërrohen në burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të të hyrave buxhetore, si dhe të sigurojnë furnizim të mjaftueshëm dhe cilësor të tregut të brendshëm te energjisë elektrike. Synime te tjera janë edhe eksporti i energjisë elektrike dhe integrimi i plotë rajonal Evropian i sistemit elektroenergjetik te Kosovës.

Sektori i ngrohjes qendrore është mjaft i limituar dhe plotëson rreth 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje. Ai përbëhet nga tri sisteme të ngrohjes qendrore: ai i Prishtinës me kapacitet të instaluar prej 159 MË, i Gjakovës me kapacitet të instaluar 38 MË, dhe i Mitrovicës me kapacitet të instaluar prej 17 MË.

Sektori i energjisë duhet të zhvillohet dhe transformohet nga një sektor që varet nga subvencionet buxhetore dhe donacionet e jashtme në një sektor që do t'i kontribuoj Buxhetit të Kosovës. Ky sektor në Kosovë duhet te arrije te behet i vetëqëndrueshëm financiarisht dhe te ofroje shërbime energjetike te standardeve Evropiane. Kjo do te arrihet nëpërmjet reformimit, ristrukturimit dhe investimeve kryesisht private. Objektivi kryesor strategjik i këtij sektori është qe ai te arrije t'i kontribuoj zhvillimit ekonomik përmes furnizimit të mjaftueshëm dhe cilësor me energji me çmime konkurruese, duke u kujdesur për shfrytëzim racional dhe efektiv të burimeve vendore të linjitit dhe burimeve tjera energjetike, duke mbrojtur njeheresh edhe mjedisin.

Kosova është nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (TKE), i cili ka hyrë në fuqi në Qershor 2006. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës është e angazhuar substancialisht për të zhvilluar sektorin e energjisë në përputhje me kërkesat e TKE. Ky traktat mandaton implementimin e '*Acquis Communnitaire*' nga ana e secilës palë nënshkruese, sipas një kalendari për zbatim të reformave të kërkuara. Republika e Kosovës po zbaton ne vazhdimësi dhe në përputhje me planet dhe afatet kohore te përcaktuara, obligimet qe dalin nga TKE.

Integrimi i sektorit elektroenergjetik te Kosovës ne sistemin Evropian do te arrihet duke zbatuar *aquis* te BE-se për energji, mjedis dhe konkurrencë. Ky proces integrues po realizohet kryesisht ne kuadër te Traktatit per Komunitetin e Energjisë ku Kosova është palë kontraktuese.

Përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe që të mbështesë shfrytëzimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe përmirësimin e Efiçiencës së Energjisë (EE). Plani i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë (PKEE) eshte instrumenti kryesor qe po zbatohet ne vazhdimësi për të mundësuar arritjen e objektivave dhe caqeve indikative konkrete te vendosura (ne përputhje edhe me

kërkesat e direktivave relevante te BE-se) për EE dhe BRE në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe atë afatgjatë.

Në kontekstin e themelimit të kushteve për tregun e energjisë në rajon, Operatorët e Sistemit të Transmisionit (TSO) të Evropës Juglindore (EJL), nën bashkërendimin e Operatorëve Evropianë të Sistemeve të Transmisionit (ETSO) në korrik 2005 kanë implementuar sistemin e kompensimit brenda TSO-ve të EJL-së, duke synuar kompensimin e shfrytëzimit të sistemeve shtetërore të Transmisionit përmes Tregtisë Ndërkufitare (CBT) në Evropën Juglindore. Përveç kësaj, procesi për implementimin e aktiviteteve të koordinuara për kapacitete interkonektimi është në vazhdim, mekanizmi i tregtisë ndërkufitare, janë çështje që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme në afat të shkurtër, me synim pjesëmarrjen e Kosovës në këto. Ne kuadër te TKE-se, sektori i energjisë elektrike i Kosovës eshte i angazhohet plotësisht drejt krijimit dhe funksionalizimit te Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike të EJL-së te hapur dhe transparent sipas kërkesave te aquis te BE-se.

Sistemi elektroenergjetik i Kosovës ka linja direkte interkoneksioni me Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Maqedoninë. Përveç Serbisë, gjithë këta sisteme janë importues neto të energjisë elektrike. Ky fakt paraqet mundësi për investime në termocentrale të reja me linjit në Kosovë.

Legjislacioni ne fuqi, ne përputhje me *aquis* te BE-se, përcakton rolet dhe përgjegjësitë për rregullimin dhe qeverisjen e industrisë së energjisë, prej Kuvendit, Qeverisë, Zyrës se Rregullatorit të Energjisë, prodhuesve dhe furnizuesve publikë dhe operatorit të sistemit të Bartjes.

Resurset kryesore të linjitit në Kosovë gjenden në dy bazene të mëdha të linjitit, të quajtura "Kosova" dhe "Dukagjini", me rezerva linjiti të shfrytëzueshme me cilësi të mirë. Sasia e vlerësuar e linjitit është mes 11.55 - 14 miliardë tonë. Rezervat e linjitit kanë përmbajtje të ultë të sulfurit, koncentrim relativisht të mirë të gëlqeres (oksid i kalciumit) për thithje të pjesshme të sulfurit gjatë djegies. Proporcioni mes djerrinës dhe linjitit është shumë i favorshëm, fakt që i bën minierat shumë atraktive për eksploatim.

Korniza ligjore

Ligjet dhe rregulloret në vijim përbëjnë kornizën menaxhuese të sektorit të energjisë në Kosovë:

- Ligji për Energjinë 2004/8;
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë 2004/9;
- Ligji për Energjinë Elektrike 2004/10;
- Ligji për Planifikimin Hapësinor (2003/4);
- Rregullorja e UNMIK-ut 2005/15, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19, për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes në Kosovë
- Ligji për Minierat dhe Mineralet (draft);
- Rregullorja për Minierat dhe Mineralet 2005/3;
- Rregullorja për Themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale 2005/3;
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9;
- Ligji për Tregtimin e Naftës dhe Produkteve të Naftës 2004/5;
- Ligji për Aktivitetet e kërkimit shkencor 2004/42;
- Rregullorja për shfrytëzimin afatgjatë të pronave shoqërore të menaxhuara nga Komunat në Kosovë 2005/13;
- Vendimet qeveritare për ristrukturimin e KEK-ut ;
- Ligji për Investimet e Huaja 2005/02-L33;
- Ligji për Gazin Natyror (i aprovuar ne parim);
- Ligji për Nderrmarrjet Publike Nr. 03/L-087;
- Ligji për Ngrohjen Qendrore Nr.03/L-116.

Ligjet e mësipërme janë në pajtim me Direktivat Evropiane Kërkesat e TKE, për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike dhe Gazit.

Baza ekzistuese ligjore e fushës së efiçiencë të energjisë është plotësuar me një sërë aktesh nënligjore nga MEM, në formë të udhëzimeve administrative:

- Disa UA për hapjen graduale te tregut te energjisë elektrike (2006, 2007, 2008, dhe 2009),
- UA për Etiketimin e Pajisjeve Elektroshtëpiake,
- UA për Auditimin e Energjisë,
- UA për Shfrytëzimin efiçient të Energjisë nga Konsumatorët Përfundimtarë,
- UA për Caqet Indikative vjetore dhe Dhjetëvjeçare për BRE,
- Vendimi Qeveritar për Masat Nxitëse për Zhvillimin e BRE.

Legjislacioni Sekondar i nxjerr nga Zyra Rregullatore e Energjisë, përbëhët nga:

- Rregulla mbi parimet e llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike (15.12.2005)
- Metodologjia e tarifave për sektorin e energjisë elektrike (15.12.2005; rifreskuar me 16.01.2007)
- Pasqyra e taksave (17.01.2006)
- Rregulla mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë (17 .01.2006)
- Rregulla për licencimin e aktiviteteve të energjisë në kosovë (24.02.2006)
- Rregulla mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë (24.02.2006)
- Rregulla mbi regjistrin publik (09.06.2006)
- Rregulla mbi kushtet e përgjithshme për furnizim me energji (28.06.2006)
- Procedura për menaxhimin e kodeve teknike/operacionale-KQKO, (29.01.2007)
- Rregulla mbi informatat konfidenciale (04.01.2008)
- Rregulla mbi masat administrative dhe gjobat (04.11.2008)
- Rregulla mbi procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte (04.11.2008).

Korniza institucionale

Institucionet kryesore përfshijnë MEM, ZRrE, dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) - është përgjegjëse për krijimin e politikave të energjisë dhe marrjen e vendimeve për sektorin e energjisë, të cilat promovojnë reformat e tregut dhe qeverisjen e mirë. Ministria ka krijuar parakushte organizative dhe institucionale për të realizuar këto kompetenca.

Misioni i MEM-it është t'i kontribuojë zhvillimit të standardeve të jetës dhe mirëqenies kombëtare duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të industrive energjetike, të mihjeve dhe mineraleve në Kosovë duke siguruar eksploatim efikas dhe efektiv të resurseve energjetike dhe minerale.

MEM ka adoptuar një vizion strategjik afatgjatë për sektorët e energjisë dhe minierave në Kosovë. MEM është duke zbatuar reforma të orientuara drejt tregut dhe po koordinon ristrukturimin e sektorëve të energjisë dhe minierave, në mënyrë që t'i përgatisë ato për tërheqjen e investimeve shumë të nevojshme private përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues për arritjen e partneriteteve publike-private. Zhvillimi i tregut konkurrues i energjisë, në pajtim me *acquis* të BE-së dhe Traktatin për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, përmes të cilit mund te ofrohen shërbime energjetike të cilësisë së lartë, me teknologji që nuk dëmtojnë mjedisin dhe me kosto të ulët, paraqet të vetmen rrugë drejt zhvillimit të qëndrueshëm për vendin tonë.

Synimet strategjike perfshijne:

- Zhvillmin dhe implementimin e politikave, strategjive dhe kornizave ligjore për reformimin dhe ristrukturimin e sektorit të energjisë në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së;

- Promovimin dhe dhe përkrahjen e zhvillimit të një tregu konkurrues energjetik, i cili do të integrohet në tregun e energjisë të BE-së në të ardhmen;
- Promovimin e restaurimit për qëndrueshmëri financiare te ndërmarrjeve energjetike;
- Arritjen e sigurmit në furnizim me energji për konsumatorët me kosto sa më të ulët dhe në mënyrë sa më të padëmshme për mjedisin;
- Inkurajimin, hulumtimin dhe zhvillimin e rezervave të reja të linjitit dhe minieraleve te tjera;
- Zhvillmin dhe implementimin e politikave, strategjive dhe kornizave ligjore për sektorin minerar
- Promovimin e investimeve private në sektorët e energjisë dhe minierave në formë të partneriteteve publiko-private

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) - Zyra e Rregullatorit për Energji është institucion përgjegjës për themelimin, promovimin dhe mbrojtjen e tregut të lirë dhe konkurrues të energjisë që bazohet në parime objektive, transparente dhe jo-diskriminuese; përbehet nga katër departamente, Grupi teknik këshillëdhënës dhe Zyrës administrative me përgjegjësitë si në vijim:

- Departamenti Ligjor dhe i Licencimit - merret me mbështetje ligjore sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, për të gjitha çështjet në sektorin e energjisë, si dhe me zhvillimin e të gjitha formave të licencave, aplikacioneve të ndryshme dhe procedurave për licencim dhe për autorizim. Departamenti Ligjor dhe i Licencimit është përgjegjës edhe për mbikëqyrjen/monitorimin e aktiviteteve të licencuara.
- Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve - merret me ankesat e konsumatorëve dhe me kontestet ndërmjet organizatave energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, ky departament bashkëpunon me të gjitha organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.
- Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve - merret me tarifat e energjisë në përgjithësi, analizon dhe përcakton për vendimmarrje sistemet tarifore, strukturat dhe nivelet tarifore të propozuara nga organizatat energjetike. Ky element është përgjegjës për implementimin e elementeve të reja të konkurrencës në treg.
- Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut - mbledh dhe analizon informatat lidhur me kapacitetin dhe bilancin e energjisë. Analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm si: inflacioni, çmimi i lëndës djegëse, zhvlerësimi etj., në çmimin e tregut dhe në çmimin e rregulluar të konsumatorit fundor. Ky departament bën edhe monitorimin e çmimeve të tregut.
- Grupi teknik këshillëdhënës - Grupi teknik këshillëdhënës i ofron këshilla teknike Bordit të ZRRE-së dhe departamenteve, për t'i përmbushur funksionet e tyre në pajtueshmëri me ligjin.
- Zyra administrative - Zyra administrative ofron përkrahje administrative për të gjitha departamentet e tjera të ZRRE-së, po ashtu dhe të Bordit, për një funksionim normal të Zyrës.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) - është themeluar në janar të vitit 2005 përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 – dhe përfaqëson Agjencinë e Pavarur Rregullatore për sektorin e minierave. KPMM është përgjegjës për lëshimin e licencave për hulumtim dhe shfrytëzim të minerale, përfshirë linjitin. Ai gjithashtu është përgjegjës për mbikëqyrjen e licencave të lëshuara.

Organet e tjera të qeverisë, siç janë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të industrisë së energjisë.

Republika e Kosovës është pronare e ndërmarrjeve publike në Kosovë, duke përfshirë edhe ato energjetike, kurse të drejtat pronësore mbi NP-të Qeveria i ushtron nëpërmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

Ndërmarrjet energjetike
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.) - është kompani publike e Kosovës e cila ka në pronë dhe operon me asete të gjenerimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të mihjes së linjitit. Performanca operative dhe financiare e saj gjatë periudhës 1999-2004 ishte negative. KEK sh.a. është menaxhuar nga kompani të huaja që nga shtatori i vitit 2002 deri në Dhjetor 2006. Nga Janari i vitit 2007 është vazhduar me asistencë teknike, po ashtu nga një kompani e huaj. Megjithatë, këto ndihma teknike, së bashku me menaxhmentin vendor nuk kanë arritur akoma ta bëjnë KEK-un financiarisht të qëndrueshëm.

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT sh.a.) u themelua në vitin 2006, në pajtim me dispozitat mbi shthurjen të Ligjit mbi Energjinë dhe kushtet e Traktatit për Komunitetin e Energjisë. KOSTT sh.a. është kompani në pronë publike, përgjegjëse për operimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të bartjes dhe ndërlidhjet e tij me sistemet energjetike fqinje, në mënyrë që të ruaj sigurinë në furnizim në Kosovë. Përveç kësaj, KOSTT sh.a. është përgjegjës për funksionimin dhe operimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë. Burimi kryesor i të ardhurave për KOSTT sh.a. vjen në formën e pagesave për bartje që paguhen nga KEK sh.a. sipas përcaktimit të ZRrE.

Kompanitë e ngrohjes qendrore ekzistojnë në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Në total ato gjenerojnë nxehtësi për ngrohje në vlerë prej 130 $GËh_{th}$/vit, apo rreth 3% të kërkesës së Kosovës për ngrohje. Stabilimentet e ngrohjes qendrore furnizojnë pjesët më të dendura të qyteteve dhe objekteve publike, siç janë spitalet, shkollat dhe ndërtesat administrative. Sistemi i ngrohtores së Prishtinës përbën më shumë se 80% të tërë kapacitetit të ngrohtoreve në Kosovë. Kjo ngrohtore udhëhiqet nga Termokos sh.a., një ndërmarrje lokale që ofron shërbime publike. Të tri këto sisteme ballafoqehen më humbje të mëdha komerciale.

Prioritetet afatshkurtra
Ne periudhën afatshkurtër, me qëllim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e energjisë, MEM-i dhe palët tjera relevante, mes tjerash, do të fokusohen në:

- Përgatitjen e pakos tenderuese për termocentralin Kosova e Re;
- Përfundimin e procesit të shthurjes (ristrukturimit) së KEK sh.a. dhe përgatitjen për privatizimin e shërbimeve te shpërndarjes dhe furnizimit te energjise elektrike;
- Rritjen e faturimit dhe inkasimit;
- Miratimin e ligjeve te amendamentuara dhe plotësimin e sektorit me legjislacion tjetër te nevojshëm, si dhe krijimin e parakushteve për investime private ne sektorin energjetik;
- Rritjen e kapaciteteve për prodhimin e linjitit për termocentralet ekzistuese si dhe përgatitjet për hapjen e minierës se re Sibovci jugperëndim;
- Mirëmbajtjen dhe operimin normal te TC-ve ekzistuese;
- Përgatitja për fillimin e koncesionimit te hidrocentraleve te vogla dhe riparimin e e tyre përmes investimeve private;
- Bashkëpunimin me te gjitha shtetet e rajonit duke qene pjese aktive ne kuadër te TKE-së;

- Rritjen e vetëdijes mbi përfitimin e shfrytëzimit racional të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve alternative të energjisë;
- Promovimin e shfrytëzimit te energjisë diellore përmes pilot projekteve; dhe
- Hapjen e plotë të tregut të energjisë elektrike për konsumatoret jo-amvisnor.

Prioritetet afatmesme
Ne periudhën afatmesme, me qëllim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e energjisë, MEM-i dhe palët tjera, mes tjerash, do të fokusohen kryesisht në:

- Vazhdimin sipas planit për ndërtimin e kapacitetit te ri gjenerues TC Kosova e Re;
- Hapjen e minierës se re Sibovci Jugperëndimor;
- Përgatitjet per revitalizimin e blloqeve te TC Kosova B;
- Ndërtimin i hidrocentralit te Zhurit dhe nje numri te HC-ve te vogla te reja;
- Privatizimin e distribucionit dhe furnizimit;
- Ndertimin e linjes 400 kV me Shqiperin;
- Ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110kV - Peja 3 bashkë me linjat ndërlidhëse; dhe
- Sanimin e pasojave mjedisore te shkaktuar nga KEK sh.a..

Në lidhje me përmirësimin e mëtutjeshëm të performancës së shërbimit dhe integrimit me tregun rajonal elektrik, do të modifikohen rregullat e tregut tranzitor, pas miratimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, KOSTT-i do të mbështetet në implementimin e mekanizmit Tregtia Ndërkufitare / Kompensimi mes TSO-ve për Tranzit (CBT/ITC), pjesëmarrja e vazhdueshme në mekanizmin rajonal të balancimit, përpjekjet do të vazhdojnë për anëtarësimin e KOSTT-it në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike - ENTSO-E (European Netëork Transmission System Operators for Electricity).

f. Shoqëria informative dhe mediat

Telekomunikacioni është element kyç për aktivitetet ekonomike vendore dhe thelbësor për krijimin e marrëdhënieve komerciale ndërkombëtare. Industria e komunikimit përbën një nga sektorët më fitimprurës për indikatorët makroekonomik dhe shërben si katalizator në të ashtuquajturën "ekonomi e mençur". Njëkohësisht, kjo industri shërben si "dritare" për bizneset dhe individët duke mundësuar qasjen e shpejtë dhe globale. Gjithashtu, është vegël për promovimin e transparencës dhe efikasitetit të qeverisë.

Regjimi licencues - Liberalizimi i tregut të telekomunikacionit për rrjetat fikse telekomunikuese dhe për shërbimet lokale, shërbimet në distanca të largëta dhe ndërkombëtare formalisht është bërë në vitin 2003 me ligjin për Telekomunikacionin, (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/16 me 12 Maj 2003).

Telefonia fikse - Për momentin PTK-ja dhe IPKO Net-i janë operatorët e vetëm të autorizuar për të ofruar shërbime të telefonisë fikse si ofrues të shërbimeve lokale, në distanca të largëta dhe ndërkombëtare. ART-ja e ka licencuar PTK-në me 30 Korrik 2004 dhe IPKO Net-in me 8 shtator 2006 (IPKO ka filluar të ofroj këtë shërbim në vitin 2008) në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Telekomunikacionin për të ofruar shërbime të telefonisë fikse. Licencat janë të vlefshme për 15 vjet. Si detyrim dhe obligim për këtë licencë, PTK-ja duhet të përmbushë disa obligime, përfshirë kërkesat për të siguruar shërbime të telefonisë për 50 % të amvisërive deri me 31 dhjetor 2005 dhe për 25% të popullatës deri me 31 dhjetor të vitit 2007. PTK ka përfunduar dixhitalizimin e rrjetit fiks në masën 100% gjatë vitit 2007.

Aurora Israphon-it iu ka dhënë licenca për shërbime Telekomunikuese Ndërkombëtare me 18 Korrik 2006. Kjo licencë iu mundëson atyre ofrimin e shërbimeve të zërit dhe të të dhënave në nivel ndërkombëtar.

Procesi i rebalancimit të tarifave të telefonisë fikse është në vazhdim e sipër, por data për përcaktimin e tarifave fikse nuk është caktuar ende. Rregullimi i tarifave është çështje për aprovim nga ana e ART-së. Megjithatë, koha për të përcaktuar çfarëdo njoftimi për ndryshim të tarifave nuk është definuar ende.

Shërbimet e Internetit - Autorizimet e para për ofruesit e shërbimeve të Internetit, ISP-të iu janë dhënë DardaNet-it (pjesë e PTK-së sh.a.), Ipko Net-it dhe Kujtesës me 18 Maj 2005. Më pastaj duke filluar nga 2007 janë lëshuar edhe 7 (shtat) licenca të tjera për shërbime të internetit, duke arritur në gjithsejtë 10 (dhjetë) ofrues të licencuar të shërbimeve të internetit. ART-ja ka lëshuar autorizime sipas kërkesës së ofruesve të shërbimeve të cilët kanë dëshiruar të legalizojnë statusin e tyre. Të gjitha autorizimet kanë validitet 15 vjeçar dhe licenca është paguar 150,000 €. Megjithatë, leja për të ofruar shërbime VoIP nuk përfshihet në këtë autorizim. ART-ja nuk ka qëndrim zyrtar për VoIP, gjithashtu nuk ekziston as rregullativë specifike për këtë çështje. Penetrimi në shërbimet e internetit ka arritur shifrën 23 % , në fund të vitit 2008.

Shërbimet e telefonisë mobile - Në sektorin e telefonisë mobile tani janë të licencuar dy operatorë që ofrojnë shërbime të telefonisë mobile. Operatori VALA është operatori publik i telefonisë mobile, i licencuar nga ART-ja që nga korriku i vitit 2004. VALA është krijuar në vitin 2000 si projekt operatorit vendor PTK-së. Pasi që Kosova nuk e ka ende kodin e vet telefonik VALA shfrytëzon kodin e Monakos (377) nga rangu i numrave të ndarë nga Monako Telekomi.

Operatori i dytë i telefonisë mobile është Konzorciumi IPKOnet – Telekom Slovenije/ Mobitel, i licencuar nga ART-ja më datë 06 mars 2007. Ky operator ka filluar të ofroj shërbimet kah fundi i vitit 2007 dhe deri më tani ka arritur që të konsolidon mjaft mirë shërbimet e tij. Kjo konkurrencë ka rezultuar në shtimin e llojllojshmërisë së shërbimeve në telefonin mobile dhe njëkohësisht edhe në uljen rapide të çmimeve të shërbimeve. Edhe ky operator njëjtë sikurse operatori VALA, për mungesë të kodit telefonik shtetëror të Kosovës është i obliguar të shfrytëzoj kodin telefonik të Sllovenisë (386).

Penetrimi i gjithmbarshëm i telefonisë mobile i arritur nga të dy operatorët e licencuar deri në fund të vitit 2008 është afërsisht 60 %.

VALA	**IPKO**	Gjithsejtë
42.19%	**16.62%**	58.81 %

Marrëveshja e Ndërlidhjes në mes të operatorëve VALA dhe IPKO është realizuar me ndihmën e ART dhe përveç tjerash rregullon edhe tarifat terminimit të thirrjeve në mes tyre, si në tabelën në vijim:

Proposal PTK/VALA	**Mobile termination rates (euro cent)**				**Asymmetry**
	PTK Mobile		**IPKO Mobile**		
	Peak	**Off-peak**	**Peak**	**Off-peak**	
PTK	**12.5**	**6.25**			
IPKO	**5**	**3**	**8.5**	**5.1**	**1.7**
TRA Dec.	**6.8**	**6**	**12.8**	**11.3**	**1.89**
PTK /IPKO Agreement	**6.8**	**6**	**11.2**	**9.9**	**1.65**

Operator tjetër të telefonisë mobile që *de-facto* operon në Kosovë është operatori ilegal i telefonisë mobile Telenor (Mobtel). Operatori GSM 900 MHz, që ishte prezent në Kosovë para lufte, megjithëse i pa-licencuar, edhe më tutje vazhdon operimin në Kosovë. Qeveria e Kosovës dhe ART-ja e konsiderojnë këtë operim ilegal, por ende nuk kanë arritur të i'a pamundësojnë këtë operim. UNMIK-u ka ftuar Mobtel-in që ta legalizojë statusin duke aplikuar për licencë tek ART-ja sikurse që parashihet në Ligjin për Telekomunikacionin. Pas refuzimit që ta bej këtë, UNMIK-u ka kërkuar nga Mobteli që të liroj GSM frekuencat në Kosovë. Mobteli operon duke shfrytëzuar kodin e Serbisë (381).

Në mënyrë të përmbledhur lloji dhe numri i licencave që deri më tani janë lëshuara nga ART , janë paraqitur në tabelën në vijim:

Lloji i licencës	**Numri i licencave**
Licenca për Shërbime Telekomunikuese Mobile	2
Licenca Kombëtare për Shërbime Fikse	3
Licenca për Shërbime të Internetit	10
Licenca për Shërbime Telekomunikuese Ndërkombëtare	5
Licenca për Pajisjet e Telekomunikimit Ndërkombëtar	5
Licenca për Shërbime me Vlerë të Shtuar	14
Licenca për MVNO (Mobile Virtual Netëork Operator)	2

Në Kosovë veprojnë 114 subjekte transmetuese, 8 operatorë kabllorë dhe afër 20 ofrues të shërbimeve programore.

Skena e mediave ka ndryshuar shumë gjatë dy viteve të fundit. Transmetimi nuk është me vetëm ai klasik, në rrjetin tokësor. Zhvillimet e teknologjisë kanë rezultuar me prezantim të platformave të reja. Ndryshimet janë në vazhdimësi por rregullimi i tyre mbetet i njëjtë. Secila platformë duhet t'u nënshtrohet parimeve dhe kushteve për operim më efikas dhe në pajtim me ligjin dhe standardet evropiane.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është autoriteti i vetëm rregullativ i transmetimit në Republikën e Kosovës.

KPM ka për mision të promovojë zhvillimin e një tregu të shëndoshë medial që u shërben të gjithë njerëzve të Kosovës; të inkurajojë profesionalizmin në radhët e gazetarëve, menaxherëve dhe pronarëve të mediave dhe të mbrojë lirinë e shprehjes, shumëllojshmërinë e mendimit, qasjen në informata për gazetarë dhe publikun si dhe interesin e shfrytëzuesve të mediave dhe operatorëve sipas sundimit të ligjit.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së shoqërisë informative është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative e cila rregullon këtë sektor. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- *Ligji për Telekomunikacionin, nr. 2002/7* - ky ligj rregullon të gjitha shërbimet e telekomunikacionit dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit si dhe krijon një ambient ligjor,

rregullator dhe transparent, gjithashtu bënë edhe promovimin e investimeve dhe konkurrencës së lirë, për t'i përmbushur nevojat e të gjithë shfrytëzuesve për shërbime të telekomunikacionit.
- *Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informative, nr. 02/L-23* – Me anë të këtij ligji, dokumentacioni në formë elektronike do të jetë juridikisht i barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në formë të letrës, për të lehtësuar veprimtarinë komerciale që përfshijnë, por që nuk kufizohet në shitblerje që bëjnë konsumatorët përmes internetit e-Tregtia, shërbimet elektronike bankare dhe ato financiare e-Pagesa, ofrimi i shërbimeve qeveritare e-Qeverisja, blerja në formë elektronike nga ndërmarrjet e-Prokurimi.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e shoqërisë informative, në fuqi është një kornizë gjithëpërfshirëse aktesh nënligjore, e cila përbëhet nga:

- UA mbi Caktimin e Dënimeve për Kundërvajtjet nga Telekomunikacioni, nr. 2004/3;
- Rregullore për licenca dhe autorizime, nr. 01/2005;
- Amendamentimi i rregullores për licenca dhe autorizime, nr. 182/07-B;
- Rregullore për procedurën e hetimit dhe inspektimit, nr. 01/2006;
- Rregullore për procedurën e zgjidhjes se konflikteve, nr. 183/07;
- Rregullore për tarifimin e spektrit, nr. 182/07;
- Rregullore për dhënien e licencës për akordimin e të drejtës për shfrytëzimin e radio frekuencave, nr. 008/08;
- Rregullore për mbrojtje e konsumatorit dhe fshehtësisë se përdoruesve te shërbimeve telekomunikuese, nr. 222/08;
- Rregullorja mbi Planin e Numeracionit, nr. 153/07;
- UA mbi tarifën dhe procesim të aplikacionit, nr. 180/07.
- Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për tarifim të spektrit, nr. 028/09.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e Shoqërisë Informative dhe Mediave, në implementim e sipër janë dokumentet në vijim:

- Politikat e sektorit të telekomunikacionit - përmban politikat e Qeverisë së Kosovës për Sektorin e Telekomunikacionit për një periudhë afatmesme deri afatgjatë.
- Strategjia Nacionale për Shoqëri të Informacionit - e formuluar me iniciativë të Ministrisë së Transportit dhe Postë&Telekomunikacionit dhe me mbështetje të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) është produkt i një partneriteti multisektorial, si një domosdoshmëri për sektorin e Shoqërisë së Informacionit. Në këtë Strategji paraqitet objektiva strategjike: që Kosova do të bëhet anëtare aktive dhe konkurruese e ekonomisë së re të bazuar në dituri; i cili fakt do të sigurojë qasje demokratike dhe prosperuese për zhvillim ekonomik. Kjo objektivë strategjike është parcializuar më tej në pesë objektiva sektoriale;
- eSEE Agjenda+ për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në EJL 2007-2012 - është një dokument i nënshkruar nga Qeveritë e vendeve të Evropës Juglindore ku ato shprehin vendosmërinë e plotë në zbatimin e prioriteteve dhe objektivave nga ky dokument, si një hap i madh drejt një përpjekje të përbashkët për ndërtimin e Shoqërisë së Informacionit në vendet e Evropës Juglindore..

Korniza institucionale

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit si institucion përgjegjës në çështjet e Telekomunikacionit në përbërje të vet ka Departamentin e TIK-ut.

Ne sektorin e telekomunikacionit shqyrton pajtueshmërinë me standardet evropiane që përfshijnë tarifat dhe taksat, cilësinë e shërbimeve dhe standardeve teknike, krijon politikën e punës për promovimin e konkurrencës si dhe shqyrton nevojat e konsumatorëve.

Në sektorin e teknologjisë informative përkrahë teknologjinë informative dhe të inovacioneve, p.sh. tregtinë elektronike, përkrahë qasjen në teknologji si dhe nxitë zhvillimin e sistemeve të aftësisë në teknologjinë informative.

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) është përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve telekomunikuese, ku inkurajohet pjesëmarrja e sektorit privat dhe konkurrenca në shërbimin e ofrimeve. Ky agjencion gjithashtu vendos standarde për ofruesit e shërbimeve në Kosovë dhe cakton dispozitat për mbrojtjen e konsumatorit.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimit në Kosovë. Qëllimi i një rregullatori për transmetim është të ndaj një burim të rrallë – brezin frekuencor – në mënyrë të drejtë dhe të hapur për t'iu shërbyer më së miri të gjithë njerëzve në Kosovë. KPM-ja promovon standarde etike dhe teknike për mediat transmetuese në Kosovë. Zbaton një grup rregulloresh që i mban subjektet lokale transmetuese në nivel me standardet evropiane të profesionalizmit dhe paanësisë në mbulimin e lajmeve të tyre. Përmes administrimit të planit të tij frekuencor të transmetimit, KPM-ja gjithashtu përpiqet të jetë i paanshëm në konkurimin në mes të subjekteve transmetuese. Aktivitetet e KPM-së përfshijnë monitorimin e mbulimit e ngjarjeve aktuale të transmetuara, komentimet rreth legjislacionit që ka të bëj me media, vlerësimin e ankesave, dhe zbatimin e rregulloreve dhe kushteve të licencave të lëshuara nga KPM-ja.

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian në fushën e shoqërisë informative dhe mediave , do të synojmë përhapjen e Internetit Brezgjerë në të gjitha shkollat dhe institucionet akademike, zhvillimin e programeve për mësimin e vazhdueshëm të zyrtarëve qeveritar në sferën e teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit deri në mes të vitit 2009 (ECDL/ICDL), zhvillimi i programit për funksionalizmin e përdorimit të numrit telefonik standard të emergjencës "E-112" dhe krijimin e planeve implementuese për emergjencë të integruar dhe të shërbimeve komunikuese të sigurisë publike, krijimin e qendrave kompjuterike shtetërore të reagimit në raste emergjente dhe fillimi i shkëmbimit të informacioneve, themelimin e kushteve për tregti elektronike, prokurim elektronik dhe aplikim i nënshkrimit elektronik. Ndërkaq, duke u bazuar në kompetencat e ART-së, do të synohet që të bëhet harmonizimi i tabelës së ndarjes të frekuencave në përputhje me tabelën Evropiane të rëndomtë të ndarjes dhe me Vendimin Nr. 676/2002/EC, sigurimi i veglave elektronike (softuer i avancuar për menaxhimin e spektrit të frekuencave), krijimi i stacionit fiks për monitorimin e spektrit, të bëhet ngritja e kapaciteteve për të kryer monitorimin e spektrit dhe matjen nga distanca të parametrave të emetimit, mbajtja e spektrit, identifikimi i emetimeve dhe lokacioni i burimit të ndërhyrjes së dëmshme, definimi i regjimit të Qasjes dhe Shërbimeve Universale, angazhimi rreth marrjes se kodit thirrës për shërbimet telefonike dhe kodit për Top Nivelin e Domenit Nacional për shërbime të Internetit – Kodit Shtetëror për Internet si dhe Kodit "Call Sign" për radio amator, promovimi i nyjave të përbashkëta/ shkëmbyese të internetit, studimi për definimin e tregut me qëllim të definimit të ofruesve të shërbimeve që kanë fuqi të ndjeshme në treg, analiza e tregjeve relevante në sektorin e komunikimeve elektronike, rregullimi i shërbimeve që i ofrojnë Operatorët me fuqi të ndjeshme në treg, përgatitja dhe aprovimi i Rregullores për Bartshmërinë e Numrave (ang. Nummber Portability), përgatitja dhe aprovimi i Rregullores për zgjedhjen dhe parazgjedhjen e bartësit (ang. Carrier Selection and Carrier Preselection), përgatitja dhe aprovimi i Rregullores për RUO (RUO - Refference Unbundling Offer), zhvillimi dhe implementimi i detajuar i sistemit të politikave për çmimet/tarifat, implementimi i rebalancimit të tarifave nga PTK dhe përfundimi dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare për qasje ne Infrastrukturën brezgjerë ëireless (patela). Duke u bazuar në kompetencat e KPM do të synohet që të bëhet hartimi i strategjisë për kalim ne sistemin digjital te transmetimit nga sistemi analog, implementimi i Projektit Kapital të Monitorimit Mobil përmes sigurimit të pajisjeve për pranimin e sinjaleve të mediave analoge dhe kabllore dhe arkivimin e tyre.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiannë fushën e shoqërisë informative dhe mediave, do të synojmë ta bëjmë ndryshimi i Ligjit te Telekomunikacionit dhe Ligjit për Media dhe Komision Transmetues ne baze te konkluzioneve nga analizat e bëra. Ndërkaq sa i përket kompetencave të ART-së do të synohet që të bëhet krijimi i kategorive të përshtatshme për licencim/autorizim/regjistrim dhe udhëzuesve të përshtatshëm për të kaluar nga regjimi aktual në regjimin e kategorive të licencave/autorizimeve/regjistrimeve, aprovimi i termeve të referencës mbi funksionimin e ART-së, përfshirë aprovimin e statutit bazë, kompletimin e urdhëresave organizative dhe sistematizuese, si dhe hartimi i rregullores për te drejtën për shteg për operatoret e licencuar për te ofruar shërbime telekomunikuese.

g. Kontrolli financiar

Departamenti i Thesarit ka përgjegjësi t'i përmbushë praktikat më të mira ndërkombëtare në menaxhimin e parasë publike për Republikën e Kosovës.
Sigurimi i një mjedisi transparent dhe informativ i financave dhe kontrollit në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke përfshirë:

- Përputhjen me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS)
- Krijimin dhe zbatimin e një kornize për kontrollin e brendshëm të financave publike në pajtim me standardet e BE-së.
- Ekzekutimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në harmoni me ligjin, rregullat dhe procedurat në fuqi.
- Ngritjen e kapaciteteve brenda Thesarit për menaxhimin e borxheve.
- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e parashikimit dhe menaxhimit të rrjedhës së parasë për të maksimizuar përdorimin e mjeteve të qeverisë.
- Zhvillimin dhe shpalljen e politikave dhe procedurave të duhura.

Në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Thesari është përgjegjës për zhvillimin e kornizës së politikave të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, implementimin e rregullave financiare të KBFP-së, edukimin lidhur me kontrollin e brendshëm financiar, ekzekutimin e buxhetit , grumbullimin dhe ruajtjen e parasë publike.

Thesari është përgjegjës për themelimin e një kornize të llogaridhënies që, brenda një ambienti të llogaridhënies dhe kontrollit të plotë, i mundëson Thesarit dhe organizatave buxhetore t'i plotësojnë obligimet e tyre ligjore dhe morale për të ekzekutuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës në mënyrë efikase dhe efektive duke pasur parasysh parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

Thesari ka këto përgjegjësi:

a) Zbatimin e kontrolleve për pagesat, si brenda organizatave buxhetore ashtu edhe të ushtruara drejtpërdrejt nga ana e Thesarit.
b) Duke inkurajuar delegimin e ekzekutimit të buxhetit brenda një kornize konsistente të llogaridhënies dhe kontrollit të brendshëm.
c) Duke lënë gjurmë gjithëpërfshirëse të auditimit, ku dokumentet kryesore që përmbajnë aprovimet (nënshkrimet) dhe dokumentacioni i lidhur me shpenzimet mbahen nga ana e Thesarit për auditim.

d) Regjistrat e detajuar të kontabilitetit për të gjitha transaksionet, duke përfshirë përcjelljen e zotimeve dhe shpenzimeve përmes një libri të përgjithshëm të centralizuar në të cilin të gjitha organizatat buxhetore mund të kenë qasje nga largësia.
e) Raporte financiare gjithëpërfshirëse dhe të rregullta që janë konsistente me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe me statistikat financiare qeveritare (GFS)
f) Vendosjen e rregullave për shpenzime që sigurojnë që vetitë e mësipërme të implementohen në mënyrë konsistente dhe që ekzekutimi aktual i buxhetit të reflektojë buxhetin të tillë siç është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Korniza ligjore

Fushë veprimtaria e Menaxhimit të Financave Publike përkufizohet me kornizën legjislative që rregullojnë çështjet: e pranimit, ruajtjes, investimit dhe shpenzimit të parasë publike. Korniza legjislative përbëhet:

- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nr. 03/ L-048;
- Ligji për ndarjet buxhetore i Republikës së Kosovës, nr. 03/L- 088, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L- 093;
- Ligji i Prokurimit Publik nr. 2003/17 i ndryshuar me Rregulloren 2007/20;
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, nr. 03/L-049.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative që trajtojnë çështjet e financave publike janë nxjerrë edhe akte nënligjore, të cilat përbëhen nga:

- UA 2005/11 , Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare
- UA 2006/13 , Pagesat për Shpenzime të Rrymës Elektrike
- Rregulla Financiare – 01, Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
- Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit -02 Shpenzimi i Parasë Publike
- UA nr. 2007/4 Llogaritë Bankare të Komunave
- UA, nr. 2008/10 Për udhëzimet e përfundimit të vitit financiar - 2008
- UA, nr. 2008/14 Për fillimin e vitit fiskal - 2009
- UA, nr. 2008/9 Për procedurat e pagesës për Ambasadat e Jashtme të Ministrisë së Punëve të Jashtme
- Udhëzimi Administrativ, nr. 2008/ 13, Raportimi vjetor i organizatave buxhetore
- UA, nr. 2008/08, për ekzekutimin e vendimeve përmbaruese të gjykatave
- UA, nr. 2007/6 Standardi i Unifikuar për Numra Referent për grumbullimin e të hyrave
- UA, nr. 2005/08 Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve
- UA, nr. 2005/07 Ekzekutimi i Buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.

Implementimi i politikave efektive në fushën e Menaxhimit të Financave Publike bazohet në dokumentet strategjike:

- Politikat mbi Kontroll të Brendshëm të Financave Publike të miratuar nga Qeveria në janar 2005 (Vendimi 4/130) i ndryshuar me 1 Mars 2006;
- Plani i veprimit për Reformën e Administratës Publike;
- Plani i veprimit për Decentralizim;
- Korniza afatmesme e shpenzimeve;
- Plani strategjik i MEF –it;
- Plani strategjik i Thesarit.

Korniza institucionale

Departamenti i Thesarit është institucion përgjegjës për grumbullimin, ruajtjen, investimin dhe shpenzimin e parasë publike që do të thotë që është përgjegjës për ekzekutimin e Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës. Këtë funksion e ushtron nëpërmes të këtyre divizioneve:

1. Divizioni i Raportimet Financiare, Kontabilitetit dhe Granteve;
2. Divizioni i Menaxhimit i Parasë së Gatshme dhe Borxheve;
3. Divizioni i të hyrave publike;
4. Divizioni i pagesave;
5. Divizioni i Sistemit të Menaxhimit Financiar të Kosovës;
6. Divizioni i Administratës dhe Teknologjisë Informative;
7. Auditori i Brendshëm.

Prioritetet afatshkurtra
M e synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian,Departamenti i Thesarit ka synim që të bëjë:

- Ndryshimet dhe përshtatjen e Udhëzimeve Administrative sipas Ligjeve të aprovuara siç janë LMFPP, Ligjit për ndarjet buxhetore, të aprovuara gjatë vitit 2008 të cilat kanë ndikim në Politikat e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike dhe ekzekutimin e buxhetit;
- Edukimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të organizatave buxhetorë për ngritje të cilësisë së Menaxhimit të Financave publike dhe përdorimit më efikas të SIMFK-së;
- Avancimin e NJQH për Kontrollimtë Brendshëm të Financave Publike;
- Ngritjen e kapaciteteve të njësisë së menaxhimit të borxheve dhe investimit të parasë;
- Shpalljen e Udhëzimit Administrativ për Decentralizim të Menaxhimit të Shpenzimeve;
- Shpalljen e Udhëzimit Administrativ për investimin e parasë publike;
- Implementimin e Modulit për barazimin elektronik të llogarive bankare.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropiannë fushën e Thesarit parashihet që të bëhet:

- decentralizimi i shpenzimeve nga Thesari te organizatat buxhetore;
- bartja e përgjegjësive për arkivimin të dokumenteve financiar nga Thesari te organizatat buxhetore;
- Implementimi i softuerit për borxhet;
- Implementimi i arkivës digjitale;
- Implementimi i kredit kartelave bankare;
- Hapja e llogarive bankare për Ambasadat.

h. Statistikat

Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka funksionuar si zyrë profesionale qysh prej vitit 1948 dhe ka kaluar gjitha fazat historike të Kosovës. Më 2 gusht 1999, ESK-ja rifilloi punën e tij si institucion i pavarur dhe profesional i administratës publike në Kosovë. ESK-ja është agjenci ekzekutive brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike (MAP) dhe ka numër total prej 134 punëtorësh.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së Statistikave në fuqi është *Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/14 mbi Statistikat* e cila ka hyrë në fuqi më 2 korrik 2001.

Ligji mbi Statistikat Zyrtare është draftuar dhe pritet të aprovohet nga Kuvendi. Deri në aprovimin e ligjit, ESK-ja punon në bazë të kësaj rregullore.

Sipas Rregullores 2001/14 funksionet e ESK-së janë: (a) hartimi dhe zbatimi i strategjisë së përgjithshme, politikave dhe standardeve për grumbullimin e të dhënave, përpilimin e të dhënave statistikore, përpunimin elektronik të shënimeve si dhe shpërndarja e informatave dhe të dhënave statistikore; (b) të sigurojë që gjitha shënimet të merren dhe komunikohen në bazë të metodave dhe teknikave të njohura dhe të përshtatshme e të përdorura në fushën e statistikave; (c) themelimi dhe zhvillimi i shërbimeve të avancuara statistikore; (d) propozimi i rregulloreve, sipas nevojës, mbi çështjet në lidhje me shërbimet statistikore; (e) kryerja e gjitha funksioneve të një Autoriteti Rregullativ mbi shërbimet statistikore; (f) sigurimi i statistikave zyrtare mbi ekonominë, demografinë, gjendjen sociale dhe mjedisore në Kosovë; (g) ndërmarrja e hulumtimeve statistikore; (h) përpilimi dhe mirëmbajtja e regjistrave që do të përdoren për qëllime statistikore; (i) sigurimi i qasjes ndaj informatave statistikore dhe të dhënave për të gjithë shfrytëzuesit, si organet dhe organizatat e administratës publike, ekonominë, institucionet relevante shkencore dhe profesionale, mediat si dhe publikun e përgjithshëm, në pajtim me ligjin në fuqi; (j) garantimi i kushteve për interpretim standard të shënimeve të grumbulluara dhe të përpunuara si dhe ndërtimi i masave për reagim nga përdorimi i gabueshëm aksidental apo i qëllimshëm i shënimeve statistikore; (k) bashkëpunimi dhe bashkërendimi me organet gjegjëse dhe organizatat e administratës publike në lidhje me shërbimet statistikore; si dhe (l) bashkërendimi i agjencive ndërkombëtare dhe qeveritare si dhe organizatave joqeveritare për të promovuar zhvillimin dhe implementimin koherent të shërbimeve statistikore.

Korniza institucionale
Enti i Statistikave të Kosovës është Agjenci e pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MAP) dhe është përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave. ESK ka shtatë departamente:

- Departamenti i Statistikave të Ekonomisë dhe Llogaritjeve Kombëtare,
- Departamenti i Statistikave të Popullsisë,
- Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit,
- Departamenti i Statistikave Sociale,
- Departamenti i Statistikave të Metodologjisë dhe Teknologjisë,
- Departamenti i Administratës si dhe
- Zyra për Regjistrimin e Popullsisë.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtëra të Partneritetit Evropian në fushën e statistikave, ESK-ja mes tjerash do të fokusohet në përforcimin e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e pavarësisë operative dhe financiare, si dhe sigurimin e saktësisë në statistika, duke përfshirë kualitetin e të dhënave të mundësuar nga anketat e respodentëve, të cilët sjellin të dhëna rregullisht në ESK pa pagesë.

Zbatimi i Ligjit mbi Statistikat zyrtare te Kosovës përmes nxerjeve te akteve nënligjore do të realizohet në vazhdimësi.

Me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve, ESK-ja ka paraparë hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Planit Zhvillimor Strategjik të ESK-së. Po ashtu në veprime përfshihet edhe rekrutimi i 15 zyrtarëve profesional në statistikat prodhuese si dhe trajnime profesionale për ngritjen e kapaciteteve te ESK-së (Metodologji, praktikat dhe metodat e EUROSTAT-it, mostra, programet softuerike dhe analiza), krijimi i grupeve punuese për fushat e caktuara me qëllim të përmirësimit të kualitetit dhe saktësisë së të dhënave.Po ashtu do të kërkohet një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet ESK-së dhe institucioneve të linjës në ofrimin e të dhënave, trajnimin e zyrtarëve përgjegjës të përfshirë në procesin e anketimeve të rregullta.

Në lidhje me zhvillimin e statistikave ekonomike dhe shpejtimin e zhvillimit të statistikave sociale, do të bëhet përgatitja dhe publikimi i llogarive kombëtare - BPV (GDP) - qasja e shpenzimeve 2007, përgatitja dhe publikimi i llogarive kombëtare - BPV (GDP) - qasja e prodhimit (tabelat ofruese përdoruese - SUT 2005/2006).

Do të vazhdohet me Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve 2008, publikimin e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2006, mbledhjen e të dhënave mbi Çmimet e Prodhimit e cila është në vazhdimësi (çdo tre muaj), do të ndërtohet një numër statistikash, si shërbimet Hoteliere 2008.

Një ndër veprimet tjera që i përket këtij prioriteti është edhe Publikimi vjetor i Statistikave të Indeksit te Çmimeve te Konsumit (IÇK-se), inflacionit për vitin 2008, publikimi i Statistikave për Tregtinë e Jashtme për vitin 2008, mbledhja e Çmimeve te Konsumit dhe Publikimi i Indeksit te Çmimeve Konsumit (IÇK) (Statistikave të Inflacionit) për vitin 2009 do të realizohet në vazhdimësi si dhe publikimi mujor i Statistikave për Tregtinë e Jashtme.

Do të vazhdohet zhvillimi i statistikave përmes anketave dhe pyetësorëve të ndryshëm, mes tjerash është edhe realizimi dhe publikimi i anketave të ekonomive familjare bujqësore dhe nxjerrja e statistikave bujqësore 2008.

Veprimet tjera të parashikuara në PVPE janë edhe publikimi i statistikat agro monetare- Çmimet dhe indeksi i çmimeve te prodhimeve bujqësore, realizimi i statistikave të mjedisit dhe publikimi i tyre për vitin 2008.

Realizimi dhe Publikimi i Anketës së Buxhetit Familjar (ABF) po ashtu edhe realizimi dhe Publikimi i Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP).

Ne kuadër të statistikave përfshihet edhe statistikat e popullsisë që do te vazhdojnë me grumbullimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave vitale mbi: lindjet, vdekjet, kurorëzimet dhe shkurorëzimet për vitin 2008-2009. Po ashtu si publikim i parë do të jetë ,,Shkaku i vdekjeve". Një anketë me Bankën Botërore mbi ,,Migracionin dhe remitancat ne Kosovë" pritet të zhvillohet këtë vit (2009).

Në mes tjerash përfshihen edhe zhvillimet e statistikave sociale si: realizimi dhe publikimi i statistikave të arsimit, të sportit, të kulturës, të shëndetësisë, të jurispondencës dhe mirëqenies sociale.

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të Prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e statistikave, ESK-ja mes tjerash do të fokusohet në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin brenda sistemit statistikor të Kosovës, në zhvillimin dhe dokumentimin e një sistemi kualitativ të menaxhmentit dhe në standardizimin e prodhimit dhe ndarjen e procedurave.

Përveç këtyre, PVPE-ja 2008 parashikon krijimin e një Këshilli Statistikor, krijimin e një Grupi të Eksperteve, fillimin e harmonizimit dhe klasifikimit të nomenklaturave sipas standardeve të BE-së, fillimin e krijimit të një sistemi për llogaritjen e indikatorëve ekonomikë afatshkurtër për llogaritë kombëtare tre mujore.

Fillimi i anketës së paritetit te fuqisë blerëse, bashkëpunimi dhe këmbimi i informatave statistikore me të gjithë akterët relevant, ngritja e kapaciteteve ndërlidhëse të teknologjisë informative ndërmjet ESK dhe institucioneve tjera.

Veprim tjetër do të jetë edhe ngritja e sistemit te GIS-it, standardizimi i prodhimit të statistikave drejt përafrimit me EUROSTAT-in, ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve adekuate në fushën menaxheriale dhe statistikore, avancimi i kontrollit për të gjitha fazat e hulumtimeve.

Si veprim tjetër në kuadër të zhvillimit të një sistemi statistikor të Kosovës është edhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve për personelin e ESK-së në kodifikimet statistikore.

2.3.3 DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

a. Vizat, kufijt, azili dhe migrimi

Republika e Kosovës është e shtrirë gjeografikisht në mes të Ballkanit dhe gjatë dekadave të fundit ka qenë në mes të rrugëve të migrimit ilegal. Me qëllim që në një periudhë afatshkurtër edhe Kosova të jetë e gatshme për procesin e liberalizimit të vizave sikurse edhe vendet e rajonit ne jemi në fazën përmbyllëse të implementimit të aktiviteteve të parapara në PVPE.

Migrimi legal si dhe menaxhimi i integruar i kufijve është prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe MPB-ja është aktori kryesor por jo i vetëm në këtë fushë. Në këtë kuadër MPB-ja i ka bërë përgatitjet e mjaftueshme legjislative, institucionale dhe të resurseve njerëzore për implementimin e standardeve më të larta evropiane që ndërlidhen me fushën e Migrimit legal dhe menaxhimit të Integruar të kufijve.

Me hartimin politikave të vizave do të përmbyllet edhe cikli i hyrje daljeve në Kosovë si dhe do të kompletohet e gjithë infrastruktura rreth lëvizjes së shtetasve të huaj në Kosovë.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së Vizave, Kontrollit të Kufijvë, Azilit dhe Migracionit është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative, e cila rregullon këtë sektor. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

Ligji për të Huajt (Nr.03/L-126) - Me këtë ligj rregullohet hyrja, lëvizja dhe qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji lidhur me qëndrimin e të huajve nuk vlejnë për pjesëtarët e misioneve diplomatike dhe konsulare, për pjesëtarë të organizatave të Kombeve të Bashkuara dhe institucionet tjera të specializuara të Kombeve të Bashkuara, pjesëtarë të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Kosovës dhe pjesëtarët e familjes së tyre.

Ligji për Azil (Nr.03/L-066) - ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen, ndërprerjen, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azil-kërkuesve, azilantëve, si dhe të personave të cilëve iu është lejuar Mbrojtja Plotësuese dhe Mbrojtja e Përkohshme.

Ligji për Menaxhimin e Inegruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror (Nr.03/L-067) – ky Ligj përcakton autoritetet kompetente dhe përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Ky ligj zbatohet pa paragjykim ndaj mandatit të veçantë të organizatave ndërkombëtare, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.Bashkëpunimi ndërmjet agjencive bëhet nga policia kufitare, Shërbimi Doganor,Shërbimi Fitosanitar, Shërbimi Veterinar, dhe të gjitha agjencitë tjera relevante siç janë të definuar me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit Dispozitat në këtë ligj janë të aplikueshme ndaj të gjithë personave që hynë apo lëshojnë Kosovën me përjashtim të atyre qe kërkojnë apo mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se do të kërkojnë azil. Në raste të tilla, do të aplikohet Ligji mbi Azilin.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregllon sektorin e Vizave, Kontrollit të Kufirit, Azilit dhe Migracionit, në fuqi janë 2 akte nënligjore:

UA Nr. 01/2009 për letërnjoftim për te Huaj - me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen procedurat e aplikimit për letërnjoftim te huaj, letërnjoftim te humbur/dëmtuar, ndërrim te të dhënave dhe ripërtëritjen e te dhënave, format e formularëve te aplikimit për letërnjoftim te huaj, përcaktimin e formës dhe mënyrës se punimit te letërnjoftimit për te huajt dhe udhëheqjes se evidencave te letërnjoftimit për te huajt.

UA për përcaktimin e vulave për hyrje dhe dalje nga Republika e Kosovës në PKK i nënshkruar nga Ministri me datën 13 Qershor 2008.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e Vizave, Kontrollit të Kufirit, Azilit dhe Migracionit, dokumentet strategjike në vijim janë në implementim e sipër:

- Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar 2007;
- Politikat e Ripranimit 2007;
- Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit;
- Procedurat standarde të veprimit për procesin e ripranimit të personave prej shteteve nikoqire me prejardhje nga Kosova
- Procedurat Standarde të Operimit (Policia Kufitare).

Korniza institucionale

Ministria e Punëve të Brendshme si institucion përgjegjës për qështjet e Vizave, Kontrollit të Kufirit, Azilit dhe Migracionit ka këtë strukturë institucionale:

- *Departamenti për Kufi, Azil dhe Migracion* në MPB – ky departament bënë pranimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve duke asistuar në zgjidhjen e komplikimeve eventuale gjatë procesit të realizimit të vendosjes, akomodimit dhe integrimit të tyre në shoqërinë kosovare, si dhe bën implementimin e politikave të riatdhesimit në pajtim me konventat, ligjet dhe standardet e caktuara nga Bashkimi Evropian.
- *Shtylla e Policisë Kufitare;*
- *Drejtoria për të Huajt (Policia e Kosovës).*

Prioritetet afatshkurtra

Me synim të adresimit të Pioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e Vizave, Kontrollit të Kufive, Azilit dhe Migracionit, mes tjerash Ministria e Punëve të Brendshme do të synoj vazhdimin e sigurimit të paisjeve të domosdoshme për forcimin e kontrollit të fluksit të personave në vendkalimet kufitare dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të vazhdueshme bazike dhe të specializuar për pjestarët e policisë kufitare. MPB-ja do të kujdeset për funksionimin e Bordit Ekzekutiv të themeluar me 25.05.2009 për Implementimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit.Gjithashtu MPB-ja do të bëjë nënshkrimin e Marëveshjeve dhe protokolleve për bashkëpunim ndërkufitar me vendet fqinjë.Në aspektin institucional do të bëhet ndërtimi i Qendrës për pranimin e Azil kërkuesve, funksionalizimi i sajë dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit përkitazi me çështjet e Azilit/refugjatëve duke përfshirë standardet e acquis të BE-së dhe praktikat më të mira. Në aspektin strategjik do të hartohet Strategjia dhe plani për zbatimin e Strategjisë përkitazi me Migrimin

Prioritetet afatmesme

Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e Vizave, Kontrollit të Kufive, Azilit dhe Migracionit, mes tjerash Ministria e Punëve të Brendshme do të synoj përmirësimin edhe më tutje të kapacitetit të Departamentit për Kufij, Azil dhe Migracion Brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë Kufitare brenda Policisë së Kosovës përmes shtimit

të personelit përkatës, sigurimit të hapsirave të mjaftueshme për punë, të këtyre departamenteve, përmes ofrimit të trajnimeve për stafin e Departamentit për Kufi, Azil dhe Migracion në MPB dhe Policisë Kufitare dhe sigurimit të mjaftueshëm të paisjeve për Policinë Kufitare.

b. Shpërlarja e parave

, Me synim të adresimit të prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e shpërlarjes së parave, mes tjerash, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, zhvillimin e bashkëpunimit mes MPB-së, PK-së, Doganes, ATK-së dhe BQK-së, si dhe miratimi i Ligjit kundër Shpërlarjes së Parave.

c. Luftimi i krimit të organizuar

Qeveria e Kosovës ka shpreh qartë vullnetin e pakushtëzuar për një luftë pakompromis kundër krimit të organizuar, lufta kundër korrupsionit, trafiqet e paligjshme, dhe luftën kundër terrorizmit. Të gjitha këto dukuri negative kryesojnë listën e prioriteteve qeveritare. Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar kërkon vullnet politik. Është zotim i Qeverisë së Kosovës që të aplikojë zero tolerancë kundër këtyre fenomeneve.

Krahas institucioneve të tjera, Ministria e Punëve të Brendshme, merr përsipër të luajë një rol të rëndësishëm në koordinimin e veprimeve të hartimit të strategjisë kundër Krimit të Organizuar si dhe të Strategjisë për Luftimin e Terorrizmit si dhe implementimit të këtyre strategjive. Ministria e Punëve të Brendshme është zotuar se këto strategji do të përfundojnë deri në fund të Qershorit, 2009. Grupet punuese Ndërministrore janë krijuar, dhe kanë përcaktuar metodologjinë e punës, si dhe kanë vendosur një orar çdo dyjavor për tu takuar dhe punuar në hartimin e këtyre Strategjive. Të gjitha ministritë, departamentet, dhe agjencitë, që kanë përgjegjësi të luftojnë Krimin e Organizuar dhe Terrorizmin, janë mobilizuar në mënyrë që të kontribuojnë sa më shumë ne hartimin e kësaj strategjie.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së Krimit të Organizuar në fuqi është Kodi i Përkohshëm Penal i vitit 2003 përkatësishtë Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal Ligji 03/L-002 2008 Kodi Penal i Kosovës.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e Luftimit të Krimit të Organizuar, dokumentet strategjike në vijim janë në implementim e sipër:

- Parimet dhe Procedurat Standarde Operative;
- Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta 2008;
- Strategjia për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008;
- Plani për Zbatimin e Strategjisë për luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008;
- Plani Strategjik i policisë se Kosovës 2008-2010.

Korniza institucionale
Ministria e Punëve të Brendshme me Policinë e Kososvës si institucion përgjegjës për çështjet e luftimit të krimit të organizuar ka këtë strukturë:

- Departamenti për Siguri Publike (MPB);
- Shtylla e hetimeve në Policinë e Kosovës;
- Njësitet regjionale.

Drejtoria për luftimin e krimit të organizuar - si pjesë përbërëse e Shtyllës së Krimit, vepron dhe funksionon në bazë të ligjeve në fuqi, si Kodi Penal i Kosovës, por edhe në bazë të Parimeve dhe Procedurave Standarde Operative.

Në lidhje me infrastrukturën institucionale dhe ndarjen e përgjegjësive në fushën e luftimit të krimit të organizuar, MPB-ja është përgjegjëse për hartimin e politikave të sigurisë së brendshme, duke përfshirë krimin e organizuar në këtë rast.

Misioni i EULEX-it mban përgjegjësinë e monitorimit dhe këshillimit në fushën e sigurisë dhe gjithahstu mban disa kompetenca ekzekutive.

Prioritetet afatskurtra
Me synim të adresimit të prioriteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e Luftimit të Krimit të Organizuar MPB-ja k inicuar Projekt-Strategjinë për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Planit të Veprimit për implementimin e Strategjisë si dhe ka inicuar dhe ka bërë finalizimin e projekt-strategjisë për Luftimin e Terorizmit dhe Planit të Veprimit për implementimin e Strategjisë dhe hartimi i Planit për mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e luftimit të krimit të organizuar, mes tjerash, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në vazhdimin e implementimit të Strategjisë për luftimin e krimit të organizuar, strategjinë për luftimin e terrorizmit, implementimin e staretegjisë për luftimin e trafikimit me qënjet njerëzore, implementimin e planit për mbledhjen e armëve, ndërtimin e kapaciteteve institucionale përmes trajnimit dhe rekrutimit, si dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit me Interpol-n dhe Europol-n.

d. Drogat

Problemet në lidhje me drogat, sidomos në trafikimin e tyre, janë identifikuar si brengosëse në Raportin e fundit të Progresit. Për herë të parë nga strukturat e shtetit merret përsipër realizimi i një koordinimi të plotë të veprimeve e masave të gjithë institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar duke bërë të mundur goditjen dhe ndërprerjen e tij, si dhe të ndërmerr masat e nevojshme për parandalim. Kështu, kjo çështje është adresuar gjerësisht me veprimet afatshkurtra dhe afatmesme në PVPE. Kjo bëhet me një qasje që synon reduktimin e ofertës, zvogëlimin e kërkesës dhe furnizimit të drogave, vetëdijësimit dhe rehabilitimin.

Në periudhën afatshkurtër, hartohet Strategjia për Parandalimin e Drogave nga Grupi i themeluar Ndërministror. Krahas institucioneve të tjera, Ministria e Punëve të Brendshme, merr përsipër të luajë një rol të rëndësishëm në koordinimin e veprimeve gjatë implementimit të kësaj strategjie. Përveç kësaj, për të luftuar krimin në lidhje me drogën, planifikohet ndërtimi i kapaciteteve të PK-së përmes trajnimeve, pajisjeve dhe punësimeve. Prioriteti dhe veprimet afatmesme gjegjëse synojnë përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet simotra fqinje në luftimin e krimit në lidhje me drogat.

Kosova është ende vend transiti për heroinën; megjithatë, ekziston një tendencë e uljes së nivelit të transitit si rezultat i luftës për parandalimin e narkotikëve. Fillimi i vitit 2008 ka shënuar rezultate pozitive në konfiskimin e substancave narkotike dhe arrestimin e disa grupeve kriminale.

Korniza ligjore
Sa i përket fushës së drogave është në fuqi një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative, e cila rregullon sektorin e drogave. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

Kodi i Përkohshëm Penal i vitit 2003 - përkatësisht Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal Ligji 03/L-002 2008 Kodi Penal i Kosovës.

Ligji mbi Substancat Narkotike Nr. 2007/02-L128. - Ligji rregullon prodhimin, qarkullimin me shumicë dhe pakicë,importin, eksportin, kalimin tranzit, transportin, blerjen, furnizimin, shitjen, posedimin, konsumimin, përdorimin dhe propagandimin e bimëve prej të cilave mund të përfitohen narkotikët, barnat narkotike, substanicat psikotrope dhe prekursorët. Ligji përcakton obligimet e autoriteteve kompetente të cilat kanë lidhshmëri me këto substancat, bënë klasifikimin e bimëve, barnave narkotike, përcakton masat e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimit të bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e Drogave, Plani Strategjik i policisë së Kosovës 2008-2010 është në implementim të sipër.

Korniza institucionale
Ministria e Punëve të Brendshme si institucion përgjegjës për çështjet e drogave ka këtë strukturë.

- *Departamenti për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme;*
- *Shtylla e Krimit në Policinë e Kosovës Drejtoria për Narkotik në nivel qendrorë;*
- *Njësitet brenda rajoneve policore.*

Në lidhje me infrastrukturën institucionale dhe ndarjen e përgjegjësive në fushën e luftimit të krimit të organizuar, MPB-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave në këtë fushë, EULEX ka përgjegjësinë e monitorimit dhe këshillimit në fushën e sigurisë por gjithahstu dhe mban kompetenca ekzekutive.

Duke njohur rëndësinë e reagimit në fushën e krimit të organizuar, MPB-ja ka iniciuar Planin e Veprimit për parandalimin e trafikimit të drogave.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e drogave, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve të hetimit, luftimit të narkotikëve dhe edukimit, strategjinë dhe planin e veprimit për parandalimin e drogave.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e drogave, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në nivelin e bashkëpunimit mes institucioneve të ndryshme në fushën e drogave, si dhe përforcimin e bashkëpunimit rajonal.

e. Policia

Sundimi i ligjit është prioritet absolut për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Qeveria është e përkushtuar që me të gjitha kapacitetet, gjegjësisht me mekanizmat që ekzistojnë në kuadër të MPB-së e me theks të veçantë të Policisë së Kosovës që Kosova të jetë në nivel të lartë të detyrës që të sigurojmë sundimin e ligjit.

Tanimë nomenklaturës ligjore të këtij sektori i është shtuar edhe Ligji për Policinë si një Ligj bazik me të cilin do të funksionoj Policia e Kosovës, si dhe përshkruhen detyrimet dhe autorizimet e saj dhe të pjesëtarëve të saj, përcaktimi i strukturës organizative dhe rregullimi çështjeve tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Kosovës.

Poashtu, Ministria e Punëve të Brendshme është duke realizuar një rishikim funksional të strukturës organizative të Policisë së Kosovës dhe vlerësimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve brenda Policisë së Kosovës.

Ministria e Punëve të Brendshme ka vendosur lart në kuadër te prioriteteve të saja funksionalizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Tanimë është kompletuar infrastruktura ligjore duke miratuar Ligjin për Policinë dhe atë për Inspektoratin Policor.

Vizioni i Qeverisë është që të zhvillohen politika të qarta për ngritjen e mëtutjeshme të Policisë së Kosovës duke krijuar një Polici efektive dhe efikase, te pregaditur më mirë, numerikisht jo shumë të madhe si dhe të paguar më mirë.

Në këtë drejtim padyshim se do të investohet në ngritjen e kapaciteteve humane dhe përmirësimin e kushteve të punës për pjestarët e Policisë së Kosovës.

Po ashtu, me qëllim të adaptimit me ambientin e krijuar pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe ligjit për policinë, MPB-ja me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë ka filluar rishikimin funksional të strukturës organizative të policisë së Kosovës, përfshirë edhe vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve.

Policia e Kosovës, numëron 8, 673 pjestarë të distribuar në mënyrën e mëposhtme:

Gjinia Mashkullore	**86.82%**
Gjinia Femërore	**13.18%**
Shqipëtar	**84.74%**
Serb	**9.83%**
Të tjerë	**5.43%**

Kurse sa i përket dukurive të veprave penale në vitin 2007 kemi pas 61,383 raste të raportuara, kurse në vitin 2008 kemi pasë 65,238 raste të raportuara. Pra kemi një rritje prej 6%. Mirepo kjo rritje mund të cilësohet dhe si rritje e kapaciteteve te PK në vitin 2008, gjë që ka ndihmuar në zbulimin e dukurive të veprave penale, si dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në PK e shprehur me rritjen e raportimit të këtyre rasteve.

Korniza ligjore

Sa i përket fushës së Policsë është në fuqi një kornizë gjithpërfshirëse legjislative, e cila rregullon sektorin e Policisë. Kjo kornizë përbëhet nga legjislacioni primar në vijim:

- *Ligji për Policinë (nr. DL-003-2008)* - qëllimi i këtij Ligji është themelimi i Policisë së Republikës së Kosovës, përshkrimi i autorizimeve dhe i detyrave të saj, si dhe autorizimeve dhe i dertyrave të zyrtarëve policorë, përcaktimi i strukturës organizative dhe regullimi i çështjeve të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

- *Ligji për Inspektoratin policor te Kosovës (nr. 03/L-036)* - qëllimi i këtij ligji është ta përcaktojë organizimin, funksionet dhe autorizimet e Inspektoratit Policor të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legjislative e cila rregullon sektorin e Policisë, në fuqi janë dy akte nënligjore:

- *UA Nr-01/2009-PK,* kalimi ne strukturën e re te gradave;

- *UA Nr. 10/2008 i aprovuar me 17 Korrik 2008 për Themelimin e Komisionit për Emërime te Larta dhe Disipline ne Polici* - ky udhëzim administrativ themelon dhe rregullon organizimin, funksionimin dhe autorizimet e Komisionit për Emërime te Larta dhe Disipline ne polici i cili funksionon ne kuadër te MPB-se.

Me qëllim të implementimit të politikave efektive në fushën e Policisë, *Plani Strategjik i policisë se Kosovës 2008-2010* është në implementim e sipër.

Korniza institucionale
Ministria e Punëve të Brendshme respektivishtë Policia e Republikës së Kosovës si institucion përgjegjës për për çështjet Policore, ka 5 (pesë) shtylla:

- Shtylla e Operativës;
- Shtylla e Hetimeve;
- Shtylla e Policisë Kufitare;
- Shtylla e Personelit dhe e Trajnimeve;
- Shtylla e Shërbimve Mbështetëse.

Policia e Kosovës gjithahstu në strukturën e saj institucionale ka *6 (gjashtë) Drejtori Regjionale* duke përfshirë edhe *stacionet policore*.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioritetve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e Policisë, mes tjerash MPB-ja PK-ja do të synojë zbatimin e legjislacionit që themelon Policinë e Ksovës respektivishtë zbatimin e Ligjit për Policinë si dhe aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit mbi Policinë dhe do të forcojë kapacitete hetuese përmes ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për zyrtarët policor të shtyllës së krimit, dhe sigurimin e paisjeve të mjaftueshme për shtyllën e krimit; do të hartohet strategjia për parandalimin dhe luftimin e krimit; hartimi dhe zbatimi i Ligjit mbi Armët e Lehta; hartimi dhe miratimi i Planit për grumbullimin e armëve në Kosovë. si dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenjet Njerëzore.

f. Mbrojtja e të dhënave personale

Mbrojtja e të dhënave personale paraqet një segmet kyq në përmbylljen e harkut të obligimeve të shteteve të cilat synojnë aderimin në hapsirat e lira të komunikimit ndershtetërorë. Siguria në procesimin e të dhënave personale përbën një element kyq në ruajtjen e privatësisë së çdo shtetasi dhe është një ndër parakushtet kryesore për vlersim pozitiv të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive personale të çdo individi.

Republika e Kosovës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale ka marrë përgjegjësitë nga Qershori i vitit 2008.

Korniza ligjore
Deri më tani nuk kemi një kornizë të fuqizuar ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. Qeveria e Republikës së Kosovës e përkushtuar për implementimin e kushteve për përfundimin e procesit të liberalizimit të vizave, ka filluar hartimin e legjislacionit primarë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Legjislacioni i ardhshëm do të jetë në përputhje me të drejtat elementare për fshehtësinë e të dhënave personale dhe me situatën teknike të sistemit ekzistues funksional në Kosovës.

Zbrastësira juridike ekzistuese mbulohet nga procedurat shumë strikte brenda Qeverisë së Kosovës, të cilat parashohin kushte shumë specifike dhe procedura konkrete për përdorimin e të dhënave personale. Qasja në të dhënat personale të Shtetasve është shumë e kufizuar dhe plotësisht e kontrolluar nga zyrtarët e MPB-së.

Korniza institucionale
Republika e Kosovës me axhendën e sajë pro-evropiane synon sigurminin e parakushteve themelore për nje nivel të domosdoshëm të sigurisë së të dhënave personale. Qeveria ka paraparë themelimin e Agjencisë për Regjistrim Civil e cila do të grumbullonte të gjitha bazat ekzistuese të të dhënave të qytetarve dhe njëherit do të siguronte mbikqyrje më praktike dhe më të sigurtë.Agjencia do të jetë në funksion të plotë të Institucionit të pavarur përgjegjës për mbrojtjen dhe përdorimin e te dhënave personale.

Qeveria do të jetë e përkushtuar që të vazhdojë me implementimin e plotë të politikave Evropiane të cilat rrisin shkallën e përgjegjësisë Institucionale në fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Personale.

Prioritetet afatshkurtra
Me synim të adresimit të prioriteteve afatshkurtra të Partneritetit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, veprimet e parashikuara, mes tjerash, do të përqendrohen në miratimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në pajtim me Direktivën për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 95/45/EC) si dhe krijimin e një organi gjegjës të pavarur përgjegjës për implementimin e standardeve për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Kosovës. Gjithahstu MPB-j ado të bëjë krijimin dhe funksionalizimin e Agjkencis për Regjistrim Civil si dhe avacimin e sistemit të marrjes dhe përpunimit të të dhënave biometrike.

Prioritetet afatmesme
Me synim të adresimit të prioriteteve afatmesme të Partneritetit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, veprimet e parashikuara, mes tjerash, do të përqendrohen në ngritjen e sistemeve mbrojtëse të shënimeve personale, në pajtim me standardet evropiane, si dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe do të ketë aktivitete të organizuara vetëdijesimi në lidhje me të dhënat personale dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre.

3 REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KAPACITETET ADMINISTRATIVE

a. Sfondi

Zhvillimi institucional është një nga prioritetet kyçe për avancimin e administratës publike në Kosovë. Me institucione të reja, Qeveria e Kosovë, ka arritur të konsolidojë plotësisht një shërbim civil profesional dhe të përgjegjshëm.

Përkundër institucioneve të reja, si dhe me zgjidhjen e statusit, përmirësimi dhe reformimi i administratës publike konsiderohet domosdoshmëri për plotësimin e kërkesave aktuale dhe për të përmbushur obligimet e krijimit të shtetit demokratik, për të ofruar shërbime efikase për qytetarë, si dhe për të qenë në gjendje të përmbushjes së obligimeve aktuale dhe të ardhme ndërkombëtare.

Në përpjekjet e vazhdueshme për hyrje në BE, institucionet kosovare do të duhet të përmirësojnë funksionimin e gjithë administratës publike.

b. Institucionet përgjegjëse dhe gjendja aktuale

Përgjegjësia kryesore për ndërtimin e kapaciteteve të Administratës publike të Kosovës bie tek Ministria e Administrates Publike (MAP), gjegjësisht Institutit Kosovar për Administratën Publike (IKAP). MAP-ja/IKAP-i është përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e politikave drejt krijimit të një shërbimi civil profesional, shumë-etnik dhe të përgjegjshëm në institucionet e Kosovës.

Agjencia për Koordinim të Zhvillimit dhe Integrimit Evropian (AKZHIE), gjegjësisht Drejtoria për Strategji dhe Koordinim koordinon gjitha aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të shërbyesve civilë në të gjitha fushat në lidhje me BE-në. Zbatimi i PVPE-së do të varet nga niveli i ndërtimit të institucioneve dhe trajnimit të shërbyesve civilë, nga njohuritë dhe aftësitë e përmbushjes së obligimeve të tyre nga Partneriteti Evropian.

c. Çka duhet bërë...?

Implementimi i vazhdueshëm i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike ka identifikuar shtatë fusha strategjike: menaxhimin e burimeve njerëzore, strukturën institucionale, komunikimin me qytetarë, menaxhimin e administratës publike, e-Qeverisja, financimi i administratës publike, anti-korrupsioni, si dhe politikat e legjislacioni.

Prioritetet kryesore përfshijnë hartimin dhe miratimin e legjislacionit në përputhje me Acquis, si dhe funksionalizimi i mekanizmave të monitorimit në implementimin e legjislacionit. MAP-ja është duke implementuar projektin për Rishikimin Funksional të Institucioneve të Kosovës për të iniciuar reformën e administratës publike. E-Qeverisja është prioritet tjetër i Qeverisë për të avancuar punën në administratë publike dhe për të ofruar shërbime efektive për qytetarë e biznese.

Reforma e administratës publike plotëson një nga prioritetet e partneritetit Evropian 2008 si dhe plotëson aktivitetet e trajnimit mbi çështjet e BE-së.

Plani i Integrimeve Evropiane 2008-2010, miratuar nga Qeveria e Kosovës, mbulon ndërtimin e kapaciteteve, trajnimin dhe aktivitete tjera në këtë fushë për implementimin e PVPE-së 2009. Fokusi kryesor i AKZHIE-së do të jetë përforcimi i strukturave evropiane në gjitha nivelet e Qeverisë për të siguruar bashkërendim dhe zbatim më të mirë të PVPE-së.

4 PËRKTHIMI I ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN.

a. Sfondi

Me çdo asocim të ri, i gjithë legjislacioni i Komunitetit Evropian në fuqi në atë kohë - *Acquis* – duhet të përkthehet në gjuhën e vendit të ri para hyrjes në BE, ashtu që qytetarët të dinë se për çka po përkushtohen.

Në periudhën e para-asocimit, Qeveria e Vendit, e jo Bashkimi Evropian, është përgjegjëse për përkthimin e legjislacionit evropian në fuqi në gjuhën e saj, si dhe duhet të ndërtojë një njësi të veçantë për këtë. Përkthimi dhe shqyrtimi i *Acquis* është ndoshta e vetmja detyrë në gjithë operacionin e bashkimit që është absolutisht e njëjtë për secilin Shtet aspirues.

Përkthimi i akteve ligjore të BE-së dhe akteve vendore duhet kuptuar si pjesë përbërëse e gjithë procesit të harmonizimit dhe implementimit në lidhje me integrimin në BE. Është qenësore që aktet vendore të përkthehen gjatë vetë transponimit në ligje vendore. Përkthimet e akteve vendore ligjore të harmonizuara me *Acquis* duhet të jenë në dispozicion të institucioneve të BE-së që janë përgjegjëse për monitorimin e progresit të arritur në përafrimin e legjislacionit.

Acquis aktualisht përbëhen nga rreth 115 000 faqe të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian (faqe të OJ). Ky është numër "dinamik", i cili përherë ndryshohet, modifikohet, shumëzohet – mbi 5.000 faqe të Gazetës miratohen në vit.

b. Institucioni përgjegjëse dhe gjendja aktuale

Mes përgjegjësive të AKZHIE-së, përveç harmonizimit të legjislacionit vendor, koordinimit të fondeve të BE-së dhe komunikimit e informimit, ekziston edhe koordinimi i përkthimit të legjislacionit të BE-së, si dhe përgatitja e *Acquis* të BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës.

